

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 397 DHJETOR 2023



QENDRIMI I ISLAMIT
NDAJ TATUAZHEVE

FEJA E SHQIPTARIT NUK
ËSHTË SHQIPTARIA

NDIKIMI I TJETRIT NË
NDËRTIMIN E IMAZHIT

URIMI I MYFTIUT TËRNAVA ME RASTIN E FESTËS SË 28 NËNTORIT

28 Nëntori është dita që bashkon të gjithë shqiptarët anembanë botës. Ditë e festë, e cila shqiptarët i bënë të ndihen si një trup, duke kujtuar veprën, kontributin, angazhimin e sakrificën e etërve të kombit e të shtetit.

Po ashtu, çdo 28 nëntor, me respekt e dinjitet, kujtojmë ideologët, heronjtë, martirët e aktivistët e çështjes kombëtare ndër vite e shekuj.

28 nëntori i vitit 1912 shënoi momentin e mëvetësisë, fillimin e shtetësisë dhe identitetin e Shqipërisë së lirë.

Gëzuar shqiptarë kudo që jeni, mbarësi, unitet e harmoni!

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë



Urime
28 *Nëntori*

EDITORIAL

- 4 Parametrat e gabuar të progresit shoqëror

FETARE

- 5 "Më i bukur se atdheu është vetëm atdheu im"
- 8 Komentimi i sures El Fet'h (10)
Sabri Bajgora
- 11 Operacionet plastike (ndërhijet estetike) dhe këndvështrimi Islam ndaj tyre
Dr. Ejup Haziri
- 15 Qëndrimi i së drejtës islame ndaj tatuazheve
Dr. Flamur Sofu
- 19 Muhamedi a.s., në mes modestisë dhe pedanterisë
Dr. Zenel Hajdini
- 21 Çiltërsia shpirtërore e besimtarit dhe kujdesi i tij për dukjen
Blerim Musliu
- 24 Jeta e varrezave (El Barzah), realiteti të cilin do ta jetojë çdo person
Dr. Ali Sallabi
- 27 Virtytet e moralit islam
Dr. Sedat Islami
- 29 E drejta pronësore e gruas dhe burimet e saj (2)
Dr. Ilmije Kuqi
- 33 Feja e shqiptarit nuk është shqiptaria!
Hajrudin S. Muja
- 37 Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (3)
Hazir D. Selmani



FAMILJE & EDUKIM

- 41 Ndikimi i tjetrit në ndërtimin e imazhit personal
PhD Merjeme Gashi
- 43 Triumfi i së vërtetës islame
Mimoza Sinani
- 47 Luftimi i amoralitetit, analfabetizmit dhe ngritja e edukimit dhe arsimimit
Dr. Mirsad Aslani
- 49 Ekspozimi ndaj drogave të ndaluara dhe ndikimi i tyre në lidhjet ndërnjerëzore
Arben Desku
- 51 Imuniteti dhe vaksinimi
Dr. Mysheref Sylbije



PERSONALITETE

- 53 111-vjetori i lindjes së hafëz Abdullah ef. Sagdanit
Faik Miftari


HISTORI & CIVILIZIM

- 56 Si e shpëtoi Islami ekzistencën e çifutëve në Evropën Perëndimore
- 59 ISLAMI NË NORVEGJI
Anne Sofie Roald*



AKTIVITETE

- 61 "Dashuria ndaj vatinit është pjesë e imanit"



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 397 • viti 37 • Dhjetor 2023
• Xhumadel-Ula / Xhumadel-Ahireh 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavi,
Mr. Vedat Shabani.
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Europrint", Prishtinë



*“Me të vërtetë më
fisniku ndër ju te Zoti,
është ai që i druan -
ka zemërdlirësinë më
të madhe ndaj Tij...”*

(El Huxhurat, 13)

Parametrat e gabuar të progresit shoqëror

Transformimi i thellë shoqëror dhe ndryshimet e shpejta botëkuptimore janë produktet e vërejtura që solli modernizmi, qoftë ai si një frymë filozofike, apo edhe si mënyrë jetese. Nëse jo si aspiratë jona, ky ndryshim është evident si realitet i imponuar që s'mund ta mohoj më asnjëri. Këto lëkundje perceptuese dhe këto dilema hamendësuese të përmasave të gjera, falë zhvillimit marramendës teknologjik, sot trokasin “pa leje” në derën e secilit, qoftë ai person liberal apo konservator, praktikues i denjë fetar apo njeri besëtytë e ateist. Sigurisht, bashkë me produktet e shumta të tjera që solli ky transformim, disi ridizenjoi edhe parametrat matës të progresit shoqëror.

Asaj që i kemi duartrokatur dikur, e që kemi ftuar shoqërinë pareshtur në të, duke e konsideruar si virtyt e të mirë, tani, hija e rëndë e ndryshimeve na bën të matemi shumë para se të çelim gojën e të themi një fjalë miradije për të. Virtytet morale, ngritja shkencore, edukimi i mirëfilltë i brezit të ri, dhe në këtë rang sigurisht edhe ngrohtësia familjare, respekti e mëshira ndaj të moshuarve, dikur konsideroheshin treguesit më të saktë që besnikërisht rrëfenin për një shoqëri progresiste, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Por që të njëjtat, sot, për dikë mund të mos llogariten asgjë më tepër se sa tipare të një karvani njerëzish që ka ngecur në vorbullën e të kaluarës dhe s'po arrin dot ta gjejë rrugën drejt “avancimit” të shpejtë e të modernizimit të shumëkërkuar. “Progresistët” e tillë, para se të ndryshojnë standardet e vlerësimit, janë vetëkënaqur me braktisjen e asaj trashëgimie të rrethit të tyre shoqëror, dhe nuk ndiejnë nevojën për të respektuar ndonjë parametër të shëndoshë të matjes së avancimit të shëndoshë shoqëror. Siç do të thoshte njëri prej sociologëve shqiptar: “Çdo ditë duket se ka një braktisje të nevojës për art, kulturë, moral, marrëdhënie shoqërore të mirëfillta, vullnetarizëm, solidaritet, ... ofrim shërbimesh për njerëzit në nevojë, etj.”

Kjo tendencë synon që ta shoh krejt normale, prirjen e atij grumbulli të madh njerëzish që fillojnë dhe e mbyllin ditën e tyre me motivet e parasë, fitimit, konsumit, pasionit dhe ngarendjes drejt të panjohurës. Ata, nëse dikur i kemi parë me syrin e dhembshurisë e të nevojës për këshillë, tani, nga një shtresë e gjerë të shoqërisë sonë, shihen me syrin e mahnitjes dhe vlerësimit maksimal. Transformimi i shpejt ka bërë që kjo kategori të shuajë përgjithmonë ëndrrën dhe aspiratën fisnike të ngritjes në atë nivel ku vlerat shpirtërore, dija dhe morali të kenë vendin më të lartë në jetën e tyre.

Në konceptin parimor islam, parametri më gjithëpërfshirës dhe sigurisht më i shëndoshë, me anë të të cilit ne udhëzohemi nga Zoti ynë, që të vlerësojmë një individ a shoqëri është: “Me të vërtetë më fisniku ndër ju te Zoti, është ai që i druan - ka zemërdlirësinë më të madhe ndaj Tij...” (El Huxhurat, 13). Kriteri matës i progresit të një individi, e rrjedhimisht edhe të një shoqërie, sipas Kuranit, mbetet besimi e dëlirësia shpirtërore, frikërespekti ndaj Krijuesit, fisnikëria morale, drejtësia në gjykime, këshillimi në qeverisje e standarde të tjera që lëvizin në këtë linjë. Heqja dorë nga ky kriter vlerësues për njeriun, pos që është nëpërkëmbje e kërkesës hyjnore, ajo rrëfen edhe moskokëçarjen tonë për brengat e shtuara të këtij brezi që në këtë pikë, rrugëtimin e ka filluar në drejtimin e gabuar.

Duke qenë se nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, myslimanët janë përshkruar se janë “dëshmitarët e Zotit” në tokë (Buhariu dhe Muslimi), atëherë ky nuk është thjesht një epitë që ne të krenohemi para të tjerëve me të. Përtej kësaj, i njëjti llogaritet një përgjegjësi që ngarkon secilin prej nesh të kujdestarojë dhe të kontribuojë disi në kapacitete të veta në ruajtjen e standardeve të shëndosha të vlerësimit të individëve dhe shoqërisë.

E mira dhe e keqja, në konsideratën e njerëzve mbesin gjithmonë relative. Një erë e vrullshme ndryshimesh, nëse nuk jemi vigjilentë, copëton e bën thërrmijë të gjitha postulatet e parimet vlerore që dikur kemi pasur dakordësi mbarëshoqërore rreth tyre. Ndërkaq, po u ruajt në vetëdijen tonë si e mirë, ajo që te Zoti ynë është e mirë, dhe si e keqe, ajo që te Zoti ynë është e keqe, kemi shpresën se kështu do të garantojmë për brezin e ardhshëm ruajtjen e standardeve të mirëfillta të një shoqërie progresiste.

Kjo nuk është e lehtë, por natyrisht, as edhe e pamundur!

Mr. Driton Arifi

Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, e mbajtur me rastin e manifestimit fetar-kulturor për nder të festës së 28 Nëntorit, në Malishevë, më 24.11.2023

“Më i bukur se atdheu është vetëm atdheu im”

Të nderuar të pranishëm,

Më 28 nëntor të vitit 1912, Ismail Qemali, i shoqëruar nga delegatë nga të gjitha trevat shqiptare, ngriti flamurin kombëtar në Vlorë dhe shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Kjo ditë dhe datë na shtyn të mendojmë edhe më shumë për fatet historike të kombit shqiptar, për vlerat që përmban e rrezaton flamuri shqiptar, e me të cilat lidhen në mënyrë të përhershme edhe festat e çdo shqiptari.

28 Nëntori është festë e cila bashkon të gjithë shqiptarët anembanë botës, festë e cila shqiptarët i bënë të ndihën si një trup duke kujtuar veprat e personaliteteve të shumta që kontribuan dhe mundësuan shpalljen e pavarësisë, por edhe të gjithë atyre që u flijuan për këtë ditë, ditë e cila bëri që shqiptarët ta gëzojnë flamurin, gjuhën, shtetin dhe identitetin e tyre.

Kjo ditë i parapriu edhe përpjekjeve dhe ditës së shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Prishtinë, në një mbledhje të jashtëzakonshme, në të cilën merrnin pjesë 109 nga gjithsej 120 delegatë. Në këtë mbledhje njëzëri nga të gjithë delegatët e pranishëm, Kosova u shpall shtet sovran e i pavarur.

Edhe për shpalljen e pavarësisë së Kosovës u sakrifikuara dhe u derdh gjak i shumtë, u flijuan qindra mijëra vëllezër e motra tanë, u zhvilluan luftëra të shumta, ranë shumë dëshmorë, u burgosën, u maltretuan dhe u ekzekutuan me qindra mijëra shqiptarë. Lufta e lavdishme e UÇK-së, e përkrahur nga aleatët tanë të shumtë, solli edhe lirinë e vendit tonë. Edhe me këtë rast, me krenarinë më të madhe përkujtojmë të gjithë shëhidët – dëshmorët e Kosovës, që ranë në altarin e lirisë për çlirimin e vendit tonë nga okupimi klasik i Serbisë.

Me theks të veçantë e me krenari, duhet në vazhdimësi ta freskojmë memorien tonë e të përkujtojmë sakrificën dhe flijimin e familjes **Jashari**, e cila pas një lufte tre ditore me ushtrinë, policinë dhe paramilitarët serb, qëndroi, luftoi dhe u flijua për të mbetur shembull deri në Kiamet se si mbrohet pragu i shtëpisë, nderi i familjes e i kombit, atdheu dhe



flamuri. Zoti i pastë mëshiruar me mëshirën e Tij të pakufishme!

Komandanti legjendar Adem Jashari, Hamëz Jashari e baca Shaban, për heroizmin e tyre të treguar dhe dashurinë për atdheun ku lindën dhe jetuan, do të mbeten në kujtesën dhe memorien e çdo shqiptari deri në amshim.

Pra, atdheu është vendi në të cilin kemi lindur dhe në të cilin jetojmë. Atdheu është toka në të cilën morëm frymën e parë, në të cilën jetojmë dhe në të cilën do të kalojmë pjesën tjetër të jetës, andaj duhet ta duam atë. Besoni me zemër të hapur, se vërtet atdheu ynë është më i miri dhe më i bukur.

Të nderuar vëllezër e motra,

Atdheu im ka një diell të ngrohtë, ajër të pastër, ujë të freskët, shira të mrekullueshëm, përmban peizazhe të ndryshme natyrore të maleve, luginave, lumenjve, dhe pamjeve të tjera natyrore që rrisin lidhjen tonë me të.

Dashuria jonë për të na shtyn drejt mbrojtjes, ruajtjes dhe konsiderimit të tij si një nga thesaret e botës së pashtershme.

Të nderuar të pranishëm,

Më i bukur se atdheu është vetëm atdheu im.

Prandaj të dua o atdhe, dhe krenohem me lavdinë dhe trashëgiminë tënde o Kosova ime, ngase ti je jeta dhe pa ty nuk ka jetë. Atdheu është në juridiksionin e zemrës, emocionit, mendjes dhe shpirtit. Atdheu asnjëherë dhe në asnjë mënyrë nuk është i negociueshëm, ngase është tokë e të parëve dhe tokë e nipërve dhe mbesave tanë, është kujtimi dhe identiteti ynë, dhe është pjesa më e bukur e tokës që shohin sytë tanë.

Atdheu përkufizohet si vendi ku individi ka lindur e është rritur, ndihet i mishëruar me të dhe i përket atij. Dashuria për atdheun konsiderohet si një nga karakteristikat më të rëndësishme të një qytetari të mirë. Dashuria për të sjell edhe ndjenjën e individit që të jetë krenar për atdheun e tij. I lidhur me atdheun, njeriu ndjen mbështetje dhe solidaritet reciprok me anëtarët e shoqërisë që jetojnë me të në të njëjtin vend.

Atdheu i jep secilit individ liri absolute për të praktikuar fenë dhe besimin e tij pa frikë dhe ndrojtje. Çdo person që jeton në atdheun tonë mund të praktikojë lirisht fenë e tij dhe ka të drejtë të praktikojë ritualet që lidhen me fenë që ndjek, qoftë feja islame, apo fetë e tjera.

Atdheu është kujtim i gjallë njerëzor. Në atdhe përjetohen të gjitha kujtimet e bukura të fëmijërisë, ditët më të bukura të rinisë, ku ndërtuam shpresat dhe ambiciet tona të mëdha për një të ardhme sa më të mirë.

Dashuria për atdheun është një instinkt i lindur njerëzor. Zoti i Madhëruar e vendosi instinktin për ta dashur atdheun dhe për t'i përkatur atij në mënyrë të lindur që në momentin e parë të ekzistencës sonë në këtë jetë, dhe për këtë ne shohim se çdo njeri duhet ta dojë dhe çmojë atdheun e tij.

Kur themi **“atdhe”**, në sytë tanë vizatohet një imazh i heronjve sypatrembur, prej të cilëve mësuam dashurinë dhe kuptimin e drejtë të sakrificës e fljimit; prej të cilëve mësuam durimin në fatkeqësi, mësuam burrëri dhe mençuri. Ata, jetën e tyre, ia kushtuan ndërtimit të një vendi të fortë si një kështjellë e paepur, në të cilën janë të disponueshme të gjitha mjetet e prosperitetit dhe të jetesës së denjë. E kemi dashur, e duam akoma dhe do të vazhdojmë ta duam deri në frymën e fundit, sepse është gjëja më e shtrenjtë që kemi.

Dashuria për kombin dhe përkatësia ndaj tij i shtyn individët në rritjen e aftësisë dhe vetëdijes së tyre për t'u përballur me sulmet dhe sfidat; i shtyn ata drejt rekrutimit për të ruajtur kombin e atdheun e tyre, për ta mbrojtur atë në luftëra dhe për të sakrifikuar dhe jetën e tyre në mbrojtje të vatanit të tyre. Ky atdhe meriton të mbrohet me gjithë dijen dhe forcën e çdonjërit edhe nëse i kushton me jetën e tij. Duhet të formohet bindja dhe të ngritet vetëdija se mbrojtja e atdheut duhet bërë nga mbarë populli, ngase interesi i atdheut duhet të jetë para çdo interesi të ngushtë të kësaj jete.

Pra duhet kohezioni i anëtarëve të komunitetit, respekti i tyre për njëri-tjetrin dhe puna e përbashkët për të ruajtur shoqërinë dhe pronën e tij, për t'u përballur me armiqtë e tij dhe për ta mbrojtur atë.

Dashuria për atdheun është e çmuar, atdheu është i shtrenjtë, atdheu është i lartë, atdheu është i palëkundur, sepse atdheu është vetvetja jonë, është prioriteti ynë i parë, që nuk mund të barazohet e as të krahasohet me asgjë.

Prandaj nuk ka alternativë apo kompensim të barabartë me dashurinë ndaj dheut të kësaj toke. Le t'u përmbahemi parimeve tona dhe ta mbrojmë tokën tonë, të cilën e kemi trashëguar nga të parët tanë dhe në të cilën u krijuam dhe u rritëm! Atdheu është një përkatësi dhe një identitet, dhe kush nuk ka identitet, sikur nuk ekziston, ngase atdheu ka rrënjë dhe autenticitet.

A e di, vendi im i dashur, se për ne nuk je vetëm një copë toke e bekuar, por ne kemi atë ndjenjë sigurie të rrënjësor thellë brenda nesh, brenda shpirtit e zemrës sonë mbështetur në mirësitë të cilat na i siguron ti.

Dashuria për atdheun është një natyrë e lindur brenda njeriut, zemra e tij rrah dhe rrjedh gjak me të. Atdheu përmban kujtime të paharrueshme, përfshirë fëmijët, prindërit, gjyshërit, familjen, të dashurit dhe miqtë. Dashuria për atdheun është një instinkt i rrënjësor në shpirtin, i cili e bën njeriun të ndihet rehat duke qëndruar në të. Përmallohu për të nëse të mungon, mbroje nëse sulmohet dhe lufto për të nëse rrezikohet.

Islami e ka bërë pjesë të besimit dashurinë për atdheun dhe përkatësinë e tij, si dhe e ka bërë detyrë të shenjtë mbrojtjen e tokës së atdheut. Biografia e nderuar e Pejgamberit a.s. na jep shembuj të mrekullueshëm që mishëron statusin e atdheut në Islam.

Ai thekson se përkatësia ndaj atdheut apo Islamit nuk është vetëm shprehje formale, por është përgjegjësi. Kushdo që pretendon se i përket dhe e do atdheun e tij duhet të bëjë mirë për të, të përpiqet të punojë për ta stabilizuar atë dhe të bashkëpunojë me anëtarët e saj, cilado qoftë feja e tyre, përderisa ata nuk janë armiqësorë apo nuk luftojnë kundër interesave të vatanit.

Natën e shpërnguljes së Muhamedit a.s., për në Medinë, ai u ndal në periferi të Mekës dhe u kthye me fytyrë nga ajo, e shikonte atë duke kujtuar situata dhe kujtime - edhe nëse këto kujtime ishin të përziera me dhimbje - dhe iu drejtuar me fjalët që zbuluan dashuri të thellë, lidhje me shtëpinë e fëmijërisë dhe adoleshencës, shtëpitë e familjes dhe miqve, si dhe shtëpinë e Shenjtë të Zotit - Qabenë, duke thënë: “Pasha Zotin, e di se t'i je më e mira tokë e Zotit dhe më e dashura te Zoti, e sikur populli im mos të më dëbonte nga këtu, nuk do të largohesha.”

Islami ka kërkuar mbrojtjen e atdheut dhe ka ligjësuar përpjekjet për hir të Zotit, në mbrojtje të tij, fesë, tokës dhe nderit, dhe kushdo që vritet në mbrojtje të atdheut të tij është



dëshmor për hir të Zotit. Mbrojtja e atdheut nuk kufizohet vetëm në përballje me armikun, por me të gjithë ata që kërkojnë t'i bëjnë dëm atdheut në çfarëdo mënyre qoftë ajo.

Feja e vërtetë islame nuk bie ndesh me vlerat e saj në raport me natyrën njerëzore dhe ndjenjat emocionale. Të duash atdheun dhe t'i takosh atij është një çështje instinktive. Kur njeriu lind në një vend, rritet në të, pi ujin e tij dhe thith ajrin e tij, nuk ka dyshim se natyra e tij do ta dojë atë dhe ai do të ndjejë atë.

Është e detyrueshme që të gjithë ta rindërtojnë dhe ta mbrojnë atë. Islami e ka lartësuar rëndësinë e atdheut si një vlerë kulmore. Dashuria, përkatësia dhe besnikëria ndaj atdheut janë detyrime të shenjta, dhe kushdo që manipulon këto koncepte konsiderohet tradhtar.

Dashuria për atdheun është një natyrë njerëzore e miratuar edhe nga Islami, duke e bërë atë një nga themelet e ndërtimit të shoqërive dhe një rrugë drejt tolerancës, mirëbesimit e emancipimit brenda kornizave hyjnore. Dashuria për atdheun nuk duhet të ndalet në ndjenja dhe emocione, por duhet të përkthehet në sjellje të mirë dhe të dobishme për individin dhe shoqërinë.

Atdheu është vendi të cilit ne i përkasim, që përfaqëson për ne sigurinë, ndershmërinë dhe përkatësinë. Ai përbën një pjesë integrale të identitetit, kulturës dhe historisë sonë, përfaqëson një burim krenarie dhe nderi. Atdheu përfaqëson një vend të dashur që i motivon qytetarët të punojnë shumë dhe të sakrifikojnë për të.

Atdheu është vendi në të cilin jetojmë dhe rritemi, dhe përmes marrëdhënieve tona me atdheun, ne ndjejmë një ndjenjë përkatësie dhe kohezion shoqëror dhe kemi përgjegjësi ta ruajmë vendin tonë dhe të punojmë për të arritur aspiratat dhe ëndrrat tona.

Në përgjithësi, mund të thuhet se atdheu është vendi që na bashkon të gjithëve dhe përfaqëson për ne një burim dashurie, përkatësie dhe besnikërie. Të gjithë duhet të punojmë për të ruajtur unitetin tonë dhe për të promovuar vlerat e respektit, tolerancës, besnikërisë e bashkëpunimit për të ndërtuar një shoqëri të fortë dhe të begatë në atdheun tonë të dashur.

Atdheu është gjëja më e çmuar që njeriu ka, sepse është djepi i rinisë së tij, guri i hapave të parë të tij, vatra e fëmijërisë, streha e pleqërisë, burimi i kujtimeve, drita e jetës së tij, shtëpia e baballarëve dhe gjyshërve të tij dhe streha e fëmijëve dhe nipërve të tij.

Dashuria e vërtetë për atdheun është ndjenjë përgjegjësie ndaj atdheut tonë të dashur dhe punë e palodhur dhe këmbëngulëse për ngritjen e nivelit të vendit tonë në të gjitha fushat, ekonomike, kulturore, sociale, fetare dhe shëndetësore, me zell dhe këmbëngulje në kërkimin e dijes, duke punuar me sineritet dhe përkushtim në punën tonë dhe përprjekje për të arritur arritje që i sjellin lavdi dhe krenari atdheut dhe kënaqin Zotin xh.sh..

Dashuria për atdheun është një dashuri e lindur, e thirrur nga besimi, e mbështetur nga Syneti dhe e inkurajuar nga morali i mirë. Prandaj konstatojmë se myslimani i vërtetë është më së shumti i dashur për atdheun e tij, besnik deri në maksimum, i gatshëm të ofrojë çdo gjë të çmuar për hir të përparimit dhe prosperitetit të kombit e atdheut të tij.

Dashuria për atdheun merr dimension besimi. Rruga drejt Zotit mund të jetë vetëm përmes atdheut. Kur Zoti i Plotfuqishëm na krijoi, Ai edhe zgjodhi vendin tonë të lindjes, ndaj të jetojmë në atdheun tonë, në tokën tonë e të mos emigrojmë.

*Myftiu Naim ef. Tërnavë
Malishevë, më 24 nëntor 2023*



Komentimi i sures El Fet'h (10)

REALIZIMI I ËNDRRËS SË PEJGAMBERIT A.S. PËR HYRJEN NË MEKË

Sabri Bajgora

لَقَدْ صَدَقَ اللَّهُ رَسُولَهُ الرُّؤْيَا بِالْحَقِّ لَتَدْخُلُنَّ الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ إِن شَاءَ اللَّهُ آمِنِينَ مُحَلِّقِينَ رُءُوسَكُمْ وَمُقَصِّرِينَ لَا تَخَافُونَ فَعَلِمَ مَا لَمْ تَعْلَمُوا فَجَعَلَ مِنْ دُونِ ذَلِكَ فَتْحًا قَرِيبًا ﴿٧٢﴾ هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ شَهِيدًا ﴿٨٢﴾

“Allahu e vërtetoi ëndrrën e të Dërguarit të Tij, dhe e bëri realitet: “Do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, të sigurt, me vullnetin e Allahut, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike.” Ai dinte atë që ju nuk e dinit. Veç kësaj, Ai ju dha një fitore të afërt (Hajberin). Është Ai që e dërgoi të Dërguarin e Vet me udhëzim dhe fe të vërtetë, për ta lartësuar atë mbi çdo fe. Mjafton Allahu si dëshmitar!” (El Fet'h, 28-27).

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETI 27


- Transmetojnë Abdu bin Humejd, Ibnul Mundhiri, Ibn Xheriri dhe Bejhekiu nga Muxhahid bin Xheberi të ketë thënë: “I Dërguari a.s., duke qenë në Hudejbije¹, e pa në ëndërr-vegim (ru'ja), se ai me sahabët e tij po hynin në Mekë, të qetë, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar... E, kur i Dërguari a.s. flijoi kurbanet në Hudejbije, disa nga sahabët e pyetën. Ku është ëndrra-ru'ja jote o i Dërguar i Allahut, dhe në lidhje me këtë pati zbritur ajeti 27: “Allahu e vërtetoi ëndrrën e të Dërguarit të Tij, dhe e bëri realitet: “Do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, të sigurt, me vullnetin e Allahut, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike.”

- Transmetohet nga Katadeja të ketë thënë: I Dërguari a.s. kishte parë në ëndërr të qartë-ru'ja, se po hynte në Mekë, (me ihram), dhe kur u arrit marrëveshja e Hudejbijes, disa njerëz që ishin me iman të dobët, mbetën të hutuar, kurse i Dërguari a.s. i lajmëroi se ai (së shpejti) do të hynte në Mekë, dhe për këtë zbriti ajeti: “Allahu e vërtetoi ëndrrën e të Dërguarit të Tij, dhe e bëri realitet...”, duke ua bërë të ditur si ai do të hynte në Mekë vitin vijues, dhe se ëndrra-ru'ja e tij ishte e vërtetë.³

LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATO PARAPRAKE

Në ajetet paraprake, ishim dëshmitarë se si idhujtarët kurejshë i penguan besimtarët myslimanë ta kryenin umren, duke i penguar madje edhe kurbanet e tyre që të arrinin në

vendin e flijimit. Pikërisht, në këto çaste të rënda, Allahu xh.sh. e inspiroi të Dërguarin e Vet, që ta pranonte marrëveshjen e Hudejbijes. Ndonëse në dukje, nenet e kësaj marrëveshjeje dukeshin të rënda e të dhimbshme për myslimanët, megjithatë frytet e saj së shpejti do të shiheshin. Allahu xh.sh., nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, i mbrojti edhe jetët e pafajshme të myslimanëve që gjendeshin në Mekë, e të cilët po e mbanin të fshehur besimin e tyre të sinqertë. Nëse myslimanët do të marshonin me forcë drejt Mekës për të hyrë në të me luftë, atëherë sigurisht se do të pësonin me jetë edhe këta myslimanë që po jetonin në Mekë. Dhe, kur në zemrat e idhujtarëve u ndez paganizmi i egër pagan, atëherë



Allahu i Madhërishëm zbriti qetësinë dhe prehjen shpirtërore në zemrat e besimtarëve, që tash në këto ajete, t'ua vërtetojë atyre se ata së bashku me të Dërguarin a.s. do të hynin në Mekë, qetësisht, dhe do ta kryeni umren, madje duke i përgëzuar për një çlirim të afërt, që ishte çlirimi i Hajberit. Njëkohësisht, në këto ajete të fundit, rikonfirmohet edhe njëherë se Muhamedi a.s. është i dërguar i Allahut me udhëzim dhe fe të drejtë dhe po ashtu vjen përgëzimi se Islami gjithsesi do të triumfojë ndaj feve dhe ideologjive të shpikura nga njeriu, sepse është fe e zgjedhur prej të Madhërishmit për krejt njerëzimin që prej Ademit a.s. e deri në Ditën e Gjykimit.

KOMENT:

27. *Allahu e vërtetoi ëndrrën e të Dërguarit të Tij, dhe e bëri realitet: "Do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, të sigurt, me vullnetin e Allahut, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike." Ai dinte atë që ju nuk e dinit. Veç kësaj, Ai ju dha një fitore të afërt (Hajberin).*

Ajetet e fundit të kësaj sureje, e përmbyllin në mënyrë madhështore një ngjarje kaq të lavdishme siç ishte marrëveshja paqësore e Hudejbijes, ngjarje e cila shënoi fillimin e ngritjes dhe lartësimit të Islamit, thirrje kjo e cila shumë shpejt do të "pushtonte" zemrat e njerëzve, duke i shpëtuar nga errësirat e kufrit në dritën e së vërtetës.

Ky ajet, pashmangshëm na kthen edhe njëherë tek ëndrra e mirë e Pejgamberit a.s., kur në Medinë, një melek e kishte përgëzuar: "Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike."⁴ Dhe tash, në ajetet e fundit të sures, i Madhërishmi ia vërtetoi edhe njëherë të dërguarit të Vet, se hyrja e tij në Mekë dhe vizita e Shtëpisë së shenjtë së bashku me sahabët, me lejen dhe dëshirën e Allahut, së shpejti do të bëhej realitet. Kjo vizitë nuk do të kryhej në vitin e 6-të hixhrij, siç ishte planifikuar, por do të realizohej menjëherë në vitin pasues, të 7-të hixhrij, ashtu siç e parashihnin edhe nenet e marrëveshjes paqësore të Hudejbijes.

Në historinë islame, kjo umre që u krye në vitin e 7h. quhet "Umretu el Kasas" ose "Umretu-l Kada'e", kur i Dërguari a.s. së bashku me sahabët e tij, për tri ditë me radhë kishin qëndruar në Mekë, duke kryer ritualet e umres dhe duke bërë

ibadet pranë Shtëpisë së shenjtë-Qabesë. Ndërkohë, kurejshët, i madh e i vogël, kishin dalë jashtë Mekës, ashtu siç kishin kërkuar ata vetë, sepse mëria dhe urrejtja e tyre ndaj Pejgamberit a.s., dhe myslimanëve, ishte shumë e madhe.

Kurse pjesa e fundit e këtij ajeti "Ai dinte atë që ju nuk e dinit. Veç kësaj, Ai ju dha një fitore të afërt (Hajberin)", përmban një përgëzim të madh për myslimanët, sepse shumë shpejt paralajmërohej një fitore dhe një ngadhënjim i madh, që sipas dijetarëve është çlirimi i fortifikatave të Hajberit, me çka iu dha fund njëherë përgjithmonë pranisë fizike të çifutëve në Siujdhesën Arabike.⁵


Ardhja në formën e kohës së shkuar, nga aspekti gramatikor i kësaj fjalie: "Allahu e vërtetoi ëndrrën e të Dërguarit të Tij, dhe e bëri realitet", ende pa ndodhur hyrja në Shtëpinë e Shenjtë, është shenjë dhe paralajmërim hyjnor, se kjo do të ndodhë pashmangshëm, dhe realizmit të kësaj ëndrrë të mirë, do t'i gëzoheshin të gjithë besimtarët.⁶

28. *Është Ai që e dërgoi të Dërguarin e Vet me udhëzim dhe fe të vërtetë, për ta lartësuar atë mbi çdo fe. Mjafton Allahu si dëshmitar!*

I Lartmadhërishmi edhe njëherë vërteton për dëlirësinë e Pejgamberit a.s., të cilin e dërgoi me udhëzim dhe fe të vërtetë, në të cilën nuk ka shtrembërime e as mundësi ndërhyrjeje nga dora e njeriut, për t'i devijuar kuptimet e ajeteve kuranore, ashtu siç kishte ndodhur me Tevratin dhe Inxhilin, nga çifutët dhe të krishterët, të cilët kishin shtrembëruar citatat e këtyre dy librave të shenjtë. Pas këtij vërtetimi bindës se kjo fe është e vërteta, tash vjen përgëzimi tjetër për besimtarët myslimanë, se kjo fe, d.t.th., Islami, do të ngadhënjë mbi të gjitha të ashtuquajturat fe dhe ideologji, që i shpiku mendja e devijuar e njeriut nëpër shekuj, e ndër to edhe fenë pagane të kurejshëve.

Nga ky ajet, shohim dhe bindemi se Islami është feja që Allahu e përzgjedhi për krijesën njerëzore. Është feja e vërtetë, është feja që bart me vete porositë dhe parimet më të larta fisnike që ndonjëherë i ka njohur njerëzimi. Ky udhëzim hyjnor, i drejton zemrat drejt besimit në Allahun Fuqiplotë dhe arritjen e kënaqësisë së Tij në të dy botët. Se Islami do të ngadhënjë mbi të gjitha fetë e tjera, është për shkak se kjo fe është fe e "fitres" – natyrshmërisë së lindur në njeriun, e cila në vete nënkupton dëlirësi, pastërti, largim prej mëkateve dhe gjërave të

"Është Ai që e dërgoi të Dërguarin e Vet me udhëzim dhe fe të vërtetë, për ta lartësuar atë mbi çdo fe. Mjafton Allahu si dëshmitar!"



shëmtuara, duke mos e përlyer për asnjë çast këtë dëlirësinë shpirtërore të lindur në njeriun.

Islami është fe që shoqërinë njerëzore e bashkon nën moton: “Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!” – (El Maide, 2). Në këtë fe të ndritshme nuk ka racizëm e as dallime klasore, por të gjithë pjesëtarët e saj janë vëllezër në mes vete, sepse asnjëri prej nesh, pas vdekjes, nuk merr asgjë me vete përpos qefinit dhe ameleve të tij.

Islami është fe e diturisë dhe e punës. Shumë ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s. nxisin në meditim dhe kërkim të diturisë. Madje i Madhërishmi, ajetet e para që i zbrit nga Kurani famëlartë, fillojnë me fjalën: “*Ikreë-Lexo (mëso, studio)*”! Kjo nënkupton se jeta e njeriut nuk është statike, por gjithmonë në lëvizje dhe në kërkim të diturisë, krahas punës së mirë sipas rregullave që i ka përcaktuar Krijuesi Fuqiplotë.

Islami është fe e paqes, e mëshirë së ndërsjellë, por njëkohësisht edhe fe që të mbjell në zemër ndjenjën e dashurisë ndaj Allahut, pika kulmore e së cilës ndjenjë është flijimi dhe rënia dëshmor-shehid në emër të lartësimit të Fjalës së Tij.

E për të gjitha këto mirësi që i ngërthen në vete kjo fe, neve myslimanëve na mjafton që Allahun e kemi dëshmitar dhe garantues të këtij udhëzimi të pastër islam.

POROSIA E KËTYRE AJETEVE

- *Ëndrrat e mira (ru'ja) të pejgamberëve, janë të vërteta dhe realizmi i tyre është vetëm në Dijen dhe kompetencën e Allahut, sepse Ai di, çka ne nuk dimë.*

- *Hyrja e myslimanëve në Mekë, për umren “El Kasas”, përputhet plotësisht me premtimin e Allahut Fuqiplotë në këtë ajet, se ju do të hyni në Mekë, të qetë, do ta kryeni umren pa frikë dhe do t'i rruani ose shkurtoni flokët pas përfundimit të tavafit dhe sa'jit, ashtu siç e kërkojnë rregullat e umres.*

- *Islami, si e vetmja fe e zgjedhur nga Allahu për njeriun, do të triumfojë ndaj çdo feje a ideologjie të devijuar, sepse është e vetmja fe, që e shpjegon qartë dhe drejt besimin e pastër në Allahun, dhe është e vetmja rrugë që garanton kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimin e Tij - Xhenetin. (vijon)*

- 1 Mendimi se i Dërguari a.s. ëndrrën-ru'jen, e ka parë në Medinë, sipas shumicës dërmuese të dijetarëve është më i sakti dhe i pakontestueshëm - (Sqarim yni – S.B.).
- 2 Lubabu-n-nukuli fi esbabi-n-nuzuli, f. 237; Fet'hu -r-Rahman fi esbab nuzuli-l Kuran, f. 131.
- 3 Et-Tefsiru-l Munir, vëll. 26. f. 529.
- 4 Tefsir sureti-l Fet'h, f. 7.
- 5 Muhamed Ahmed Bashmil, Mevsuatu-l gazevatu-l kubra – Gazvetu Hajber, Xhedë, 1969, f. 6.
- 6 Lemehat fi i'xhaz suretil Fet'h, f. 26.

Operacionet plastike (ndërhyrjet estetike) dhe këndvështrimi Islam ndaj tyre

Dr. Ejup Haziri

HYRJE

Jemi dëshmitarë të një dinamike të fuqishme të ndryshimeve drastike dhe risive të papara më herët. Kjo në masë të madhe po ndodh nga zhvillimi i hovshëm i teknologjisë, i cili ka mundësuar që të arrihen gjëra që më parë ndoshta edhe kanë qenë të pa imagjinuara. Ndër këto ndryshime drastike padyshim që janë edhe operacionet plastike apo thënë ndryshe ndërhyrjet estetike, ndonëse si term “operacion plastik” përmendet edhe në të kaluarën, por atëherë kishte domethënie tejte të kufizuar, kryesisht me teknika dhe procedura tepër klasike që përshtateshin me rrethanat e atyre kohërave.

Sot, operacionet plastike në masë të madhe e kanë humbur rolin e vet primar, ngase për dallim nga e kaluara kur ato përdoreshin në raste kur një intervenim i tillë ishte më së i nevojshëm, sot janë shndërruar si një garë ku pjesëmarrësit garojnë jo për të bërë intervenime të nevojshme apo të domosdoshme, por gara bëhet në gjëra që janë krejtësisht të panevojshme, kryesisht për shfaqje e dukje sa për të marrë vëmendjen e tjerëve.

Ndërhyrjet estetike janë bërë modë dhe ato janë shndërruar në një fenomen mjaft të përhapur, i cili është inkorporuar si një modë për t'u dukur bukur. Ideja për t'u dukur sa më bukur dhe për të ndryshuar nga

konstrukti i krijuar është një tendencë mashtrimi që tenton vëmendje. Dukuria për të rënë në sy te të tjerët dhe për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve është bërë obsesion dhe sëmundje që ka kapluar tërë botën, ku personazhe të ndryshme më tepër flasin për pamjen se sa për arritjen e tyre profesionale. Mungesa e anës profesionale, mbulohet nga ana e ndryshimit në dukje. Kjo dukuri komplekse është shndërruar në një mani që ka përfshirë çdo vend. Mania për t'u dukur më bukur, për të mashtruar me vitet e jetës, me pamjen, me moshën dhe me çdo gjë tjetër.

Andaj, në këtë punim, do t'i përmendim kategorizimet kryesore të operacioneve plastike dhe ndërhyrjeve estetike, duke u munduar që secilën prej tyre ta trajtojmë nga këndvështrimi islam, në mënyrë që besimtari ta ketë një pasqyrë më të qartë se kur lejohet një ndërhyrje e tillë dhe kur ndalohet një gjë e tillë, duke dhënë edhe arsyen për një ndalesë të tillë.

ÇKA SYNOJMË ME OPERACIONET PLASTIKE?

Synimi ynë me operacionet plastike, konkretisht ndërhyrjet estetike, ka të bëjë me ndërhyrjet kirurgjike, si një term gjithëpërfshirës që ngërthen në vete një gamë të larmishme të ndërhyrjeve që kryesisht mund t'i kategorizojmë në dy grupe:

Ndërhyrjet estetike janë bërë modë dhe ato janë shndërruar në një fenomen mjaft të përhapur, i cili është inkorporuar si një modë për t'u dukur bukur. Ideja për t'u dukur sa më bukur dhe për të ndryshuar nga konstrukti i krijuar është një tendencë mashtrimi që tenton vëmendje.

I pari: Rregullimi i defekteve të pjesëve të trupit, qofshin ato defekte nga lindja apo të mëvonshme, si pasojë e ndonjë aksidenti, fatkeqësie, e të ngjashme.

I dyti: Ndërhyrja estetike, ku kryesisht bëhet për zbukurim të ndonjë pjesë të caktuar, e që realisht nuk ekziston ndonjë defekt.

Këto dy grupe, në brendësinë e tyre kanë ndarje e degëzime të tjera, ku disa dijetarë, vetëm në grupin e parë kanë bërë deri në katër kategorizime të ndryshme, megjithatë elementi i defektit është thelbësor te të gjitha ato kategorizime. Për këto grupe do të flasim në vijim.

OPERACIONET PLASTIKE TË NEVOJSHME APO TË DOMOSDOSHME

Në këtë grup kryesisht renditen defektet, dëmtimet apo edhe deformimet e ndryshme të trupit, e të cilat defekte kanë nevojë për intervenim apo ndërhyrje kirurgjikale për mënjanimin e atij defekti apo deformimi. Në disa raste, intervenimet e tilla janë të domosdoshme, për dallim nga disa intervenime të tjera ku ato janë të nevojshme, por jo të domosdoshme.

Në këtë grup hyjnë:

DEFORMIMET SI PASOJË E LINDJES APO SI PASOJË E NDONJË SËMUNDJEJE

Defektet apo dëmtimet që nga lindja, sikurse lindja e fëmijës me gishtërinj të ngjitur apo me gjashtë gishtërinj në duar apo këmbë, apo lindja e fëmijës me ndonjë defekt tjetër, si e çara në buzë, nofull, e të ngjashme, llogariten si defekte të shkaktuara nga rrethana të jashtme. Në këtë grup hyjnë edhe sëmundjet që e godasin njeriun gjatë jetës, sikur llojet e tumoreve që shkaktojnë telashe në shëndet deri te rënia e mishit nga pjesët e trupit, po ashtu edhe sëmundje të tjera, si tuberkulozi e lebra.

DEFORMIMET SI PASOJË E AKSIDENTEVE E TË NGJASHME

Në këtë grup hyjnë të metat apo deformimet që e godasin njeriun si pasojë e ndonjë aksidenti në trafik, djegia e shtëpive, zjarret e ndryshme, aksidentet me armë, si rënia në mina e të ngjashme me këto, ku dëmtimet si pasojë e këtyre aksidenteve janë kryesisht në pjesët e jashtme të trupit, si në fytyrë, kokë, duar apo në këmbë.

QËNDRIMI I ISLAMIT NË RAPORT ME KËTO GRUPE

Sa i përket qëndrimit të Islamit në raport me grupin e shpjeguar deri tani, ku deformimet apo konkretisht të metat ose janë nga lindja, ose nga ndonjë sëmundje, ose si pasojë e aksidenteve të ndryshme, mund të themi se Islami në raste të tilla lejon plotësisht ndërhyrjen kirurgjikale, ngase deformimet e tilla janë anormale, andaj, ndërhyrjet përmes operacioneve janë plotësisht legjitime dhe të mirëpritura. Në këtë fushë operacionet dhe intervenimet e tilla janë të mirëseardhura, sepse në pyetje janë deformimet apo të metat që njeriun e vënë në situata të pa lakmueshme. Shembujt e mësipërm, por dhe shembujt të tjerë të kësaj natyre e që janë të shumtë, janë të nevojshëm për ndërhyrje kirurgjikale sepse, mbetja e defektit në trup mund ta vë në pozitë të pa lakmueshme dhe atij sigurisht se mund t'i shkaktojë pengesa e vështirësi. Sigurisht se një person i tillë me një defekt të tillë, mund edhe të mos e gjejë veten në shoqëri dhe të ndihet përherë i përbuzur dhe i turpëruar, shtoj kësaj edhe bullizmin dhe përqeshjen që mund ta përjetojë në shoqëri. Përveç kësaj, ai nga trupi dhe përqeshja mund ta zgjedhë rrugën e izolimit, e cila rrugë mund ta shpie në veprime plotësisht të gabuara.

Deformimet apo të metat e tilla, dijetarët i shohin si gjëra anormale që kanë njerëzit, e të tillët kanë nevojë për



ndërhyrje, ngase intervenimi është i nevojshëm apo i domosdoshëm, varësisht nga rasti.

Se këto intervenime lejohen, dijetarët kanë sjellë argumente të bollshme edhe nga vetë jeta e të Dërguarit të Allahut, ku siç ka ardhur në hadithe, gjatë një beteje, njëri ndër luftëtarët humbi hundën dhe i Dërguari i Allahut ia lejoi atij ta zëvendësojë me një hundë fillimisht nga argjendi, e më pas prej ari. Pra, e meta e tij ishte si pasojë e luftës dhe mbetja në atë gjendje sigurisht se atë do ta vinte në një situatë aspak të favorshme, ndaj i Dërguari i Allahut ia lejoi atij të bënte ndërhyrje dhe ta evitonte atë deformim si pasojë e luftës. Po ashtu në këtë kategori hynë të gjitha hadithet që flasin për shërimin, që e shoh të panevojshme t'i sjell këtu, ngase hadithin që e solla është argumenti më i qartë dhe argumenti më praktik i mundshëm.

Ajo që është e rëndësishme në këtë grup është ekzistimi i defektit, qoftë nga lindja, apo edhe më vonë si pasojë e ndonjë incidenti apo aksidenti të ndryshëm, ku intervenimi është i lejuar, ngase në vetvete ai intervenim realizon një interes. Në këtë kontekst, siç përmend Shatibiu, qëllimi nga një operacion apo intervenim i tillë duhet të shërbejë patjetër në realizimin e një interesi.¹

NDËRHYRJET ESTETIKE

Në këtë grup ndërhyrjet janë kryesisht estetike, për bukuri shtesë, e jo për mënjanimin e ndonjë të mete apo defekti. Pra, për dallim nga grupi paraprak ku e meta dhe defekti ekzistonin, këtu nuk ekziston as e meta e as defekti. Qëllimi këtu është aparenca, dukja sa më e mirë e mundshme, perfeksionimi i pjesëve të ndryshme të trupit dhe ndryshimi i ndonjë pjesë të veçantë të trupit.

Realisht, ndërhyrjet estetike sot kanë pushtuar botën dhe janë bërë pothuajse përditshmëri nga gjeneratat më të reja për t'u dukur ndryshe e për të bërë ndryshime drastike në trupin dhe formën trupore.

Ndërhyrjet estetike ndahen në dy grupe:

Ndërhyrjet estetike të mosha kryesisht e re, si:

- Fryrja e buzëve përmes injeksioneve;
- Ndryshimin i formës së hundës, kryesisht zvogëlimi i saj apo edhe ngritja e majës së hundës;
- Ndryshimi i nofullës, ku bëhet ndërhyrje në zvogëlimin e ashtit të nofullës nëse ashti i saj është i madh dhe e kundërta;
- Implantet e faqeve;

*Gjatë një beteje,
njëri ndër
luftëtarët humbi
hundën dhe i
Dërguari i
Allahut ia lejoi
atij ta
zëvendësojë me
një hundë
fillimisht nga
argjendi, e më
pas prej ari.*

-Ndryshimi i formës së veshëve, ku bëhet një shtrirje e veshëve nga mbrapa;

-Ndryshimi i formës dhe madhësisë së gjoksit të femrat;

-Vendosja e silikonit në trup, dhe intervenime të tjera të kësaj natyre, që kryesisht janë evidente të gjeneratave të reja.

Ndërhyrjet estetike të mosha të vjetër

Në këtë kontekst janë edhe ndërhyrjet që bëhen kryesisht në fytyrë, si:

-Ndërhyrjet për mënjanimin e rrudhave në fytyrë;

-Mënjanimi i shenjave të plakjes;

-Ndërhyrjet në vetulla, e intervenime të tjera të kësaj natyre, që kryesisht bëhet të gjeneratave të vjetër, duke dashur t'i shmangin pasojat e pleqërisë.²

QËNDRIMI I ISLAMIT NË RAPORT ME NDËRHYRJET ESTETIKE

Ndryshimet e panevojshme në trup, si fryrja e buzëve përmes injeksioneve, ndërhyrjet për ndryshimin e formës së hundës, me theks të veçantë zvogëlimi i hundës, ndryshimi i formës së nofullës dhe faqes, ndryshimi i formës dhe madhësisë së gjoksit të femrat, vendosja e silikonit (botox) në trup dhe intervenime të tjera të kësaj natyre, që kryesisht gjejnë aplikim të gjeneratave të reja, janë jo të domosdoshme e plotësisht të panevojshme, dhe kur mungon elementi i nevojshmërisë për një ndërhyrje të tillë, atëherë një veprim i tillë konsiderohet i ndaluar, ngase baza e kësaj dispozite është mbetja në esencë e çdo organi të trupit, ashtu siç e ka krijuar Allahu, me përjashtim të rasteve kur ka deformime apo të mete, atëherë në raste të tilla Islami e lejon rregullimin e asaj të mete, rikthimin në funksion të organit, përndryshe një gjë e tillë mbetet e ndaluar, dhe kjo për faktin se:

Islami nuk ia lejon njeriut ndryshimin e konstruktit pa pasur nevojë

Allahu i Madhëruar e krijoi njeriun në formën më të bukur, ndaj edhe tha në Kuran: “Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.” (Et Tin, 4). Gjithashtu thotë: “Allahu është Ai që ua bëri tokën vendbanim e qiellin kulm, dhe ju formësoi, e formën tuaj e bëri më të mirë dhe ju pajisi me të mira.” (Gafir, 64).

Allahu është i bukur dhe e do të bukurën, ashtu siç përshkruhet në hadithe. Megjithatë kur ndërhyrjet janë jo të domosdoshme e as të nevojshme, atëherë marrin tjetër karakter. Në këtë çështje ndërhyrjet vijnë si pasojë jo vetëm për t'u dukur më bukur, por edhe për të ndryshuar pjesë të caktuara të trupit. Islami nuk e ndalon rregullimin e as bukurinë, ai e ndalon ndryshimin që individi e bën pa



nevojë, ngase Islami synon që njeriu ta ruaj me fanatizëm konstruktin që ia dha Krijuesi e të mos i tejkalojë kufijtë e të lejuarës asnjëherë.

DJALLI DËSHIRON QË NJERIU TA NDRYSHOJË FORMËN E VET

E nëse njeriu i tejkalon ata kufij, atëherë ai do të bëhet vegël e djallit, i cili iu kishte betuar Allahut se ai do të bëj çmos derisa ta mashtrorë njeriun për ndryshimin (lexo shëmtimin) e konstruktit që ka: "...do t'i urdhëroj dhe ata do të ndryshojnë (shëmtojnë) krijesat e Allahut. E kush bën mik djallin, e jo Allahun, ai ka dështuar sheshazi." (En Nisa, 119). Nga kjo qartazi kuptohet se ai s'do t'i ndalojë përpjekjet e tij gjersa individit të mos e shëmtojë veten e vet. Ky ajet shfaq gjërat e ndaluara që shejtani i inkurajon të pabindurit të bëjnë, e në mesin e tyre edhe ndryshimin e krijimtarisë.³

Ndërhyrjet estetike pa ndonjë interes dhe pa nevojë

Dijetarët kanë përmendur se ajo çfarë e bën të lejuar ndërhyrjen apo operacionin është nevoja e individit për ndërhyrje, në të kundërtën është e ndaluar.⁴ Kur ndërhyrja nuk sjell ndonjë interes apo përfitim, Islami një gjë të tillë nuk e merr as në konsideratë. Si rrjedhojë e kësaj, nga ndërhyrjet estetike, nuk arrihet ndonjë interes sipas konceptit islam e as një gjë e tillë nuk konsiderohet si e nevojshme. Si rrjedhojë nga kjo mani e ndryshimit, sikur njeriu po bën një hap tutje të pakënaqësisë ndaj konstruktit të tij nga ana e Krijuesit.

Ndërhyrjet e tilla mund të sjellin mallkim

Abdullah ibën Mesudi ka thënë: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: "Allahu i mallkoftë ato që bëjnë tatuazh dhe ato që kërkojnë t'u bëhet tatuazh, ato që ndukin qimet e vetullave dhe ato që kërkojnë t'u nduken (vetullat); ato që bëjnë veprime për t'i larguar dhëmbët (nga

njëri-tjetri) që të duken më të bukura, dhe ato që ndryshojnë natyrshmërinë e krijimtarisë së Allahut."⁵ Ky hadith sipas dijetarëve ngërthen në vete dy gjëra të rëndësishme: Estetikën (pamjen e jashtme), për të bërë gjëra të ndryshme sa për t'u dukur e bukur dhe ndryshimin e pamjes deri në atë masë të ndryshimit të natyrshmërisë së saj. Realisht këto gjëra janë evidente gjatë ndërhyrjeve estetike.

Ndërhyrjet estetike nuk janë edhe pa rreziqe

Përveç atyre që i përmendëm, duhet të mos e anashkalojmë faktin se janë qindra raste të vajzave të reja që kanë vdekur si pasojë e operacioneve plastike, ku gjithçka nuk shkoi sipas planeve të tyre. Pra, ndërhyrjet e tilla nuk janë pa rreziqe. Shumë raste të tjera fatmirësisht nuk përfunduan me fatalitet, por ndërhyrjet ishin të pa suksesshme dhe se pastaj ato patën nevojë edhe për ndërhyrje të tjera për ta përmirësuar ndërhyrjen e parë.

Keqpërdorimi i ndërhyrjeve nga kriminelët

Kjo e arritur e madhe është keqpërdorur nga shumë kriminelë të kërkuar, të cilët për t'u ikur dënimeve të ndryshme kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale dhe kështu kanë ndryshuar edhe pamjen e tyre. Realisht vetëm keqpërdorimi i ndërhyrjeve kirurgjikale nuk e bën të ndaluar atë, ngase gjithçka varet nga përdorimi, por duke ia bashkangjitur edhe arsyet e tjera që i përmendëm më lartë, bëhet e qartë se ndërhyrjet estetike të llojeve të fundit, që sot janë shumë në trend, janë të ndaluara.

MESAZH PËR FUND

U munduam t'i ndajmë këto problematika, duke shpjeguar llojet e operacioneve plastike dhe të ndërhyrjeve estetike, që nuk janë të njëjta dhe realisht edhe qëndrimi fetar nuk është i njëjtë, ngase, siç kam shpjeguar, nganjëherë ndërhyrja kirurgjike mund të jetë e domosdoshme apo e nevojshme, e herë të tjera ajo mund të jetë krejtësisht e ndaluar dhe e panevojshme, siç janë ndërhyrjet estetike, të cilat janë asgjë më tepër se një ujëvarë mashtrimi dhe një pamje që të gënjen.

Ndërhyrjet estetike, kur njeriu nuk ka as të metë e as ndonjë deformim, është një bukuri sipërfaqësore e vezulluese, e cila tretet shumë më shpejt se sa që mendohet, ngase është farsë mashtrimi dhe investim sfidues ndaj kohës dhe plakjes, gjë që në fund rezulton pasuksesshëm. Çdo përpjekje për të dalë nga vetvetja është mashtrim dhe çdo sfidim për të ndalur plakjen dhe shenjat e saj është dështim!

1 Shatibiu, El Muvafekat fi Usuli-l Ahkam, boton: Daru-l Fikr, Liban, 1341h, v.II, f.127.

2 Hasen el Kazvini, Fen Xhirahatu-t Texhmil, Paris, pa vit botimi, f.39-54; Grup autorësh, përgatiti Muhamed Ref'at, El Amelijat el Xhirahijeh ve Xhirahatu-t Texhmil, boton: Daru-l Ma'rifeh, 1405h, bot.IV-të, f.136-150.

3 Shinkit, Ahkamul-l Xhiraheti-t Tibbijeh, El athar el muterettebetu alejha, bot.II, 1994, f.194.

4 Shinkiti, Ahkamul-l Xhiraheti-t Tibbijeh, El athar el muterettebetu alejha, bot.II, 1994, f.105.

5 Buhariu në Sahih dhe Muslimi në Sahih. Hadithi është autentik.

Qëndrimi i së drejtës islame ndaj tatuazheve

Dr. Flamur Sofiu

HYRJE

Sipas parimeve islame, njeriu është krijesa më e bukur dhe e krijuar në formën më të përsosur. Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: “Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer.” (Et Tin, 4). Andaj, çdo revanshizëm në këtë aspekt është i pa pranueshëm dhe i dështuar thellësisht. Prandaj njeriu që ka mendjen e shëndosh duhet të jetë vigjilent nga pasojat negative që mund të vijnë në të gjitha aspektet e jetës, qoftë aspekti fetar, shëndetësor, shoqëror etj.. Myslimanit i kërkohet që të mos lëshohet në veprime dhe sjellje të pa kontrolluara dhe me pasoja të mëdha negative. Po ashtu, ne si myslimanë jemi të urdhëruar që ta çmojmë dhe ta ruajmë njeriun si në aspektin fizik ashtu edhe në atë shpirtëror.

GJENEZA E FENOMENIT TË TATUAZHEVE

Fenomeni i tatuazhit është i njohur që në kohërat e vjetra dhe ka prejardhje pagane. Tatuazhet janë përdorur qysh prej kohës së faraonëve dhe po ashtu janë përdorur edhe nga asirianët dhe kinezët qysh nga kohërat e hershme.

Një praktikë e këtillë ka qenë e përhapur edhe tek arabët në periudhën para-islame për qëllime zbukurimi, ose ka shërbyer për identifikimin e përkatësisë së klanit përkatës.

Pa dyshim, në kohën bashkëkohore, kur shkenca ka arritur në shkallë të lartë, risitë shkencore mundësojnë që njeriu të fus në

praktikë traditat dhe zakonet e paganizmit, duke u munduar që të ndërroj emërtimin, por që thelbi është i njëjtë.

Rreth fenomenit të tatuazhit janë bërë shpjegime të hollësishme nga dijetarët myslimanë, qofshin ata klasikë apo bashkëkohorë.

Në këtë punim do të përcaktohem vetëm në aspektin fetar, çfarë thotë e drejta islame për fenomenin në fjalë, e sa i takon aspektit shëndetësor, nëse këto tatuazhe janë të dëmshme ose jo, nuk na takon neve të shprehim mendim për faktin se kjo është kompetencë e ekspertëve të mjekësisë, dhe janë ata që duhet të shfaqin opinionet e tyre profesionale për këtë dukuri.

Kur shohim reagimet e Pejgamberit a.s. ndaj këtij fenomeni, do të kuptojmë qartë se ky fenomen është i ndaluar në mënyrë shumë të qartë dhe të prerë. Në bazë të asaj që transmeton Ibën Umeri r.a., Pejgamberi a.s ka thënë: “Allahu e ka mallkuar një zonjë të tillë që i zgjat flokët (e saj apo të dikujt tjetër) në mënyrë artificiale ose i zgjat, si dhe një zonjë që bën tatuazhe (veten apo dikë tjetër) ose e bën veten tatuazh.”¹ Mallkimi i shprehur në hadith përfshin të dy gjinitë, si femrat ashtu edhe meshkujt.

URTËSITË E NDALESËS SË TATUAZHIT

Sa u përket urtësive të ndalesës së tatuazhit ato mund të jenë të shumta, por thelbësore është se me tatuazh bëhet përpjekje për të ndryshuar krijimtarinë e Allahut të Madhërishëm, andaj një

Fenomeni i tatuazhit është i njohur që në kohërat e vjetra dhe ka prejardhje pagane.



përpjekje e atillë është e ndaluar rreptësisht. Këtë e kuptojmë qartë nga fjala e Allahut: “Do t’i shmangë (nga e vërteta), do t’i bëjë të shpresojnë në gjëra të kota; do t’i urdhëroj dhe ata do të shqyejnë veshët e bagëtive; do t’i urdhëroj dhe ata do të shëmtojnë krijesat e Allahut. E kush e bën mik djallin, e jo Allahun, ai ka dështuar sheshazi.” (En Nisa, 119). Po ashtu mund të përmendim edhe këto urtësi të ndalesës së tatuazhit që i kanë përmendur disa nga juristët myslimanë:

E para: tatuazhi është një lloj mashtrimi dhe ndryshim i asaj që ka krijuar Allahut,

E dyta: në vendosjen e tatuazhit ka dhimbje, ngase futet gjilpëra poshtë lëkurës dhe më këtë ka mundim të trupit, e që dihet se në aspektin fetar është e ndaluar rreptësisht dëmtimi i vetës apo tjetrit pa nevojë të domosdoshme.

E treta: tatuazhi është një veprim që e ngjason njeriun me njerëz mëkatar dhe injorantë. Dijetari i mirënjohur, Mulla Alij el Kariji ka thënë: “Është e ndaluar bërja e tatuazhit për shkak se konsiderohet si vepër e mëkatarëve dhe injorantëve dhe se më këtë bëhet ndryshim në atë që ka krijuar Zoti.”²

E katërta: tatuazhi shkakton papastërti në vendin ku bëhet, ngase përzihet me gjakun ngjyra e atillë. Imam Neveviu ka thënë: “Sipas nesh (shafitëve) vendi ku është bërë tatuazhi është vend i ndyrë.”³

Rreth qëndrimit islam për këtë dukuri, dijetarët kanë shprehur mendimet dhe qëndrimet e tyre.

Në parim, të gjithë dijetarët janë të mendimit se të bërit tatuazh është vepër e ndaluar rreptësisht, duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberit a.s., të cilin e përmendem më lartë, ku përmendej mallkimi për atë që bënë tatuazhe, si për të tjerët ashtu edhe për vetën.

TATUAZHI NDAHET NË DY LLOJE:

Tatuazhi që është i përhershëm, dhe

Tatuazhi i përkohshëm.

Sa i përket llojit të parë të tatuazhit, që të gjithë dijetarët klasikë dhe bashkëkohorë janë të një mendimi se është vepër e ndaluar. Bile disa nga juristët myslimanë të medhhebit maliki dhe shafi, e konsiderojnë tatuazhin prej mëkateve të mëdha.⁴ Po ashtu, disa nga dijetarët, fenomenin e të bërit tatuazh e ndajnë në dy situata:

a. kur bëhet vetëm për dëshirë të personit, kjo është e ndaluar rreptësisht (haram), dhe

b. kur ndodh që të bëhet tatuazh si formë e shërimit nga sëmundja, në këtë rast mendojnë se lejohet duke u bazuar në rregullën e sheriatit “nevoja e jashtëzakonshme e bënë të lejuar atë që është e ndaluar”.

Ndërsa sa i përket tatuazhit të përkohshëm, që me këtë nënkuptohet të bërit tatuazh që mund të fshihet dhe eliminohet pa kurrfarë problemi dhe se nuk është i atillë që futet brenda nën lëkurë. Bile ky lloj i tatuazhit nuk duhet të emërtohet si tatuazh, por të konsiderohet një lloj vizatimi sikur që është rasti më kanën,⁵ dijetarët për këtë lloj tatuazhi janë të mendimit se lejohet nëse i plotëson kushtet me sa vijon:

Që vizatimi të jetë i përkohshëm dhe që eliminohet lehtë;

Që të mos vizatohen pamje të gjallesave që kanë shpirt;

Që këtë formë të zbukurimet të mos ia shpalosë femra askujt, pos burrit të saj;

Që në vizatime të atilla të mos kihet ngjashmëri me mëkatarët dhe jo besimtarët;

Që në këto vizatime të mos përdoren llojet e ngjyrave që mund të jenë të dëmshme për lëkurën dhe shëndetin;

Që vizatimet të mos përmbajnë në vete përmbajtje që madhësojnë ritualet e ndonjë besimi tjetër apo ndonjë programi devijues;

Vizatimi te femra duhet ta bëjë vetëm femra dhe se vizatimet e tilla të mos bëhen në pjesët e turpshme.

Po që se plotësohen këto kushte, ne nuk shohim ndonjë pengesë për këtë dhe se këtë lloj të tatuazhit, gjegjësisht vizatimit, e konsiderojmë të lejuar.⁶

QENDRA PËR FETVA ELEKTRONIKE AL AZHAR NDALOI TATUAZHET PËR BURRAT DHE GRATË

Fetvaja i përshkruan tatuazhet si “një nga mëkatet e mëdha”.

Qendra, e cila është një nga organet fetva të lidhura me Al Azhar, përjashtoi vetëm dy raste nga kjo: kur tatuazhi është një trajtim për një sëmundje, ose kur vizatohet me materiale që hiqen lehtë, si këna.

Fetvaja, e cila u publikua në një deklaratë në Facebook, thoshte: “Forma bashkëkohore e tatuazhit konsiston në futjen e ngjyrave në shtresat e brendshme të lëkurës, duke shpuar me një gjilpërë të lidhur me një pajisje të vogël që mban një tub, i cili përmban një ngjyrë dhe kur gjilpëra futet në pjesën e tatuazhuar, një pikë e vogël boje hyn në trup. Shtresat e brendshme të lëkurës përzihen me gjak dhe më pas efekti i këtij procesi mbetet për gjithë jetën, ose zgjat 6 muaj ose më shumë.”

Deklarata shpjegoi se vendimi për tatuazhet në Islam është “ndalesë e prerë (haram)”. Po ashtu kjo deklaratë thotë: “Disa juristë i konsiderojnë tatuazhet si një prej mëkateve të mëdha” dhe theksoi se vendimi juridik islam “përfshin njësoj burrat dhe gratë”.

Deklarata shtoi: “Tatuazhet transmetojnë sëmundje të transmetuara nga gjaku si virusi i hepatitit C dhe HIV AIDS, nëse makinat e përdorura janë të kontaminuara.”

Arti i tatuazhit ka filluar të përhapet kohët e fundit në botën arabe, veçanërisht te të rinjtë, megjithëse shumë shoqëri, veçanërisht ato konservatore, e konsiderojnë atë të ndaluar, madje disa vende kanë nxjerrë ligje dhe legjislacion që e ndalojnë atë.

Periodha e fundit ka dëshmuar hapjen e shkollave për mësimin e tatuazheve në disa vende arabe, pasi disa prej tyre kërkojnë një certifikatë akademike për të marrë leje për ushtrimin e profesionit.

Shoqëritë arabe i kanë njohur tatuazhet që nga kohërat e lashta. Disa gra në zona të ndryshme të fshatrave arabe, disa fise dhe klane, si dhe komunitetet e shkretëtirës, përdornin tatuazhe në fytyrë për dekorim, për të treguar bukurinë dhe ndonjëherë për trajtim.

Qytetërimet e lashta, si persët, asirianët dhe kinezët, përdorën tatuazhe për qëllime të shumta, duke përfshirë trajtimin, dekorimin, mbrojtjen nga shpirtrat e këqij dhe gjithashtu për të treguar guxim.

Kohët e fundit u zbulua se njerëzit e parë që përdorën tatuazhet ishin faraonët, pasi tatuazhi më i vjetër piktural në botë u gjet në një palë mumie egjiptiane që janë pesë mijë vjeçare.

“Tatuazhi më i vjetër” në botë u zbulua në një mumie egjiptiane 5000-vjeçare.

A do të bëhen të pranueshme tatuazhet në trup në vendin e punës?

Tatuazhet janë përdorur kohët e fundit si pjesë e trajtimit psikologjik për pacientët me kancer gjiri, pasi tatuazhet vizatohen te femrat dhe meshkujt të cilëve u është hequr gjoksi.

Mund të mendohet se vendet ku tatuazhet janë të zakonshme do ta pranonin më shumë këtë art, por nuk është gjithmonë kështu. Hulumtimi i kryer nga Christine Broussard dhe Helen Harton për Universitetin e Iowa-s Veriore, tregoi se edhe në Shtetet e Bashkuara, tatuazhet që mbulojnë të gjithë krahun mund të lidhen me stigmën sociale.⁷

FETVAJA PËR TATUAZHIN

Nëse dikush pyet: A janë të ndaluara tatuazhet, apo a është mëkat i madh ai, si dhe a do të hyjë në Xhenet ai që ka tatuazh dhe cila vepër mundëson shlyerjen e këtij mëkati?

Përgjigja është:

Tatuazhi është i ndaluar dhe është prej mëkateve të mëdha, sepse Pejgamberi, lavdia dhe paqja e Zotit qofshin mbi të, e mallkoi atë që e bën atë, si në hadithin e Abdullah bin Omerit, Allahu qoftë i kënaqur me të dy, i cili tha: “I Dërguari i Zotit, lavdia dhe paqja e Zotit qofshin mbi të, ka thënë: “Allahu e



mallkoftë atë që bën tatuazh dhe atë që është bërë në të tatuazh.” Transmetohet nga Buhariu.

Imam Dhehebiu – dhe të tjerët – tatuazhin e konsideruan si një mëkat të madh, si një mëkat që mbart një dënim në këtë botë ose një kërcënim në jetën e përtejme me mallkime ose ndëshkime e të ngjashme.

Kushdo që e bënë tatuazhin, duhet të pendohet te Zoti i Madhëruar dhe kushdo që e bën këtë, duhet të nxitojë për ta hequr atë, përveç nëse i frikësohet dëmtimit serioz të trupit nga heqja e tij, në këtë rast mjafton pendimi i sinqertë.

Sa i përket hyrjes në Xhenet, nëse ai që bën një mëkat të madh pendohet prej tij, Zoti ia pranon pendimin, e nëse vdes para se të pendohet, puna e tij i takon Zotit, nëse do, do ta dënojë, nëse do, do ta falë, por ai nuk do të mbetet përgjithmonë në Xhehenem nëse vdes, duke mos i bërë shok Zotit nëse është monoteist.

Zoti e di më së miri!⁸

TATUAZHI ËSHTË NDYRËSIRË, POR A E PENGON KRYERJEN E NAMAZIT?

Pasi tatuazhi konsiderohet si ndyrësirë (nexhaset), atëherë lind pyetja se çfarë duhet të veprojë personi që e ka bërë tatuazhin në rastin e faljes së namazit? Juristët myslimanë ndajnë mendimet e tyre rreth kësaj çështje.

Të gjithë fukahatë janë të mendimit se tatuazhi që është përzier me gjakun është ndyrësirë, ndërsa për atë se a duhet eliminuar tatuazhin, shumica e fukahave janë të mendimit se nuk është e domosdoshme heqja e tatuazhit nëse shkakton dëme dhe sjell mundime.

Hanefitë janë të mendimit se duhet larë vendi i tatuazhit dhe se nuk kërkohet të eliminohet për shkak se shkakton mundim dhe dëmtim të trupit, por që pas pastrimit të vendit të tatuazhit, namazi është i vlefshëm.⁹

Malikitë janë të mendimi se nuk është obligim largimi i tatuazhit, por konsiderohet si ndyrësirë që lirohet personi nga ajo, dhe namazi me të është i vlefshëm. Shafitë janë të mendimi se tatuazhi është ndyrësirë që duhet doemos të eliminohet nëse nuk shkakton dëme në trup, e nëse ekziston frika e dëmtimit, atëherë duhet penduar për këtë veprim dhe se namazi është i vlefshëm.

Ndërsa hanbelitë janë të mendimit se nuk kërkohet të largohet tatuazhi, ngase në këtë mënyrë ruhet dëmtimi i gjymtyrëve të trupit.¹⁰

Hanefitë janë të mendimit se duhet larë vendi i tatuazhit dhe se nuk kërkohet të eliminohet për shkak se shkakton mundim dhe dëmtim të trupit, por që pas pastrimit të vendit të tatuazhit, namazi është i vlefshëm.

MARRJA E SHPËRBLIMIT PËR BËRJEN E TATUAZHIT

Të gjithë juristët myslimanë janë të mendimit se marrja e shpërblimit për bërjen e tatuazhit të përhershëm është haram dhe konsiderohet mëkat. Këta mendimin e tyre e mbështesin në hadithin e Pejgamberit a.s. ku thotë: “E ka ndaluar që dikush t’i bëjë tatuazh dikujt dhe që të bëjë tatuazh në vetën e tij.”¹¹

PËRMBYLLJE

Të gjithë juristët myslimanë, si klasikët po ashtu edhe ata bashkëkohorë janë të një mendimi se tatuazhet e përhershme janë të ndaluara dhe se konsiderohen si mëkat i rëndë.

Ndërsa sa u përket vizatimeve të përkohshme, që mund largohen shpejt dhe pa pasoja, lejohen duke i plotësuar kushtet e përmendura më lartë. Ky lejim për këto lloje të vizatimeve të përkohshme bazohet në analogjinë e bërë në zbukurimet me kanë.

Po qe se është e mundur të largohet tatuazhi nga trupi, por duke mos shkaktuar pasoja në trup apo brenda në organizëm, duhet të eliminohet i njëjti, njëkohësisht personi duhet edhe të kërkojë falje tek Allahu i Lartësuar duke u penduar për gabimin e bërë.

Pasi që Allahu i Madhërishëm në Kuran sinjalizon se krijimi i njeriut është në formën më të bukur dhe më të përsosur, atëherë myslimani duhet të jetë vigjilent nga pasojat negative në aspektin fetar, po ashtu edhe në atë shëndetësor, duke u ruajtur kultivimi i traditave dhe veseve për të cilat feja slame me kohë është distancuar.

Myslimanit i mbetet të jetë i kujdesshëm duke mos i lejuar vetës që në asnjë mënyrë të lëshohet në veprime të pakontrolluara dhe të dëmshme.

1 Buhariu, Kitabul-Libas hadithi nr. 5937.

2 Mulla Alij el- Kariji, Mirkatul Mefatih, boton Darul Fikr, pa vit botimi, vëll. V, fq. 1895.

3 En Neveviju, El Minhaxh Sherhu Sahihi Muslim, boton Daru Ihjai Turathil Arebij, vëll. XIV, fq. 106.

4 Grup autorësh, El Meusuat El Fikhijetu El Kuvejtijetu, boton Ministria e Vakëfit të Kuvajtit, viti 2007, fq. 158-159.

5 Këna ose kâna (Arabisht: كَئِنَاء) është një ngjyrë e përgatitur nga bima Lawsonia inermis.

6 <https://islamqa.info/ar/answers/99629>

7 <https://www.bbc.com/arabic/art-and-culture-58213924>

8 <https://www.islamweb.net/ar/fatwa/26402>

9 Ibën Abidin, Ed Durrul Muhtar ve Haxhijet Ibën Abidin, boton Alemul Kutub, 2007, fq. 424

10 Mahmud es Subkij, Ed Dinul Halisu Eu Irshadul Halki Ila Dinil Hakki, boton El Mektebetul Mahmudijetu es Subkijetu, 2006, fq. 231.

11 Buhariu, Kitabul Buju, hadithi nr. 2086.



Muhamedi a.s., në mes modestisë dhe pedanterisë

Dr. Zenel Hajdini

Në kohën para lindjes së Muhamedit a.s., shoqëria njerëzore ishte në gjendjen më të ulët që ka njohur historia. Për shkak të kësaj gjendjeje, edhe historianët, atë periudhë kohore e quajtën koha e injorancës, sepse vlerat dhe virtytet njerëzore kishin humbur tërësisht. Mirëpo, deshi Allahu të lëshojë mëshirë mbi njerëzimin, dhe këtë mëshirë e solli me dërgimin e të Dërguarit të Tij, Muhamedit a.s., i cili për mision kishte ngritjen e këtyre vlerave shpirtërore, shoqërore e humane. Për këtë arsye, shembulli dhe personaliteti i Pejgamberit a.s., do të mbetet sinonim i virtyteve më të larta njerëzore. Kështu, Allahu na lajmëroi në Kuranin famëlartë: “Në të dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm...” (El Ahzab, 21).

Pra, Allahu me urtësinë e Tij, bëri që ky njeri të merret shembull nëpër të gjitha epokat historike pasuese, aspekte specifike të të cilit do të jenë modestia, përlulësia e pedanteria.

ÇFARË DO TË THOTË TË JESH NJERI MODEST, NJËKOHËSISHT DHE PEDANT?

Nëse i shikojmë fjalorët e gjuhës shqipe, gjejmë se njeri modest është ai i cili nuk mburret me aftësitë që zotëron, ose për punën e rëndësishme që bën, ose që nuk e mbivlerëson vetveten. Pra, modesti është thjeshtësia dhe pranimitet në vërtetë.

Ndërsa të jesh njeri pedant është të jesh njeri që të interesojnë gjërat në detaje, në hollësi.

Andaj, me këtë temë kemi për qëllim ta vëmë në pah anën e brendshme që kishte Pejgamberi a.s., dhe reflektimi i saj në të jashtmen e tij.

Allahu i Lartësuar e ngriti Muhamedin a.s., nga njerëzit e tjerë me atë se e bëri pejgamber, e nga pejgamberët e tjerë e dalloj pasiqë e bëri vulë të pejgamberisë dhe e dërgoi për njerëzimin mbarë. Megjithatë, ai zgjodhi ta jetojë jetën e qetë

*“Në të dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm...”
(El Ahzab, 21).*

dhe modeste, larg krenarisë dhe mendjemadhësisë, saqë edhe kur iu ofrua të zgjedh në mes asaj që të jetë mbret dhe i dërguar ose rob dhe i dërguar, ai zgjodhi të jetë rob dhe i dërguar.

Prandaj, në një hadith Pejgamberi a.s., thotë: “Unë jam Muhamedi i biri i Abdullahut, rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij, nuk dëshiroj të më ngrehni më lartë sesa aq sa më ka ngritur Allahu.” (Imam Ahmedi, 12551).¹

Ky ishte i Dërguari i Allahut që ishte i afërt me çdokënd, i ndihmonte çdokujt, luante edhe me fëmijët dhe ishte modest në

shtëpinë e tij. Ai nuk përtoi t'i kryente edhe punët e shtëpisë. Kur u pyet Aisheja r.a., se çka bën Pejgamberi a.s., në shtëpi, ajo u përgjigj: “I qep rrobat e tij, i rregullon mbathjet e tij dhe punon atë çka e punojnë burrat në shtëpitë e tyre.” (Imam Ahmedi, 24903).²

Ky ishte i Dërguari i Allahut që edhe pse ishte prijës i besimtarëve, kurrë nuk e ndjeu vetën mbi të tjerët. Një ditë, një njeri shkoi te Pejgamberi a.s., dhe kur u takuan filloi të dridhej nga emocionet. Pejgamberi a.s., i tha: “Qetësohu, sepse unë nuk jam mbret, por jam bir i një nëne kurejshite që hante mish të tharë.” (Ibën Maxheh, 3312).³ Kjo, sepse njeriu modest, nuk mashtrohet nga pozita dhe pasuria e kësaj bote.

Po ashtu, me rastin e çlirimit të Mekës, Pejgamberi a.s., edhe pse ishte prijës i besimtarëve, nuk hyri në Meke me kokën lart nga mendjemadhësia, por hyri me modesti e krenari për besimin që kishte dhe faljen që do t'ua bënte.

Çfarë modestie përmbante zemra e këtij të Dërguari?! Hapi krahët për të gjithë që kishin nevojë; i madh e i vogël, i afërt e i largët, i pasur e i varfër... Ai ulej edhe me fëmijët e i ngushëllonte nëse u ndodhte ndonjë fatkeqësi, siç është rasti me djalosin të cilin e ngushëllloi për pëllumbin e tij të ngordhur.



Ky
ishite i

Dërguari
i Allahut që

brenda natës u
ngrit mbi shtatë qiejt,

ndërsa në mëngjes u ulë me të

varfrit, të ngratët, jetimët, hallexhitë... ishte në gjendje të
dëgjojë me orë të tëra brengat që kishin njerëzit.

Pra, nga e gjithë kjo, bëhet e qartë se modesti është të sillesh
mirë me njerëzit, çfarëdo pozite që kanë në shoqëri, të pasur
apo të varfër, të fortë apo të dobët, të respektuar apo të
përbuzur, ndërsa e kundërta e saj është mendjemadhësi.

Prandaj, Pejgamberi a.s., në një hadith tregoi për një dënim
të dhembshur që do të jetë në Ditën e Gjykimit, për ata që
modestia nuk është cilësi e tyre në këtë botë: "Janë tre lloje
njerëzish me të cilët, Ditën e Kiametit, Allahu nuk do të flasë,
të cilët nuk do t'i shohë në fytyrë dhe nuk do t'i nxjerrë të
pastër (të pafajshëm). Dhe për ta do të ketë një ndëshkim
përvëlues." Pasi i Dërguari i Allahut e përsëriti tri herë këtë
thënie, Ebu Dheri r.a., e pyeti: "Këta njerëz paskan mbetur
krejt të vetmuar dhe paskan pësuar disfatë të plotë. Kush janë
këta, o i Dërguari i Allahut?" I Dërguari i Allahut iu përgjigj:
"Janë ata që ecin duke e hequr zvarrë rrobën me
mendjemadhësi, që mbahen më të madh për të mirën që
kanë bërë dhe që, duke u betuar në gënjeshtëri, përpiqen ta
shesin mallin me një çmim të mirë." (Muslim, 171).⁴

Pra, mendjemadhësia dhe mbajtja e vetës më të madh janë
aq veti të këqija saqë e privojnë njeriun nga mundësia që Zoti
t'i flasë, ta shikojë e ta fal në momentin më të vështirë të tij.
Dhe përkundër kësaj modestie që kishte, ai, alejhi selam, i
kushtoi rëndësi të veçantë edhe anës së jashtme, dukjes së tij.
Pasi që modestia nuk është vetëm të ecësh me kokë ulur, me
rroba jo të mira, me trup të dobët e të rraskapitur. Kujto kur
Llukmani e këshilloi birin e tij i tha: "*Të jesh i matur në ecjen
tënde...*" (Llukman, 19). Jo me kokë ulur, por me shikim ulur!

Fillimisht, rëndësi të veçantë i kushtoi përgatitjes për
namaz. Para se të nisim namazin, adhurimin tonë të
përditshëm, mësimet kuranore na porositin që të kemi rroba
të pastra. Për këtë erdhi urdhri nga Allahu në Kuranin
famëlartë: "*O bijtë e Ademit, vishuni bukur kudo dhe kurdo që
të faleni!*" (El E'araf, 31). Dhe nuk mjaftoi vetëm për adhurim,

por na porositi që rrobat tona të jenë të pastra çdoherë: "Dhe
rrobat tua pastroji." (El Muddethir, 4).

Pastaj, prej natyrshmërisë së njeriut është se ai dëshiron të
ketë trup, veshje e mbathje të bukura, të pastra. Për këtë,
transmeton Ibën Mesudi r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë:
"Nuk do të hyjë në Xhenet askush në zemrën e të cilit gjendet
sa grimca mendjemadhësi." Një njeri i tha: "Por, nëse ndokush
dëshiron që rroba e tij të jetë e mirë (bukur), dhe mbathjet e
tij të mira?" Ai a.s., tha: "Allahu është i bukur dhe e do të
bukurën, ndërsa mendjemadhësia është refuzim i së vërtetës
dhe poshtërim i njerëzve." (Muslim, 147).⁵

Po ashtu, porosia për përdorimin e misvakut para namazit,
parapëlqimi i miskut dhe nxitja e përdorimit të tij tregojnë
për një kujdes të veçantë që ka pasur Pejgamberi a.s., ndaj
anës së jashtme.

Gjithashtu, transmeton Xhabiri r.a., se një ditë erdhi i
Dërguari a.s., dhe pa një njeri që flokët e tij ishin të
shprishura dhe tha: "A nuk ka gjetur ai diçka që t'i rregullojë
flokët e tij?" Ndërsa një tjetër kishte rrobën e tij të ndotur
dhe tha: "Ai, a nuk ka gjetur ujë që ta pastrojë rrobën e tij?"
(Ebu Davud, 4062).⁶

Pas gjithë këtij kujdesi që ka pasur Pejgamberi a.s., për
anën e jashtme të tij dhe të shokëve të tij, nuk është për t'u
habitur ajo që është transmetuar se kur një i huaj i është
afuar rrethit ku qëndronte Pejgamberi a.s., me shokët e tij,
nuk ka dalluar se cili është i Dërguari a.s., në mesin e tyre.
Kjo, për shkak të modestisë së tij që ka pasur, përkundër
pozitës së tij dhe tjetra është pikërisht kujdesi që i ka kushtuar
Pejgamberi a.s., dukjes së jashtme. Ai nuk pranoi që në mesin
e tyre të jetë një njeri që ka flokët e shprishura e rrobat e
ndyra. E si do të ishte pedanteria e tij?!

Këto ishin vetëm disa nga shembujt e Pejgamberit a.s., sa i
përket modestisë dhe pedanterisë së tij, që tregojnë se
Pejgamberi a.s., aq sa i kushtoi rëndësi anës së brendshme të
tij, po aq i kushtoi edhe të jashtmes apo dukjes së tij, e që për
besimtarin është që ta marrë shembull atë, ashtu siç na
porosit Allahu në librin e Tij: "*Në tregimet e atyre (të
dërguarve) ka këshilla për ata që meditojnë!*" (Jusuf, 111).

1 Ahmed bin Hanbel esh Shejbanij, Musned Imam Ahmed, (Mueseseh er Risaleh, Lubnan, 2001), v20, f.23. Ka thënë shejh Shuajbi, hadithi është i vërtetë në kushtet e Muslimit.

2 Ahmed bin Hanbel esh Shejbanij, Musned Imam Ahmed, (Mueseseh er Risaleh, Lubnan, 2001), v41, f.390. Ka thënë shejh Shuajbi, hadithi është i vërtetë.

3 Ebu Abdullah ibën Maxheh, Sunen ibën Maxheh, (Dar er Risale El Ilmije, Siri, 2009), v4, f.430. Ka thënë shejh Shuajbi, hadithi është i vërtetë.

4 Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v1, f.102.

5 Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v1, f.93.

6 CEbu Davudi, Sunen Ebu Davud, (Dar er Risale el Ilmije, Siri, 2009), v1, f.168. Ka thënë shejh Shuajbi, hadithi është i vërtetë.

Çiltërsia shpirtërore e besimtarit dhe kujdesi i tij për dukjen

Blerim Musliu

Allahu, mesazhin e fundit, të drejtuar te Pejgamberi Muhamed a.s., përmes së cilit iu drejtua njerëzimit, e zgjodhi të jetë i plotë, pa asnjë mangësi, ngase ishte dhe mbeti i plotfuqishëm për të gjitha kohët dhe për të gjitha hapësirat gjeografike.

E s'ka si të mos jetë i tillë, kur Allahu e dinte fare mirë se me çfarë do të ballafaqohej njerëzimi, andaj edhe solli fenë, në të cilën njerëzit do të gjejnë përgjigjet për të gjitha dilemat, por në të do të gjejnë edhe mënyrën më ideale të jetesës, ku balanca është etike për ta realizuar rrugëtimin e saktë e të sigurt. Njëra nga balancat më të nevojshme, që feja e mbolli te njeriu dhe e bëri të domosdoshme zbatimin e saj, është edhe

kujdesi i rregullimit të së brendshmes së njeriut dhe të dukshmes së saj. Këtë, pothuajse nuk e gjen askund të detajuar deri në finesat më të vogla, përveçse në fenë islame, dhe praktika na tregon se kur ky balancë humbet, atëherë shkaktohet kaos.

Në aspektin islam, nuk imagjinohet të jetë një njeri besimtar, i cili ka pamje mahnitëse nga jashtë e i prishur në brendësinë e tij. Por, as anasjelltas, nuk mund të imagjohet dikush që ka zemër të pastër, nëse e jashtëmja e tij është e shëmtuar. Për këtë, i Dërguari i Zotit, mësuesi i njerëzimit, na udhëzoi në rrugën e kësaj balance, e ajo buron nga brendësia për të reflektuar në të jashtmen e tij: “Me të vërtetë në trupin e

I Dërguari i Zotit, mësuesi i njerëzimit, na udhëzoi në rrugën e kësaj balance, e ajo buron nga brendësia për të reflektuar në të jashtmen e tij: “Me të vërtetë në trupin e njeriut është një copë mishi, nëse ajo rregullohet, atëherë i gjithë trupi është i rregullt, e ajo është zemra.”



njeriut është një copë mishi, nëse ajo rregullohet, atëherë i gjithë trupi është i rregullt, e ajo është zemra.”¹

Ta vështrojmë me një sy studimi ajetin kuranor, ku Allahu xh.sh. e përshkruan lutjen e Ibrahimit a.s. drejtuar Atij, që njerëzimit t’ia dërgonte një peygamber dhe mësues, e ku përmes tij do t’ua mësonte rrugën e formimit: “Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre të dërguar, që t’ua lexojë atyre ajetet Tua, t’ua mësojë atyre Librin dhe urtësinë e t’i pastrojë ata. S’ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i Dijshmi.” (El Bekare, 129). Nëse e meditojmë thellë këtë ajet, do ta shohim se shprehja “tezkije” – “pastërti apo çiltërsi e brendshme” në lutjen e Ibrahimit a.s. na vije pas mësimi të Librit dhe urtësisë, e Allahu i Madhëruar, duke treguar se ia ka plotësuar këtë lutje Ibrahimit a.s. dhe këtë begati, në ajetin 151 të sures El Bekare, na tregon një tjetër renditje: “(Sikur plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiri juaj të dërguar, që t’ua lexojë ajetet Tona, t’ju pastrojë e t’ua mësojë Librin dhe traditën, e edhe t’ju mësojë atë që nuk e dinit.” (El Bekare, 151).

Në këtë ajet, shihet qartë se menjëherë pas rikujtimit se Pejgamberi a.s. ka ardhur që t’ua mësojë njerëzve Librin e Allahut, vije detyra e tezkijes apo pastërtisë së brendshme, të cilën Allahu xh.sh. e sjell të parën në renditje, para detyrave të tjera. Me këtë del qartë në sipërfaqe rëndësia e pa kontestuar e pastërtisë së brendshme, qoftë të besimit, mendimit apo edhe të largimit të çdo gjëje që e prish brendësinë dhe që do të ketë pasojë në veprimet e jashtme.

Për ta argumentuar rëndësinë e çiltërsisë së brendshme dhe për të dëshmuar se nga aty buron e jashtëmja e njeriut, mjafton ta meditojmë pastërtinë e zemrës së Pejgamberit a.s.. Ai, nuk ka dyshim se e kishte zemrën më të pastër njerëzore. Kjo ngase Allahu xh.sh. e kishte zgjedhur zemrën më të pastër për ta bartur misionin më të rëndësishëm dhe përmbyllës të të gjithë pejgamberëve. Megjithatë, prapëseprapë Pejgamberit a.s. iu pastrua zemra dy herë (siç rrëfëhet në transmetime të sakta), një herë në moshën e re te fisi Beni Sad dhe një herë para Israsë dhe Miraxhit, kjo për të qenë argument për secilin, se pastrimi i brendësisë së zemrës dhe çiltërsia e saj janë të pa kompromis për ata që kanë synim të qenët shembull dhe që e jashtëmja të jetë për t’u lakmuar dhe për t’u admiruar.

Në qëllimet madhore të fesë, e që është formimi i duhur i njeriut, kjo metodologji kuranore dhe profetike, nuk ka si të mos jetë e suksesshme në rregullimin e jashtëm të njeriut besimtar, e që nënkupton se ai është i pastër dhe i çiltër në brendësinë e tij. Reflektimi i saj do të jetë në të jashtëm të tij, nga pamja e bukur e nga veprat e tij. Rrjedhimisht, rregullimi i jashtëm pa atë të brendshëm nuk është rruga e duhur, dhe se balanca ndërmjet tyre është e domosdoshme. Këtë nuk e rregullon askush, përveç metodologjisë kuranore dhe praktikës reale nga jeta e të Dërguarit a.s., për të cilin Zoti i Gjithësisë thotë se: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të



Dërguarin e Allahut.” (El Ahzab, 21). Ajo që jemi të bindur dhe që nuk kemi asnjë dilemë është se Muhamedi a.s. ishte njeriu që ka arritur ta bëjë balancën më mahnitëse ndërmjet çiltërisë së brendshme dhe të jashtme së tij, e mu për këtë edhe jemi urdhëruar ta marrim si model dhe si shembull.

Në humbjen e këtyre balancave shohim se sot njerëzit kanë rrëshqitur në të dyja skajet e keqkuptimit. Njëri grup, fokusin dhe investimin e vetëm të tyre e kanë të jashtmen, madje edhe këtu duke bërë një seleksionim nga vetja e tyre duke i kushtuar kujdes vetëm dukjes, janë të gatshëm të shpenzojnë pa llogari në përmirësimin e imazhit të jashtëm dhe kjo në vetvete nuk përmban ndonjë problem, ngase vetë feja e ka nxitë një gjë të tillë. “Allahu është më i bukur dhe e do të bukurën.”²

E në një ajet kuranor, Zoti i Madhëruar thotë: “O ju bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendet e turpshme dhe petk zbukurues. Por, petku i devotshmërisë është ai më i miri. Këto janë nga argumentet e Allahut ashtu që ata t’i kujtojnë.” (El Araf, 26).

Pra, zbukurimi është i pëlqyer dhe i preferuar, por nëse teprohet dhe bëhet në llogari të shkujdesjes ndaj të brendshmes, atëherë është i qortuar dhe nuk kryen punë, ngase Pejgamberi a.s. na ka mësuar se kriteri i vlerësimit tek Allahu është e brendshmja. Në Sahihun e Muslimit, është transmetuar se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Allahu nuk shikon në paraqitjen tuaj të jashtme, as në pasurinë tuaj, por Ai shikon në zemrat dhe veprat tuaja.”

Sot, në kohën e materiales, jo rrallëherë shohim përmbysje të kriterëve, ku njerëzit vlerësojnë veten dhe të tjerët vetëm nga pamja e nga luksi, e kjo shpesh merr kahje të shëmtuar, sidomos kur kalon edhe në operacione plastike, vetëm e vetëm për t’u dukur bukur. Çështja bëhet edhe më tragjike atëherë kur paturpësitë, morali i ulët, gënjeshtria, mos mbajtja e fjalës etj., të cilat duhet të jenë zbukurimi real i jashtëm, mbesin nën hije dhe tentohet humbja e peshës së tyre, duke u fokusuar me tërë qenien në aspektin e jashtëm e atë dekorativ.

Zbukurimi është i pëlqyer dhe i preferuar, por nëse teprohet dhe bëhet në llogari të shkujdesjes ndaj të brendshmes, atëherë është i qortuar dhe nuk kryen punë, ngase Pejgamberi a.s. na ka mësuar se kriteri i vlerësimit tek Allahu është e brendshmja.

Por edhe grupi i dytë, të cilët kanë shkuar në skajin tjetër, ku pretendojnë se vetëm brendësia apo ajo që bartin në brendësinë e tyre është me rëndësi, duke mos i kushtuar rëndësi pamjes së jashtme, duke dalë kështu te njerëzit me rroba që nuk janë të zakonshme e duke dalë para tyre në formë të shkujdesur, apo edhe me aroma të neveritshme, e të gjitha këto me arsyetimin se mjafton se unë e kam këtë zemrën e pastër, sigurisht se edhe këto karaktere njerëzish janë larg nga balancat e vendosura nga feja. E Allahu xh.sh. në Kuranin fisnik, për mospërputhjen e mendimeve dhe veprimeve, në formë të qortuar thotë: “O ju që keni besuar, përse e flitni atë të cilën nuk e veproni. Tek Allahu është e urryer ta thoni atë që nuk e punoni.” (Es Saff, 2-3).

Padyshim se mesatarja e balancuar, e nxjerrë nga këto dhe shumë argumente të tjera fetare, e formësuar në formën më të mirë nga i Dërguari i Zotit, a.s., mbetet pamja më brilante e njeriut që i ofrohet shoqërisë. Ai i cili me mbikëqyrjen hyjnore e ka rregulluar të brendshmen e tij, e cila pastaj pashmangshëm reflekton në pamjen e bukur të jashtme, dhe e cila do ta bëjë atë të mahnitshëm me moralin dhe edukatën e tij.

Çdoherë që e shohim se ka ngecje në plotësimin e këtij imazhi, duhet të jemi të bindur se ka një keqkuptim në formim, e i cili më pastaj shtyn në një disbalancë, e kjo pastaj na e paraqet para të tjerëve një pamje dhe perceptim të shpërftytyruar të njeriut besimtar.

Shpeshherë pasojat janë të menjëhershme tek individ, por edhe te shoqëria, e shtrembërimi i fesë është pasoja më e madhe. Ne jemi përgjegjës për t’i ndryshuar për së miri përshtypjet e njerëzve për këtë fe. Vetëm duke e paraqitur e duke e jetësuar atë ashtu siç është, ne e kemi përmbushur misionin e të jetuarit si besimtar dhe e kemi përmbushur “thirrjen e heshtur” apo të praktikuarit, e që mbetet një nga format më të suksesshme të thirrjes në fe.

1 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

2 Sahihu i Muslimit, 131.



Jeta e varrezave (El Barzah), realiteti të cilin do ta jetojë çdo person

Dr. Ali Sallabi

Tekstet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit a.s. e kanë vërtetuar jetën e varrezave, e cila nuk është e ngjashme me jetën e zakonshme të kësaj bote. Allahu xh.sh. ka bërë që jeta të zhvillohet në tri etapa: jeta në këtë botë, jeta në varreza dhe jeta në botën e përherëshme,

Fjala “Barzah” është emër që tregon periudhën mes kësaj bote dhe botës së përtejme, nga koha e vdekjes deri në kohën e ringjalljes. Lidhur me këtë, Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: “...që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova! Kurrresi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distanca periodike) deri në ditën kur ringjallen.” (El Muminun, 100).

Tekstet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit a.s. e kanë vërtetuar jetën e varrezave, e cila nuk është e ngjashme me jetën e zakonshme të kësaj bote. Allahu xh.sh. ka bërë që jeta të zhvillohet në tri etapa: jeta në këtë botë, jeta në varreza dhe jeta në botën e përherëshme, dhe Ai vendosi rregulla të jetesës për çdo etapë. Zoti xh.sh., njeriun e ka krijuar të përbërë prej dy elementeve: fizike dhe shpirtërore. Rregullat e kësaj bote i ka ndërlidhur me aspektin

Në kohën tonë në të cilën jetojmë, janë shfaqur grupe njerëzish, të cilët po përpiqen të mohojnë jetën e varrezave, e në veçanti mundohen ta mohojnë se në jetën e varrezave njeriu mund edhe të ndëshkohet, duke pretenduar se kjo është në kundërshtim me mëshirën dhe mirësinë e Zotit ndaj robërve të Tij. Përveç plasimit të këtyre mendimeve, ata bëjnë përpjekje të pareshtur që të përgënjeshtrojnë hadithet që kanë folur për këtë çështje dhe të cilat kanë vërtetuar një gjë të tillë, duke pretenduar se kjo që ata e thonë është në përputhje me Kuranin famëlartë, i cili nuk e përmendi fare këtë çështje, dhe as që ka folur për dënimin apo lumturinë e varrit, duke e ditur se kjo çështje është diçka për të cilën myslimanët janë pajtuar, pasi që argumentet e Kuranit dhe Sunetit të Pejgamberit a.s., të cilat flasin për lumturinë dhe ndëshkimin e varrit janë të qarta.



fizik, ndërsa shpirtërorja është pjesë e saj, ndërsa rregullat e jetës së varrezave ndërlidhen me aspektin shpirtëror, ndërsa ana fizike është pjesë e saj, e kur të ndodhë Dita e Kiametit dhe të ringjallen njerëzit nga varret e tyre, atëherë rregullat, kënaqësia dhe ndëshkimi përfshinë edhe anën fizike po edhe anën shpirtërore në formë të përgjeshme.

Ajo çfarë duhet ta kemi të qartë është se kur përmendim ndëshkimin në varr apo edhe mirësitë e tij, është për qëllim jeta e varrezave (El Barzah), e që është jeta mes kësaj bote dhe botës së amshueshme. Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: “E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!” Kurrsesi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distanca periodike) deri në ditën kur ringjallen.” (El Muminun, 99-100).

AJETET KURANORE TË CILAT ALUDOJNË NË NDËSHKIMIN NË VARR

Allahu xh.sh. ka thënë: “E kush është më gabimtar i madh se sa ai që trillon rrenë ndaj Zotit, ose thotë: “Mua po më shpallet e nuk i është shpallur asgjë, ose se sa ai që thotë: Do të thur diçka të ngjashme me atë që e ka zbritur Allahu”. E, sikur t’i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): “Shpëtoni pra vetveten (nëse mundeni).” “Tash përjetoni dënimin e turpshëm për shkak se e thoshit të pavërtetën për Allahun, dhe ndaj argumenteve të Tij ishit kryeneç.” (El En’am, 93).

Pjesa e ajetit ku Allahu xh.sh. thotë: “Tash përjetoni dënimin e turpshëm” sqaron momentin e vdekjes së jobesimtarit, të cilit i vijnë melaqet dhe e informojnë se ai sot do të dënohet, d.m.th. kanë për qëllim ditën e vdekjes së tij. Kjo tregon se ndëshkimi do të jetë para Ditës së Kiametit. Ky ajet është argument i qartë se ndëshkimi i varrit është realitet.

Allahu xh.sh. ka thënë: “Edhe rreth jush ka beduinë që janë hipokritë, e edhe nga banorët e Medinës që janë përcaktuar për hipokrizi, ti nuk i di ata, Ne i dimë, ata do t’i dënojmë dy herë, pastaj shtyhen në dënimin e madh.” (Et Tevbe, 101), pjesa ku Allahu thotë: “ata do t’i dënojmë dy herë”, hera e parë ka për qëllim telashet dhe brengat e kësaj bote, si në vetveten e njeriut ashtu edhe në pasurinë dhe familjen e tij. Ndërsa hera e dytë ka për qëllim ndëshkimin e varrit, ndërsa për

Allahu xh.sh. ka thënë: “Dhe, Ne do të bëjmë që të shijojnë një dënim më të lehtë në këtë jetë, para dënimit më të madh në jetën e përtejme, me qëllim që të kthehen në rrugën e drejtë.” (Es Sexhde, 21).

ndëshkimin e botës tjetër, ka thënë: “pastaj shtyhen në dënimin e madh.”

Allahu xh.sh. ka thënë: “Dhe Allahu e shpëtoi atë (besimtarin) prej të këqijave që i kurdisën, ndërsa ithtarët e Faraonit i përfshiu dënimi i keq. Ata i nënshtrohen zjarrit mëngjes e mbrëmje, e Ditën e Kiametit (u thuhet engjëjve): “Ithtarët e Faraonit futni në dënim më të rëndë!” (Gafir, 45-46). Edhe ky ajet është prej teksteve të qarta që tregojnë për ndëshkimin në varr, sepse ndëshkimi i cili i ndodhi popullit të Faraonit ishte pas vdekjes së tyre, ndërsa ndëshkimi ndaj tyre në botën tjetër ai është potencuar më pastaj në pjesën e ajetit: “Ithtarët e Faraonit futni në dënim më të rëndë!”

Allahu xh.sh. ka thënë: “Dhe, Ne do të bëjmë që të shijojnë një dënim më të lehtë në këtë jetë, para dënimit më të madh në jetën e përtejme, me qëllim që të kthehen në rrugën e drejtë.” (Es Sexhde, 21). Një grup komentuesish të Kuranit, prej tyre Abdullah ibën Abasi, këtë ajet e kanë marrë si argument për ekzistimin e ndëshkimit në varr, sepse Allahu xh.sh. ka treguar se ndaj tyre ka dy ndëshkime: më i lehtë dhe më i madh, dhe është thënë se këto dënime janë pas dënimit në këtë botë.

Allahu xh.sh. ka thënë: “Po ti lëri ata derisa të ballafaqohen në ditën e tyre, kur do të shtangen. Ditën kur dredhia e tyre nuk do t’u bëjë dobi asgjë e as që do të ndihmohen. Është e vërtetë se ata që bënë zullum kanë një dënim më të afërt se sa ai (i kiametit), por pjesa dërmuese e tyre nuk e dinë.” (Et Tur, 45-47). Abdullah ibën Abasi, sipas Kadates, ka thënë: dënimin në varr e gjeni të theksuar edhe në Kuran.

VENDQËNDRIMI I SHPIRTRAVE NË JETËN E VARREZAVE (BARZAH)

Shpirtrat e njerëzve në jetën e varrezave (Barzah) kanë pozicione të ndryshme, përmes studimit dhe analizimit të teksteve të ndërlidhura me këtë çështje, mund të bëjmë një ndarje si në vijim:

- Shpirtrat e pejgamberëve

Shpirtrat e pejgamberëve janë në vendet më të mira dhe më të larta, në shoqërim të Zotit. Aisheja r.a., në momentet e fundit të jetës së Pejgamberit a.s., e kishte dëgjuar duke thënë: “O Zot, shoqërimin Tënd!”

- Shpirtrat e dëshmorëve



Allahu xh.sh. ka thënë: “Kurrësi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre.” (Ali Imran, 169). Shpirtrat e tyre janë në brendësinë e një shpeze të gjelbër të varur si fener për Arshin e Zotit xh.sh., të cilët lëvizin nëpër Xhenet kudo që dëshirojnë dhe prapë kthehen në ato fenerë.

- Shpirtrat e besimtarëve të mirë

Shpirtrat e besimtarëve të mirë do të jenë zogj të varur në pemët e Xhenetit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Shpirti i besimtarit bëhet zog në Xhenet, derisa atë, Zoti xh.sh., ta kthejë në trupin e tij Ditën e Kiametit.”¹

Dallimi mes shpirtrave të besimtarëve dhe shpirtrave të dëshmorëve është se dëshmorët janë në trupat e zogjve të gjelbër që enden dhe lëvizin nëpër kopshtet e Xhenetit dhe strehohen në fenerë të varur në Fron (Arsh-i-Alan), ndërsa shpirtrat e besimtarëve, janë në trupat e zogjve që janë pezull në frutat e Xhenetit dhe nuk lëvizin nëpër të.

- Shpirtrat e mëkatarëve

Bazuar në referenca të sakta, gjejmë disa tekste që tregojnë mundimin me të cilin do të përballët mëkatori. Prej shembujve të tillë mund të përmendim p.sh. personin i cili e thotë një gënjeshtër e cila më pastaj merr dhenë, i tilli do të torturohet me një kanxhë hekuri që do t'i hyjë në gojë derisa t'i arrijë në zverk. Pastaj personin i cili fle gjumë dhe nuk zgjohet për faljen e namazit, të tillit koka e tij do t'i thyhet në një gur. Pastaj personat të cilët bëjnë amoralitet (zina), si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat, të tillët do të torturohen në një vrimë si furrë, ajo është e ngushtë në krye dhe e gjerë në fund, nën të ndizet një zjarr. Pastaj fajdexhiu i cili do të notoj në një lum prej gjaku kurse në breg është dikush që e gjuan me gurë dhe nuk e lë që të dal.

Gjithashtu kemi hadithe të cilat flasin për mundin dhe ndëshkimin që do ta kenë ata të cilët nuk kanë kujdes gjatë urinimit të tyre, pastaj ata të cilët bartin fjalët dhe ata që

keqpërdorin pasurinë publike, e lloje të tjera të shumta. Pra mëkatarët gjatë jetës së varrezave do të ndëshkohen me ndëshkime të llojllojshme, më lart u përmendën vetëm disa prej tyre.

- Shpirtrat e jobesimtarëve

Hadithi i Pejgamberit a.s., i cili përshkruan gjendjen e besimtarit derisa ai arrin në vendi i tij në Xhenet, më pastaj përshkruan gjendjen e jobesimtarit dhe çfarë do t'i ndodh atij me rastin e marrjes së shpirtit, përshkruan se shpirti i tij do të dalë nga trupi me një erë shumë të keqe dhe ai do të dërgohet lart dhe kur të arrijë te dera e tokës do të pyesin: sa shpirt i qelbur qenka ky! Dhe më pastaj e dërgojnë te shpirtrat e tjerë të jobesimtarëve.

Jeta e varrezave (Barzahit) – me mirësitë dhe ndëshkimet e saja – është një jetë reale, të cilën do ta jetojë çdonjëri prej nesh. Kjo çështje është e vërtetuar dhe mbështetur në argumente të shumta dhe të qarta për të cilat nuk ka vend dyshimi.

Besimtari i vërtetë dhe i sinqertë është ai i cili beson bindshëm në atë që është potencuar në Kuran dhe Sunet të Pejgamberit a.s.. Ai largohet prej atyre njerëzve të cilët mundohen që tekstet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit a.s. t'i nënshtrojnë sipas hamendësive të tyre, analogjisë së tyre të prishur, dhe mendjeve të cekura. Me bindje të thellë mund të themi se nuk mund të ketë kundërshtim dhe mos përputhje mes teksteve autentike dhe logjikës së shëndoshë, siç edhe e kanë potencuar dijetarët tanë të respektuar. Mirëpo, kur analogjia ka disbalancë dhe mendja sëmuret, atëherë ajo mund të sjellë çudira! Zot na ruaj!

Përktheu: Mr. Vedat Shabani

¹ Transmeton Imam Nesaiu, nr. hadithit: 2073, Kitabu-l-Xhenaiz/Ervahu-l-Muminin. Hadithin e transmeton gjithashtu Ibën Maxheh, Imam Maliku dhe Imam Ahmed. Hadithi është autentik-sahih

Virtytet e moralit islam

RËNDËSIA DHE VEÇORITË E TYRE

Dr. Sedat Islami

HYRJE

Në tekste të shumta fetare, virtyteve të moralit u kushtohet rëndësi e veçantë. Kjo për faktin se ato prezantojnë fenë në terren. Pra, janë imazhi më i theksuar i fetarisë së një besimtarit. Në hadithin e përcjellë nga Ebu Hurejre r.a., qëndron se Profeti a.s., ka thënë: “Besimtarët me besimin më të përsosur janë ata me moralin më të mirë.”¹ Kjo ndërlidhje ndërmjet tyre tregon se morali i mirë vjen si rezultat i besimit të thellë dhe të fuqishëm, ose besimi vjen si motiv për përsosjen e moralit sepse, duke e ditur se nuk do të ketë besim të përsosur ndryshe vetëm se duke përmirësuar sjelljet, njeriu do të angazhohet që të përvetësojë tiparet e çmuara dhe virtytet e larta, si dhe të braktisë ato të pavlerat.² E si të mos jetë kështu kur kryefjalë e misionit të Profetit Muhamed a.s., është pikërisht morali: “Vërtetë, jam dërguar për të plotësuar virtytet e moralit.”³

Në këtë punim do të ofrojmë një përmbledhje rreth rëndësisë dhe veçorive për të cilat karakterizohen virtytet e moralit islam.

RËNDËSIA E VLERAVE DHE VIRTYTEVE MORALE TË ISLAMIT

Virtytet, siç aluduar më lartë, janë kërkesë e parashtruar në Kuran dhe Sunet. Allahu i Madhëruar, në disa vende, në Kuranin fisnik, na urdhëron për moral e sjellje të mira, si p.sh.: “Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin,

veprat e shëmtuara dhe dhunën...” (En Nahl, 90); “Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!” (El Arafë, 199). Nga kjo perspektivë, për një besimtar, rëndësi parësore ka çuarja në vend e një urdhri të Zotit, respektivisht ne duhet të dallohemi për moral të mirë sepse kështu na urdhëron Zoti ynë.

Se morali i mirë ka rëndësi të madhe mësojmë edhe nga ndërlidhja e tij me adhurimet, respektivisht të qenit të tij produkt i adhurimeve. P.sh., për namazin, Allahu na mëson se efekt i tij është largimi i besimtarit nga punët e këqija (Ankebut, 65); për zekatin na tregon se dëlirja shpirtërore është objektive e tij (Teube, 103); për agjërimin na tregon se synim ka devotshmërinë (Bekare, 183). Po kështu për haxhin na bëhet me dije se qëllime të tij janë largimi nga punët dhe tiparet e urryera (Bekare, 197).

Këtu mbase qëndron shpjegimi pse kriter i vlerësimit të një besimtarit merret fillimisht morali, sepse ai flet edhe për adhurimet dhe besimin. Morali është përfaqësuesi i tyre në terren. Allahu i Madhëruar thotë: “...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...” (Huxhurat, 13). Ibën Kethiri, duke e shpjeguar këtë ajet, tregon se kriter i vlerësimit dhe dallimit për të mirë tek Allahu është devotshmëria, jo prejardhja. Ai argumenton edhe me hadithe të regjistruara në koleksionet e Buhariut dhe Muslimit, në të cilat po kështu konfirmohen vlerat si kriter vlerësimi e jo elementet e tjera. Profeti a.s., ka thënë: “...Më i nderuari tek Allahu është më i ruajturi nga mëkatet...”⁴

“Besimtarët me besimin më të përsosur janë ata me moralin më të mirë.”

Po kështu ka thënë⁵: “Allahu nuk shikon në pamjet dhe pasuritë tuaja por në zemrat dhe veprat tuaja.”⁶ Në fakt, hadithe me këtë tematikë ka shumë. Një prej tyre është dhe hadithi i përcjellë nga Ebu Hurejre r.a., në të cilin qëndron se Profeti a.s., ka thënë: “Kë e zmbrops puna, prejardhja nuk e shtyn tutje.”⁷

Prandaj virtytet janë edhe dëshmi e dashurisë së Zotit ndaj robit: “...Allahu me të vërtetë i do bamirësit.” (Bekare, 195); “...Allahu i do të duruarit.” (Ali Imran, 146); “...Vërtet, Allahu i do të drejtët.” (Maide, 42).⁸

Pikërisht për shkak të kësaj rëndësie që kanë, virtytet kanë edhe shpërblim të madh në botën tjetër. Profeti a.s., ka thënë: “Vepra më e rëndë në peshojën e besimtarit është morali i mirë.”⁹ “Vërtet, njeriu do të arrijë me moralin e mirë të tij gradat e besimtarit që falet natën dhe agjëron ditën.”¹⁰; “...ia premtoi një shtëpi në pjesën më të lartë të Xhenetit atij që ka moral të mirë.”¹¹



PËR ÇFARË KARAKTERIZOHEN VLERAT DHE VIRTYTET MORALE TË ISLAMIT?

Përgjatë shpjegimeve në pjesën paraprake, ne iu referuam vetëm ajeteve dhe haditheve për virtytet. Kjo nënkupton se bazë dhe themel i virtyteve të moralit islam është vetë feja.¹²

Veçori tjetër e tyre është se ato janë të gjithanshme dhe se përfshijnë çdo aspekt të jetës së njeriut. Më qartë, ato manifestohen në raport me Zotin, vetveten, të tjerët dhe ambientin.

Vlejnë në dhe për çdo kohë.

“...Më i nderuari tek Allahu është më i ruajturi nga mëkatet...”

Ngjallin përgjegjësinë individuale dhe kolektive “...Çdo njeri është peng i veprave të veta.” (Tur, 21); “...Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.” (Isra, 36). Sa i përket përgjegjësisë kolektive, Profeti a.s., ka thënë: “Kush sheh një të keqe, le ta largojë me dorë, e nëse nuk ka mundësi, atëherë me gjuhë, e nëse as për këtë nuk ka mundësi, atëherë me zemër. E ky është niveli më i dobët i besimit.”¹³

Mbikëqyrja hyjnore “...Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.” (Nisa, 1). Nga kjo perspektivë vjen edhe shpërblimi në këtë dhe botën tjetër. Për shpërblimin në

këtë botë, Allahu thotë: “...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi). Dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu.” (Talak, 2-3). Ndërsa për shpërblimin në Ahiret, Allahu i Madhëruar thotë: “Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitorja madhështore.” (Teube, 72).

PËRFUNDIM

Virtytet janë dëshmi e besimit dhe pjekurisë fetare e personale. Nëpërmjet tyre plotësohet kushti i të qenit i nderuar dhe graduar nga Allahu i Madhëruar dhe përfitues i ndërmjetësimit të Profetit a.s.. Virtytet janë dëshmi e besimit të kompletuar dhe adhurimeve të pranuar. Ato kanë këtë rëndësi dhe pozitë për shkak të veçorive dhe përmbajtjes. Kanë burim hyjnor dhe shtrihen në çdo aspekt të jetës së njeriut. Për këtë arsye parashihet shpërblim i madh për to.

1 Hadithin e shënojnë Ebu Davudi, nr. 4682 dhe Tirmidhiu, nr. 1162.

2 Shih: Muhamed bin Salih el Uthejmin, *Mekarim el ahlak*, (Rijad: Dar el vatan,), f. 10.

3 Hadithin e shënojnë Bejhakui, nr. 21301, Ahmedî, nr. 8952 dhe Hakimi, nr. 4221.

4 Buhariu, nr. 4689.

5 Muslimi, nr. 2564.

6 Shih: Ismail bin Omer bin Kethir, *Tefsiru el Kur'ani el adhim*, (Rijad: Dar Tajjibe, ed. 2, 1999), 7/386.

7 Muslimi, nr. 2699.

8 Shih për rëndësinë e moralit: Grup autorësh, *Enciklopedia e moralit islam*, versionin elektronik i saj (<https://dorar.net/alakhlaq/19/>).

9 Sahih el Xhami, nr. 135.

10 Sahih el Xhami, nr. 1620.

11 Sahih et Tergib, nr. 2648.

12 Shih për burimet e moralit islam: Grup autorësh, *Enciklopedia e moralit islam*, versionin elektronik i saj (<https://dorar.net/alakhlaq/19/>).

13 Muslimi, nr. 49.



E drejta pronësore e gruas dhe burimet e saj (2)

(BURIMET E TË ARDHURAVE TË GRUAS)

Dr. Ilmije Kuqi

Ndër burimet e të ardhurave të gruas, të cilat i zotëron pa punë dhe angazhim të saj janë: trashëgimia dhe mehri.

1-E DREJTA E GRUAS PËR TRASHËGIMI

Në hyrje të këtij punimi kemi përmendur se në epokat e shkuara para Islamit, gruaja nuk ka pasur pronë private, as nuk ka pasur të drejtë trashëgimie, por përkundrazi ajo ishte trashëguar si pronë.

Kur Islami solli ligjin e tij tolerant dhe drejtësinë absolute, ai e trajtoi atë me drejtësi dhe ia përcaktoi asaj të drejtën e trashëgimisë, sipas pozitës së saj në lidhje me trashëgimlënësin dhe me pjesën tjetër të trashëgimtarëve, qoftë trashëgimi e vogël apo e madhe, duke mos shikuar gjininë e saj.

Zoti i Madhëruar thotë: “Meshkujve ju takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti).” (En Nisa, 7).

Zoti i Madhërishëm i veçoi gratë me përmendje ashtu siç i veçoi burrat dhe ua vërtetoi të drejtën e trashëgimisë, sado e pak qoftë ajo, duke thënë: “le të jetë pak ose shumë ajo që lënë”, dhe e bëri të drejtë të përcaktuar në formë të prerë me shprehjen: “ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti)”, në mënyrë që të mos nënvlerësohen në këtë të drejtë dhe që më këtë legjislacion të urtë të konfirmojë fshirjen e padrejtësisë që i është bërë asaj në periudhën paraislame dhe epokat e errëta që i paraprinë.

Çështja e dallimit gjinor është për popullimin e tokës me mbijetesën e qenies njerëzore, e cila është një çështje e domosdoshme për mbijetesën e llojit njerëzor, dhe për shpërndarjen e roleve gjinore për vendosjen e jetës në tokë.



Zoti i Plotfuqishëm e bëri të qartë të drejtën e gruas për trashëgimi, në suren En Nisa, ajetet 11-14 dhe ajeti 176 dhe Ai vetë, e detajoi atë sipas rrethanave të saj dhe nuk ia la askujt që të bëjë ixhtihad në të.

Megjithëkëtë, disa akoma i shqetëson fakti, se në ligjin e trashëgimisë në Islam është çështja e dallimit të mashkullit nga femra në shpërndarjen e trashëgimisë, pasi dihet se mashkulli ka dyfishin e femrës. Por, a do të thotë kjo anshmëri ndaj burrit dhe favorizim të tij mbi gruan?!

Për të sqaruar këtë çështje, duhet thënë se Islami nuk mund ta favorizojë burrin për mashkulloritetin e tij, sepse kjo bie në kundërshtim me pikëpamjen e Islamit për burrin dhe gruan, pasi secili prej tyre është krijuar për një qëllim, e që është adhurimi i Zotit të Plotfuqishëm siç është theksuar në ajetin: “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë,” (Edh Dharijat, 56) dhe përderisa qëllimi i krijimit është i njëjtë për të dy gjinitë, atëherë nuk ka asnjë konsideratë për të preferuar një gjini mbi një tjetër. Kurse çështja e dallimit gjinor është për popullimin e tokës me mbijetesën e qenies njerëzore, e cila është një çështje e domosdoshme për mbijetesën e llojit njerëzor, dhe për shpërndarjen e roleve gjinore për vendosjen e jetës në tokë.

Ai që nuk bëri dallim midis të bardhit dhe të ziut, as arabit dhe jo arabit përveçse me devotshmëri, nuk është e mundur të bëjë dallim midis mashkullit dhe femrës, përveçse me të njëjtin kriter gjithashtu, e që është devotshmëria.

Pyetja tani është nëse Islami nuk e favorizon mashkullin mbi femrën, cili është justifikimi i dallimit midis burrit dhe gruas në trashëgimi sipas fjalëve të të Plotfuqishmit: “Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimit) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra.” (En Nisa, 11).

Përgjigja për këtë nën një është se kriteret për shpërndarjen e trashëgimisë në Islam nuk janë sipas mashkulloritetit dhe feminitetit. Por, ajo rregullohet nga tre kriteret:

*Kushdo që shikon
Islamin, tekstet e
tij dhe historinë e
tij të lavdishme,
objektivisht nuk
do të gjejë
vështirësi në
zbulimin e statusit
të lartë që ia dha
gruas, pasi Islami
është feja që ia dha
gruas të drejtën e
trashëgimisë,*

Një: shkalla e lidhjes farefisnore ndërmjet trashëgimtarit, mashkull qoftë apo femër, dhe trashëgimlënësit. Sa më e afërt të jetë lidhja, aq më e madhe është pjesa në trashëgimi, dhe sa më e largët të jetë lidhja aq më e vogël është pjesa në trashëgimi, duke mos marrë parasysh gjininë e trashëgimtarëve.

Dy: Pozicioni i brezit trashëgues në sekuencën kronologjike të brezave. Gjeneratat që kanë jetën para dhe përgatiten për të mbajtur barrën e saj zakonisht kanë një pjesë më të madhe në trashëgimi sesa pjesa e brezave që jetën e kanë lënë prapa, pavarësisht nga gjinia e trashëgimtarëve, mashkull apo femër.

Tre: Barra financiare që legjislacioni islam kërkon nga trashëgimtari të mbajë. Ky është kriteri i vetëm që rezulton në një dallim mes mashkullit dhe femrës, por ky është një dallim që nuk çon në ndonjë padrejtësi ndaj femrës apo pakësim të së drejtës të saj. Prandaj, kushdo që shikon Islamin, tekstet e tij dhe historinë e tij të lavdishme, objektivisht nuk do të gjejë vështirësi në zbulimin e statusit të lartë që ia dha gruas, pasi Islami është feja që ia dha gruas të drejtën e trashëgimisë, ndërkohë që ajo ishte prej atyre që trashëgohej po si çdo plaçkë, dhe nuk kishte të drejta të mbrojtura dhe status të lartë para Islamit. Andaj, është gabim të shikohet barazia e burrit dhe gruas pa marrë parasysh të drejtat dhe detyrat që ka burri, pasi barazia në dhënie duhet të shoqërohet me barazi në detyrime. Prandaj, duhet të shikohen detyrimet që ka burri, ndërsa barazia e gruas pa i marrë në konsideratë detyrimet që merr përsipër burri, është defekt.

Djali ka më shumë detyra dhe përgjegjësi financiare sesa vajza, madje ato nuk krahasohen me përgjegjësitë financiare të vajzës. Ai paguan pajën e bashkëshortes dhe obligohet ta furnizoj atë dhe fëmijët me ushqim, veshmbathje, strehim dhe të ngjashme. Ai obligohet me pajën e bashkëshortes, t'i përgatisë asaj vendstrehimin dhe të shpenzojë për të nga pasuria e tij, qoftë ajo e varfër apo e pasur, me ç'rast pjesa e tij e trashëgimisë do të jenë për të dhe për bashkëshorten e tij, kështu që



pjesa e tij do të jetë e barabartë ose më pak se ajo e motrës së tij. Pastaj, nëse i lindin fëmijë, ai është i detyruar t'i mbajë ata, ndërsa nëna e tyre nuk mbart asnjë përgjegjësi financiare. Në këtë rast, pasuria e tij e trashëguar do të jetë më pak se pasuria e motrës së tij. Po, nëse vajza martohet, ajo merr mehrin nga bashkëshorti i saj dhe furnizimi i saj bie mbi të. Kështu që, ajo mund ta shfrytëzojë atë që ka trashëguar nga i ati dhe ta zhvillojë vetëm për veten e saj, d.m.th. djali e paguan pajën, kurse vajza ia merr pajën bashkëshortit të saj, djali shpenzon për shtëpinë e tij, kurse vajza nuk shpenzon asgjë, por e kundërta, për të shpenzohet.

Të gjitha këto, fetarisht dhe juridikisht, janë të detyrueshme për burrin, jo për gruan. Gruaja merr e nuk jep dhe kursen pa paguar asnjë shpenzim dhe pa ndarë me burrin shpenzimet dhe kërkesat e jetës, edhe në rast se gruaja është e pasur, burri është i detyruar ta furnizojë atë, sepse ai është përgjegjës për furnizim. Nëse gruaja paguan, kjo është mirësi nga ana e saj, por sipas legjislacionit islam, ai që e furnizon bashkëshorten dhe fëmijët është burri. Zoti i Madhëruar ka thënë: "I ati i fëmijës është i obliguar për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre (gruas) ashtu si është rregull." (El Bekare, 233).

Gruaja, gjegjësisht cilado grua në Islam, ka sigurim gjithëpërfshirës gjatë gjithë jetës, sipas terminologjisë së epokës bashkëkohore, ndaj të gjitha nevojave të saj, për ushqim, pije, strehim, trajtim dhe gjëra të tjera, të cilat Sheriati ia obligoi burrit, pavarësisht nëse ai është baba, bashkëshort, vëlla, xhaxha i gruas apo dikush tjetër, kjo përveç përgjegjësisë që bart burri për shpenzimet për fëmijët, prindërit dhe ndonjëherë edhe disa të afërm. Në të kundërtën, asgjë nga këto nuk janë të detyrueshme për gruan. Nëse Ligjvënësi ka caktuar burrin të jetë përgjegjës për gruan dhe

që të kujdeset për të gjitha nevojat e saj të domosdoshme, dhe shtojë këtë pjesë që duhet t'i jepet asaj si mehr, pastaj edhe e drejta e trashëgimisë që gruaja e meriton me hise të caktuara, atëherë ku ekziston padrejtësia e shkaktuar ndaj gruas?! Përkundrazi, kjo është urtësia që flet për drejtësinë dhe mëshirën në formën e saj më të bukur, e cila nuk i fshihet një personi të shëndoshë.

Çështja e trashëgimisë nuk duhet të merret parasysh vetëm nga njëri aspekt, ngase ajo ka shumë aspekte. Shumë njerëz shikojnë ndarjen e trashëgimisë pa shikuar rezultatin social, disa prej tyre mund të shkojnë aq larg sa të mendojnë për barazinë e burrit dhe gruas duke e detyruar gruan të paguajë pajën dhe të paguaj gjysmën e furnizimit, në mënyrë që ajo të jetë e barabartë në trashëgimi. Kjo është e kundërta e natyrshmërisë, padrejtësi ndaj femrës dhe transferim i përgjegjësisë sociale nga supet e burrit në supet e gruas, përveç lindjes së fëmijëve, ushqyerjes me gji dhe kujdesi që ka ajo për ta.

Prandaj, është e padrejtë mos marrja parasysh e të drejtave dhe detyrat. Duhet të shikohet balanca e të drejtave dhe detyrave, në mënyrë që dhënia të jetë në vend.

Një çështje e rëndësishme që duhet theksuar është se pasuria e trashëgimisë nuk është rezultat i punës dhe mundit, ndërsa sa i përket pasurisë së fituar, në këtë nuk ka dallim midis burrit dhe gruas, as në shpërblimin e punës, as në fitimin e tregtisë, e as në të drejtën e pronësisë.

Së dyti: trashëgimi i burrit dyfishin e femrës nuk është në formë absolute, por vetëm në disa raste të caktuara, ngase ka shumë raste në të cilat gruaja trashëgon më shumë se burri apo burri nuk trashëgon fare, ndërsa ka vetëm 4 raste nga më

shumë se 40 raste në të cilat gruaja trashëgon gjysmën e pjesës së burrit, përfshirë rastin e përmendur në ajetin: “Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimit) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra.” (En Nisa, 11). Në këtë rast dhe në të tri rastet e tjera në cilat burri trashëgon dyfishin e gruas është për shkak se mbi të bien obligimet financiare familjare, sepse pasardhësi është vazhdues i përgjegjësisë financiare të të ndjerit dhe të familjes së tij për sa i përket mbajtjes së të afërmeve, dhe në çështjet e shpagimit të gjakut. Ndërsa sa u përket të tjerëve jashtë këtyre katër rasteve, marrëdhënia e tyre me të ndjerin është jashtë fushës së asabesë¹, d.m.th. nuk ka përgjegjësi financiare vetëm mbi mashkullin, kështu që pjesa e femrës prej tyre është e barabartë me mashkullin, siç tregohet nga ajeti: “Në qoftë se (i vdekuri) është mashkull ose femër, e trashëgohet nga ndonjë i largët (pse s’ka as prindër as fëmijë) po ka një vëlla ose një motër (nga nëna), atëherë secilit prej tyre u takon një e gjashta, e në qoftë se janë më shumë (se një vëlla ose se një motër) ata janë pjesëmarrës të barabartë në të tretën (e tërë pasurisë).” (En Nisa, 12).

Kjo është urtësia e legjislacionit hyjnor në këtë fushë, i cili me tolerancën dhe drejtësinë e tij, hoqi nga gruaja padrejtësinë nga e cila ka vuajtur me shekuj, duke e konsideruar atë të aftë për të zotëruar pronë dhe për të vepruar në të dhe bëri një nga burimet e zotërimit të pasurisë. Kjo është ajo që i dha gruas myslimane një pozitë të madhe në shoqëri dhe e bëri atë pjesëmarrëse aktive në ndërtimin dhe zhvillimin e saj, me pasurinë dhe mendimin e saj.

2- E DREJTA E GRUAS NË MEHR

Mehri në Islam, i cili është një dhuratë e domosdoshme dhe dhënie e kërkuar për bashkëshortin nga bashkëshorti i saj, konsiderohet si një nga burimet më të spikatura të pronësisë për gruan, një nga të drejtat e saj financiare, në mënyrë që të mund të ketë jetën e vet ekonomike dhe të jetë një anëtare aktive në ndërtimin e shoqërisë së saj, për dallim nga epokat paraislame, ku gruaja nuk kishte të drejtë në mehr apo në ndonjë gjë tjetër, sepse ajo ishte si një plaçkë për ta me të cilën mund të vepronin si të donin. Në rast se është paguar diçka në martesën e saj, ajo ka qenë vetëm për kujdestarin e

*Ligjvënësi ka
caktuar burrin të
jetë përgjegjës për
gruan dhe që të
kujdeset për të
gjitha nevojat e saj
të domosdoshme,
dhe shto kësaj atë
pjesë që duhet t’i
jepet asaj si mehr,
pastaj edhe e
drejta e
trashëgimisë që
gruaja e meriton
me hise të
caktuara, atëherë
ku ekziston
padrejtësia e
shkaktuar ndaj
gruas?!*

saj, ndërsa ajo nuk ka pasur të drejtë në të. Kur erdhi Islami, ai e nderoi gruan dhe e obligoi bashkëshortin t’ia jap mehrin asaj, pavarësisht se sa i varfër qoftë ai, dhe kjo për shumë kuptime, prej tyre shfaqjen e rrezikut dhe rëndësisë së kontratës martesore, veçanërisht pasi subjekti i saj është qenia njerëzore, krijesa më fisnike, demonstrim të dëshirës së tij për t’u martuar me të, nderim të gruas, ngritje të statusit të saj, ruajtje të qëndrueshmërisë së lidhjes martesore, si dhe plotësim të nevojave të saj. Ai e shfuqizoi atë që ishte në kohën paraislame dhe e bëri mehrin pronë ekskluzive të gruas, duke mos pasur askush të drejtë në të. Zoti i Madhëruar thotë: “Grave jepuani dhuratën e kurorës së tyre (niqahin) më të mirë, e në qoftë se ato nga vullneti i vet ju falin diçka nga ajo, atëherë hajeni atë hallall të mirë.” (En Nisa, 4).

Në këtë ajet ka dëshmi, se gruaja mund të veproj çfarë të dojë me pasurinë e saj nëse është e pjekur dhe nuk është e lejueshme që dikush të marrë asgjë nga mehri i saj, pasi ai është një e drejtë e pastër e saj, dhe kushdo që e merr atë pa dëshirën e saj, ai ka e ka marrë atë padrejtësisht. Këtu, kuptimet e mëshirës së Islamit ndaj gruas u bënë të qarta kur i dha asaj të drejtën për të pasur pronë, kapacitet të plotë për të vepruar në pronën e saj dhe pavarësi financiare nga burri.

Legjislacioni islam ligjësoi për gruan të drejtën e mehrit dhe e bëri atë të shenjtë, deri në atë pikë sa asaj ia dha të drejtën e gjysmës së tij vetëm më lidhjen e kontratës së martesës para gjerdekut! Pra, cili ligj i ka

dhënë gruas një të drejtë të tillë?

Kështu, legjislacioni islam e liroi gruan nga skllavërimi i kujdestarëve të saj dhe nga tregtia e tyre me të, siç ishte rasti para Islamit, dhe caktoi mehrin për të dhe ia dha asaj të drejtën e pronësisë së tij. Ai atë e nderoi dhe ia bëri një entitet të pavarur dhe të respektueshëm, për të pasur një pozitë të madhe në ndërtimin e familjes dhe shoqërisë së saj, qytetërimi i së cilës nuk mund të arrihet pa pjesëmarrjen e saj.

1 El asabe janë të afërmit e të vdekurit që marrin pjesën më të lartë të pasurisë, por pa hise të përcaktuara paraprakisht. Ata janë bijtë e të vdekurit p.sh.



Feja e shqiptarit nuk është shqiptaria!

Hajrudin S. Muja

Në biografinë e nacionalistit anti-kolonialist, Mahatma Gandhit (1896-1944), është shënuar një tregim, se kur ai po kalonte pranë një lope, duke dhënë shenja nderimi ndaj saj, reagoi në habinë e një shoqëruesi të tij duke u shprehur: “solidarizohem me besimin e popullit tim!” Këtu duhet të jetë fundi i këtij shkrimi, sepse nuk ka arsye të vazhdojë më tutje, por çudia e botës shqiptare është më e madhe dhe më e vjetër se kaq. Konstatimi i Faik bej Konicës mund të jetë sot më i vërtetë se në kohën kur ai e shkroi: “Shqiptarët nuk ndahen në myslimanë e në të krishterë, por ndahen në dy anë: ana e kombëtarëve, në të cilën ka shqiptarë nga të gjitha besimet, dhe ana e zuzarëve.”¹ Këta të fundit ishin (dhe janë) “patriotët”, të cilët bëhen qesharakë me “patriotizmin” e tyre me: “lloj-lloj maskarallëqesh e teprimesh të shpëlara.”²

Shembullin më të freskët e kemi me një grup “patriotësh” të moshuar, të cilët në një

ambient të një ngrehine të papërfunduar të Deçanit, si një metaforë që të linte përshtypjen e ditëve të fundit të Jugosllavisë së dikurshme, pretenduan se po fillonin një “Lëvizje për braktisjen vullnetare të fesë islame”. Dolën me moton se “jemi vetëm shqiptarë” dhe si të tillë “feja e shqiptarit është shqiptaria”, një thënie që vazhdimisht e përdorin në mënyrë spekuluese, për të arsyetuar veprime idioeteske në llogari të “patriotizmit” të shpifur të tyre! Shpejt u organizuan debate “pro” dhe “kundër” dhe e bënë të madhe për hir klikimesh. Është thjesht ajo që thotë Konica: “një maskarallëq”, që bartë brenda vetes urrejtje patologjike ndaj një feje të cilës nuk i kanë takuar kurrë. Sërish me përrallat e përsëritura të tri dekadave se gjoja Islami po shkatërron kulturën shqiptare, se po bëhet shkak që të mos na dojë Evropa, se na bën të dukemi si vend i prapambetur arabo-aziatik me xhami e mjekra.

Janë njerëz të cekët, të cilët nuk kanë arritur ta kuptojnë se feja nuk ndryshohet në mënyrë të organizuar kolektive lëvizjesh e shoqatash, sepse është bindje individuale që bazohet në argumente të cilat ai mendon se i plotëson kriteret për të qenë pjesë e saj.



Janë njerëz të cekët, të cilët nuk kanë arritur ta kuptojnë se feja nuk ndryshohet në mënyrë të organizuar kolektive lëvizjesh e shoqatash, sepse është bindje individuale që bazohet në argumente të cilat ai mendon se i plotëson kriteret për të qenë pjesë e saj. Natyrisht gjenden edhe të tillë, ndonëse të paktë, të cilët në vend të bindjes kanë interesin personal që e fshehin “për shkak të kombit” ose “dashurisë për kombin”, por që në deklaratimet e tyre shfaqin të kundërtën e asaj që thonë. Të pranosh një fe në bazë të argumentit është një gjë dhe ta ndërrosh për shembull për një mundësi azili, është një gjë tjetër, zaten ne kemi postulatit kuranor që qartas thotë: “kush të dojë le të besoj, e kush të dojë le të mohoj!” Kaq e thjeshtë është kjo.

Këta janë thjeshtë disa “aktorë” të ri me “regji” të vjetër, me biografi të dyshimta, të mbytur në klithma që alarموjnë fundin e ekzistencës së tyre! Me vetëdije apo pa të, kanë qëllime dashakeqe dhe promovojnë shkatërrimin e tolerancës fetare, e cila përherë ka karakterizuar kombin shqiptar. Çështje e vërteta, në një farë mase e kuptoj dhe e arsyetoj nismën e tyre, sepse religjioni vërtet lufton servilizmin që mund t’u prishë shumë punë, por nuk kam fare dyshim se ky është një absurd që ka vdekur para se të lindë dhe nuk ja vlen të shpenzohet asnjë debat, asnjë shkrim dhe asnjë fjalë për të. Brengosës është fakti se në çgjendje kemi mbërritur! Për më tepër, është shqetësues burimi i ideve të tilla dhe “patriotizmi” i tyre i pretenduar i lidhur ngushtë me moton “Feja e shqiptarit është shqiptaria”.

Për të treguar sa pa shije dhe sa e pa vërtetë është bërë kjo, ne na duhet të kthehemi në kohën kur është shkruar kjo frazë. Fillimisht duhet të kuptojmë se intelektualët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare kanë qenë të gjithë ose shumica fetarë dhe besimtarë, që tregon se qasja e tyre nuk ishte qasje antifetare, ishte pikërisht e kundërta. Madje besimi i tyre nganjëherë ishte stresues dhe në njëfarë mënyre pengonte zhvillimin dhe konsolidimin e vetëdijes kombëtare, që ende ishte në embrion. Kjo qe arsyeja që Pashko Vasa, edhe ky fetar i devotshëm, shkroi poemën “O moj Shqipëri e mjera Shqipëri”, ku zë vend rreshti: “Feja e shqiptarit është shqiptaria”,³ por që në proporcion me gjithë tekstin e poemës dhe brenda kornizave dhe rrethanave të kohës në të cilin ai jetoi, nuk paraqet aspak një qasje antifetare.⁴ Ishte thjesht një thirrje për “bashkim kombëtar”, pavarësisht përkatësive të ndryshme fetare, sepse ky ishte kushti i vetëm për ekzistencën e kombit shqiptar.⁵ Të tillë mendim patën edhe rilindësit e intelektualët e tjerë të shquar shqiptarë, si Naim bej Frashëri, Faik bej Konica, Gjergj Fishta, etj..

*Këta janë thjeshtë
disa “aktorë” të ri
me “regji” të vjetër,
me biografi të
dyshimta, të
mbytur në klithma
që alarموjnë
fundin e
ekzistencës së tyre!*

I ndjeri Ali Basha ka shkruar një herë se në botën shqiptare nuk është ngatërruar asgjë më shumë se koncepti fe dhe komb, gjë që ka sjellë keqkuptimin dhe keqpërdorimin e motos “Feja e shqiptarit është shqiptaria”. Mohimi i shqiptarisë për shkak të fesë ka qenë politikë e të tjerëve, nuk ka qenë veti shpirtërore e shqiptarëve. Kjo nuk është moto që duhet të interpretohet si parullë antifetare, por si një reagim lëvizjesh të caktuara me ngjyrimet fetare për ndarjen e Shqipërisë.⁶

Motoja e Vasës nuk synonte ta zëvendësojë Zotin me Shqipërinë, por shprehte qartë nevojën e përbashkët për nacionalizmin shqiptar në një mjedis multireligjioz dhe nevojën për tolerancë, pa synuar në ndonjëfarë mohimi ose ateizmi.⁷ Thënë ndryshe, ishte një ftesë që u bëhej shqiptarëve për t’u bashkuar me përkushtim në çështjen e përgjithshme kombëtare, duke e lënë fenë si diçka personale. Ai i kishte kuptuar tendencat e rrezikshme për Serbinë e Madhe e Greqinë e Madhe! Kjo ishte thjesht një platformë politike e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, një koncept politik që duhej të bashkonte të gjithë shqiptarët, pa dallim feje e krahine, në një front të përbashkët.⁸ Myslimanët dhe katolikët shqiptarë – pohonte ai: “flasim po at gjuhë, kanë po ato zakone, vazhdojnë po ato doke e tradita. Midis tyre nuk ka pasur kurrë s’mirë të rrënjës, as armiqsira shekullore. Ndryshimi i fesë nuk ka qenë kurrë shkak për t’i shtyrë në përçarje sistematike”.

Pesë vjet para se Pashko Vasa të shkruante poemën e tij, një korrespondent i “Hamburgische Corrospondent” (9 qershor 1883), përdori të njëjtën frazë, me të cilën donte të thoshte se kur është në pyetje çështja për mbrojtjen e atdheut, shqiptarët janë bashkë pavarësisht përkatësive të tyre fetare.

Eqrem bej Vlora na tregon se edhe në kohën e tij, ishte një rrymë që dëshironte të minimizonte përkatësinë fetare islame shqiptare, një rrymë që u përhap nga politikat antishqiptare dhe antiosmane, të drejtuara nga priftërinjtë dhe politikanë të besimit ortodoks (sllavë e grekë), për arritjen e qëllimeve të tyre,¹⁰ ndërkohë që vetë Evropa i trajtonte shqiptarët si një koncept klanesh e familjesh dhe i ndante në bazë të përkatësive fetare.¹¹ Ky konstatim është i mjaftueshëm për të na treguar se prej nga u vijnë shqiptarëve ide të tilla dhe në shërbim të kujt janë! Vlora tregon bindshëm se: “Synimi im nuk është që të mbroj as turqit, as shqiptarët, por për hir të së vërtetës, dua të theksoj faktin se në këto 4-5 vjet, grekët, serbët, malazezët dhe bullgarët, kryen aq shumë krime ndaj shqiptarëve, sa nuk u bë as diçka e përafërt në 4 - 5 shekujt e sundimit osman”.¹²

S'do mend se lufta kundër Islamit dhe hoxhallarëve te ne, e nisur nga ruso-sllavët që nga koha e Revolucionit Bolshevik, ka vazhduar më pastaj nga komunistët për të ardhur deri në ditët tona. Enver Hoxha me fuqinë e madhe propagandistike që kishte regjimi i tij, e çoi deri në grotesk këtë projektim. Ai edhe fenë e quajti diçka “të huaj për shqiptarët”, që ia kishte sjellë armiku. Ne sot paguajmë, veç të tjerash, edhe ideologjizimin e thellë, me frymë totalitare, që i ka bërë ai mendjes së shqiptarëve për sa i përket vetëdijes historike. Kjo luftë e ndyrë e tyre ndryshon taktika, mënyra e metodologji, por në esencë është përpjekje anti-kombëtare, sepse atakon shumicën dërmuese të kombit tonë. Me të tilla lëvizje filloi edhe lëvizja komuniste, që dogji të gjitha dorëshkrimet, shembi kisha e xhami, mbylli institucionet fetare, ndërpreu kambanat dhe ezanin, zhdukuri të gjitha festat dhe e shndërroi njeriun në një robot ideologjik.¹³

Islami nuk është pengesë për kohezionin mbarëkombëtar, kjo fe ka qenë barrikada e presioneve të huaja, nuk ka program të dominimit mbi kombëtarizimin, por ka rregullin e vet më të përkryer politiko-shoqëror, ekonomik e kulturor, rregulli i cili mbarte me vete parimin më themelor: “Pa fe nuk ka atdhe”. Është pikërisht Islami, pa të cilin sipas Faik bej Konicës: “populli shqiptar do të ishte shumë më tepër në numër, por jo shqiptar”, të shpjeguar më qartë nga akademik Mark Krasniqi, se Islami “frenoi në masë të madhe procesin asimilues sllav, grek, bullgar dhe bizantin ndaj shqiptarëve, duke i dobësuar dhe shkatërruar mbretëritë e tyre”.¹⁴ Plot

*Thirrja e kësaj
lëvizje për të dalë
nga Islami është
një version i
përrallës së vjetër
“në fenë e të
parëve”, me qëllim
të njëjtë.*

intelektualë e akademikë kanë mbrojtur këtë tezë, duke shpjeguar se Islami dallonte etninë shqiptare nga serbët e grekët, dhe pikërisht konvertimin e shumicës shqiptare në Islam e argumentojnë si shpëtim të identitetit kombëtarë.¹⁵

Thirrja e kësaj lëvizje për të dalë nga Islami është një version i përrallës së vjetër “në fenë e të parëve”, me qëllim të njëjtë. Se në shërbim të kujt shkon kjo iniciativë na mëson vetë historia. Duke qenë se veprimtaria anti-islame teorike e Akademisë së Shkencave të Serbisë është e gjerë, unë do të mjaftohem me disa shembuj praktikë. Politika konvertuese e shqiptarëve është prezentë prej kohës së Nemanjës (1113-1200), Millutinit (1253-1321) dhe Dushanit (1336-1356), me kodin e veçantë për t'i kthyer të gjithë “në fenë e vërtetë” ose për t'i konfiskuar e vrarë, por atëherë shqiptarët nuk ishin myslimanë. Nuk qenë myslimanë as ata që migruan në 80 fshatrat e Italisë Jugore (Kalabri e Sicili), të cilët me urdhrin “Romanus Pontifex” (1564 dhe 1595) dhunshëm i konvertuan nga riti lindor (ortodoks) në ritin perëndimor (katolik). Për fatin tonë të keq, princërit shqiptarë edhe duke qenë të krishterë luftonin njëri-tjetrin.

Thirrja që u bëhet shqiptarëve “për braktisjen e Islamit” dhe konvertimin “në fenë e të parëve”, nisi me kolapsin përfundimtar të Perandorisë Osmane. Dhuna konvertuese gjatë viteve 1911, 1912 dhe 1916 ishte alarmante, pasi bashkë me sllavët, morën pjesë edhe disa fise katolike shqiptare, disa prej të cilëve (sipas burimeve austriake), luftonin nën urdhrat e komandantit serb Rashković.¹⁶ Një “episod” i kësaj periudhe



u njoh si “dita e kiametit në tokë”. Gjatë viteve 1912-1920, bëhej propagandë intensive për konvertimin e shqiptarëve, jo vetëm nga soldateska sllave, por edhe nga misionarët protestantë dhe nga kleri katolikë. Të parët propozonin evangelizmin e shpejtë të Shqipërisë,¹⁷ kurse të dytët nga Roma kishin lëshuar thirrje solemne për të kthyer në fenë e tyre “të vërtetë” ortodoksët dhe myslimanët shqiptarë, duke i quajtur këta të fundit “bijtë e errësirës”.¹⁸

Në revistën e përmuajshme “Lajmtari” (tetor 1923), në një ditë të shenjtë, jezuitët e Shkodrës, me duart e drejtuara drejt qiellit, kërkonin shëlbimin e të konvertuarit në fenë e të parëve, për 200 milionë myslimanët e botës, e në veçanti për myslimanët shqiptarë. Për këtë arsye hyri në polemikë Hoxhë Kadri Prishtina me revistën “Udha e s’vërtetës” (Vjeti I, #2, nanduer 1923, f.44-52).

Në prag të pushtimit fashist ishte bërë marrëveshja sekrete “Ciano – Stojadinoviq”, sipas së cilës deri në vitin 1949 do të konvertonte në krishterimin *unijatë* gjithë Shqipërinë bregdetare. Për instruktorë ishin caktuar priftërinj malazezë, të cilët kishin përvojë konvertimesh nga viti 1913. Në lidhje me këtë ‘fenomen’, konti Ciano (dhëndër i Musolinit) deklaronte: “Ne i kemi asimilue rreth 200 mijë shqiptarë në Italinë e Jugut, asgjë nuk do të na privojë që këtë proces ta vazhdojmë edhe në anët tjera të Adriatikut”. Më 1940 filluan përgatitjet në dy qendra, por u ndërpre në për shkak të disa kundërthënieve me Hitlerin.¹⁹

Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të KMSH-së (29 maj 1942), Ferid Vokopola dhe Sali Vuçiterni, shprehnin shqetësimin e tyre në lidhje me keqtrajtimet dhe detyrimet e fëmijëve jetimë, të çuar në Itali, që i detyronin të shkonin në kisha dhe atje po bëheshin përpjekje që edhe ushtarët shqiptarë t’i konvertonin në katolikë.²⁰ Edhe atëherë sikurse sot, brenda Shqipërisë përdoreshin të gjitha metodat e konvertimit të shqiptarëve, përmes mjeteve propagandistike, duke e vënë Islamit në bankën e të akuzuarve.

Edhe sot e njëjta gjë. Duke parë se bota gjithnjë e më shumë po shkon drejt humnerës me konflikte e vdekje të përditshme në Lindjen e Mesme dhe gjetkë, do të ishte e nevojshme të qëndrojmë jashtë këtyre debateve, sepse thirrjet publike për të ndryshuar fenë mund të shkaktojë çarje në trungun kombëtar në këto kohë të vështira. Ato që janë të etur për lëvizje të reja, do të bënin mirë të themelonin lëvizje me thirrje për zhvillim teknologjik, për shëndetësi moderne, për nivel më të lartë edukativo-arsimor, për punësim e paga dinjitoze, për debate njerëzore e akademike, për rikthimin e dinjitetit njerëzor, për familje të shëndosha e bashkëshortësi respektuese, për rikthimin e autoritetit të prindit e të profesorit, për frenimin e antivlerave, korrupsionit, narkotizimit, prostitucionit, pornografisë, vetëvrasjeve e vëllavrasjeve, intrigave, skandaleve e braktisjes së vendit!

Për kuriozitet, në faqet e revistës “Hylli i Dritës” të botuara 88 vjet më parë, është një tekst që më duket se i përshtatet shumë realitetit të sotëm: “Gjithkund ka fanatikë fetarë, afetarë e antifetarë, ashtu edhe në Shqypni, veç me këtë ndryshim, se te na nuk duket cili asht njani e cili tjetri, me formen e “afetarisë” po luftohet besimi në parim e me dukjen e hijeshme të komsisë e të qytetnimit, po ushqehet fanatizmi. ce mos kurrë, as ne kohet e robnisë. Ky pshtjellim ideshë asht katastrofal. A mund të dijë kush se në ç’breg do të na qesë?”²¹

Intelektualët shqiptarë e kanë shpjeguar qartë dhe në mënyrë të argumentuar, por disa të tjerë kanë zgjedhur të qëndrojnë ende në “shinat” e kalburat të “trenit” monist. Motoja e Vasës në çdo kuptim sot mund të “vlerësohet” si një kredo e eskaduar, ose së paku si një kredo që nuk na hynë fare në punë. Feja e shqiptarit nuk është shqiptaria për faktin e thjeshtë se shqiptaria nuk është dhe nuk mund të jetë fe. Cili komb tjetër, i madh apo i vogël i botës, merret me absurditete të kësaj kategorie? Unë nuk njoh ndonjë, po ju?

1 Albania, #1/1905.

2 Po aty.

3 Pashko Vasa: “Vëpra letrare”, I, (Shqypnia dhe Shqiptarët), Tiranë 1987, f.37-39.

4 Rexhep Qosja: “Ideologjia e shpërbërjes, trajtesë mbi idetë çintegruese në shoqërinë e sotme shqiptare”, Toena – Tiranë 2006, f. 23-28.

5 Hysamedin Feraj: “Skicë e mendimit politik shqiptar”, Tiranë, 1999, f.280

6 Ali M. Basha: “Rrugëtimi i fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)”, Tiranë, 2011, f.157.

7 Gazmend Shpuza: “Millet Sistemi emierçevesinde Arnavutların Durumu”, Osmanlı IV, ed. Güler Eren, Yeni Türkiye Yayınları, Ankara 1999, f.294-297.

8 Masar Rizvanolli: “Lufta e Serbisë dhe e Malit të Zi, për pushtimin e tokave shqiptare gjatë Krizës Lindore, 1875-1878”, Gjakovë 2007, f.295.

9 Historia e Popullit Shqiptar, II, Tiranë 2002, f.209.

10 Eqrem Bej Vlora: “Kujtime”, nga gjermanishtja nga Afrim Koçi, Tiranë 2003, f. 152, 335-336.

11 Ismail Hasani: “Vetëdija fetare dhe kombëtare tek shqiptarët”, Prishtinë 2001.

12 Eqrem Bej Vlora, po aty.

13 Musa Musai: “Integrimi i fesë dhe identitetit të muslimanët e Ballkanit”, Ištambul 2007, shën.27, f.25.

14 Mark Krasniqi: “Roli i Kishës Ortodokse Serbe në politikën anti-shqiptare në Kosovë”, f.75.

15 Roberto Moroco dela Roka: “Feja dhe kombësia në Shqipëri 1920-1944”, Tiranë, 1994.

16 Eqrem Zenelaj: “Çështja shqiptare nga këndvështrimi i diplomacisë dhe gjeopolitikës së Austro-Hungarisë”, Prishtinë 2010, f.128.

17 The Muslim World, #4/1914.

18 Alexandre Popovic: “Islamizimi Ballkanik – Myslimanët e Evropës Juglindore gjatë periudhës paosmane”, Shqipëruar nga: Dritan Egro dhe Sokol Haxhimusaj, Dituria 2006, f.33.

19 Hakif Bajrami: “Naçertania – Program politik serb që shpie në çfarosjen e shqiptarëve (1844-1999)”, Prishtinë 2004, f.263-264

20 Ali M. Basha: “Rrugëtimi i fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)”, Tiranë, 2011, f.312.

21 Hylli i Dritës, #4/1935.

Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (3)

MUHTESARI I KER'HIT

Hazir D. Selmani

Pothuajse në periudhën kur në Egjipt vepronte Tahaviu, në Bagdad jetonte dhe vepronte Ker'hi, e që ishte një personalitet tjetër shumë i madh i medhhebit hanefi. Ai është autor i veprës që llogaritet muhtesar-i i dytë fikhori i këtij medhhebi.

JETA E KER'HIT DHE VEPRIMTARIA E TIJ MEDHHEBORE

Për jetën e tij nuk kanë mbërritur shumë të dhëna edhe pse Sajmeriu deklaroi se po t'i kishte shënuar gjitha historitë për Ker'hin dhe Ebu Hazimin, atij do t'i duhej një libër i posaçëm. Emri i plotë i Ker'hit është Ubejdullah b. Husejn b. Dellal b. Delhem. Më i njohur është si Ebu'l-Hasen Ker'hi. Lindi në vitin 260 hixhri në një vendbanim të lashtë me emrin Ker'h Xhudam (Guddam), që ndodhej në fund të provincës së Irakut. Pastaj erdhi në Bagdad dhe këtu përvetësoi fikhun hanefi nën kujdesin e Ebu Seid Berderiut. Gjersa mësonte te Berderiu, ai për një kohë të shkurtër mësoi edhe nga kadiu Ebu Hazimi, mësuesi i Tahaviut.¹ Berderiu ishte prej fukahave të mëdhenj hanefi të Bagdadit, i cili pati debate edhe me vetë Davudin, themeluesin e medhhebit dhahiri.² Me kalimin e viteve, si dhe zgjerimin e diturive dhe përvojave, Ker'hi arriti që pas dy mësuesve të tij, të bëhej udhëheqësi i

hanefive të Bagdadit dhe medresesë hanefite irakiane. Në shumicën absolute të burimeve që flasin për jetën e tij, ai cilësohet si një dijetar me asketizëm të plotë e me devotshmëri të lartë, adhurues i madh, me namaz nate e agjërim dite, si dhe dhikre të shumta. Ai asnjëherë nuk hynte pa abdes në një dhomë ku kishte mus'haf. Qe durues i fukarallëkut dhe asnjëherë nuk e shtriu dorën të lypte lëmoshë ose diç nga pasuria e njerëzve.³ Tërë jetën e tij qëndroi larg posteve dhe detyrave zyrtare, madje edhe i shkëputte lidhjet e tija me nxënësit që bëheshin kadi. Rasti i tij me kadiun, Ebu'l-Kasim Tenuhi, është më se i njohur, me të cilin Ker'hi i shkëputi lidhjet edhe pse atë e kishte nxënësi dhe deri në fund të jetës më nuk e pranoi në mexhlis. Bile, pak para vdekjes së Ker'hit në vizitën e fundit që Tenuhi i pati bërë, Ker'hi nuk i foli as edhe një fjalë të vetme, por vetëm i dha një buzëqeshje.⁴ Në moshën 80 vjeçare u paralizua dhe në vitin 340 hixhri vdiq në Bagdad. Kur u sëmur, detyrën e mësimit dhe të la në dorën e nxënësit të tij, Ebu Ali Shashi, kurse detyrën e fetvave e la në dorën e nxënësit tjetër, Ebu Bekër Dameganit.⁵ Pak para vdekjes, nxënësit i kishin kërkuar ndihmë materiale princit hamdanid të Halepit, të njohur si Sejfudevleh, kjo për mjekimin dhe nevojat e hoxhës së tyre tanimë të paralizuar.

Në shumicën absolute të burimeve që flasin për jetën e tij, ai cilësohet si një dijetar me asketizëm të plotë e me devotshmëri të lartë, adhurues i madh, me namaz nate e agjërim dite, si dhe dhikre të shumta.

Ndërsa, kur mësoi Ker'hi këtë gjë, ai u lut duke thënë: *"Allahu im, mos më furnizo përveçse me riskun tim të zakonshëm!"* Pas vdekjes së tij arriti ndihma prej 10 mijë dirhemëve dhe të gjitha këto para u shpërndanë sadaka për shpirtin e Ker'hit.⁶ Ker'hi në burimet historike cilësohet si gjuhëtar i madh, poet i shquar, mufessir, fakih dhe usulij i madh hanefi. Ai sipas rangimit klasik të fukahave hanefi, e që është edhe rangimi hierarkik më i njohur, renditet në nivelin e tretë që njihet si rangi i muxhtehidëve të meseleve, ku krahas Ker'hit numërohen edhe dijetarët si: Hasafi, Tahaviu, Halvani, Serahsiu, Bezdeviu, Kadihani, etj.⁷

KER'HI DHE TAHAVIU

Ajo që dihet është se këta dy patën të paktën një mësues të përbashkët dhe një nxënës të përbashkët. Mësuesi është kadiu Ebu Hazimi, ndërsa nxënësi është Ebu Bekër Damegani. Gjithashtu në disa burime josunite shënohet se Ker'hi një kohë deklaronte: *"Në botë nuk ka më njeri që mund të bëjë ixhtihad veç Tahaviut në Egjipt."* Mirëpo, pastaj kur e pa Tahaviun në haxh thoshte: *"...Madje, as edhe Tahaviu në Egjipt!"*⁸ Kjo deklaratë nuk e ulë pozitën e Tahaviut, por dëshmon për të paktën një takim mes tyre, ku sigurisht është zhvilluar edhe ndonjë bisedë a debat që ka çuar në këtë vlerësim të Ker'hit. Nga ana tjetër, në librat e zgjeruara të fikhut hanefi, qëndrimet e këtyre dyve aty-këtu hasen përballë njëri-tjetrit, ku thuhet se qëndrimi i Ker'hit është kështu, e ndërsa qëndrimi i Tahaviut ashtu, edhe pse për shumë çështje të tjera hasen bashkërisht me të njëjtin qëndrim. Ndryshe nga Tahaviu, për akiden e të cilit nuk ka fare dyshim se ajo ishte pastër sunite dhe plotësisht e njëjtë

Ker'hi llogaritet dijetari hanefi, i cili pas Ebu Hanifes, Ebu Jusufit dhe Shejbanit pati numrin më të madh të studentëve.

me atë të Ebu Hanifes dhe dy nxënësve të tij të mëdhenj, Ebu Jusufit dhe Shejbanit, për akiden e Ker'hit, në mesin e dijetarëve ka diskutime. Kjo, për shkak të periudhës dhe vendit ku Ker'hi veproi. Historianët si Hatibi, Ibën Xhevzi, Dhehebiu, Ibën Kethiri, etj., krahas devotshmërisë së Ker'hit shënojnë se ai ishte prej mutezilëve. Mirëpo hafëz Ibën Haxher Askalani është më objektiv kur thotë: *"Ker'hi ishte njeri i devotshëm, njeri i hairit dhe i vlerave. Atë e pati akuzuar (rama-hu) për mutezilizëm Ebu'l-Hasen Ibën Furati."* Pastaj, këtë deklaratën e Ibën Furatit e shënoi Hatibi dhe prej tij u bë e famshme dhe e morën kallëp shumë historianë. Ndërsa kronisti i madh hanefi, Tekijudin Gaziu shënon: *"Hatibi e konsideroi atë (Ker'hin) si kokë të*

mutezilizmit, megjithatë Allahu e di më së miri hallin e tij, e ndërsa halli i Hatibit dhe fanatizmit të tij është më se i njohur, Allahu e faltë atë!" Po këtë fjalë të Gaziut e aprovon edhe Kumilai, kronisti i madh hanefi i kohës sonë.⁹ Mirëpo, një gjë është e sigurt se jeta e Ker'hit figuron në të gjitha veprat kronike të dijetarëve hanefi dhe për çudi asnjëri prej tyre nuk e paraqet atë si mutezili.

GJURMËT E KER'HIT

Ker'hi llogaritet dijetari hanefi, i cili pas Ebu Hanifes, Ebu Jusufit dhe Shejbanit pati numrin më të madh të studentëve. Kjo gjë vërtetohet me një lexim të thjeshtë të biografive të dijetarëve hanefi të Irakut që jetuan në periudhën e Ker'hit dhe pak pas tij. Bile këtë gjë e deklarojnë edhe ca njohës perëndimor të studimeve orietale-islame.¹⁰ Veçori tjetër është se me nxënësit e Ker'hit filloi periudha e komentimit (*el-shuruh*) të doracakëve të shkurtër (*el-muhtesarat*) të





fikhut hanefi. Fillimtari qe Xhesasi, që komentoi veprat *Muhtesar Tahavi* dhe *Muhtesar Ker'hi*, pastaj vijuan të tjerët. Në burimet e jetës së Ker'hit shënohen të paktën gjashtë vepra të tija dhe ajo që më së shumti na intereson është *muhtesar*-i tij i fikhut hanefi, e që sipas Afganit është *muhtesar*-i i dytë i fikhut hanefi, pas atij të Tahaviut.¹¹

MUHTESARI I KER'HIT

Muhtesari i Ker'hit ishte doracak bazë i shumë studentëve hanefi të Bagdadit. Materiali i tij ishte kriter vlerësues për shumë dijetarë të asaj periudhe. Koha e shkrimit të tij nuk dihet edhe pse sigurisht ngjau pas shkrimit dhe përhapjes së *Muhtesar Tahavit*. Sot si kopje në vetvete nuk ekziston më dhe llogaritet libër i humbur edhe pse Mer'ashliu pretendon se një kopje e tij ekziston në Stamboll,¹² mirëpo kjo gjë duket shumë e vështirë edhe pse jo e pamundur. Sigurisht në pushtimin mongol të Bagdadit, në mesin e veprave të zhdukur ishin edhe kopjet e këtij doracakut të hanefive. Pra, edhe në shqip nuk pritet të gjendet diç e përkthyer prej tij, përderisa llogaritet i humbur në vetë botën arabe. Kuduriu deklaroi se, Ker'hi, e nisi librin e tij që ai të dalë si një version shumë i shkurtër. Mirëpo, pas kapitujve të ibadeteve u zgjerua pakëz më shumë si dhe prej kapitullit të hipotekës u zgjerua tërësisht. Përderisa mbetet libër i humbur, atëherë edhe nuk mund të thuhet se sa kapituj përfshinte, edhe pse Kuduriu jep shenjë se autori la disa kapituj pa përmendur. Gjithashtu nuk mund të gjykohej se ku u bazua saktësisht në përpilimin e tij edhe pse nuk ka dalë jashtë kornizave të medhhebit hanefi.

Për atë se a ka pasur edhe përzgjedhje individuale dhe opinione personale nuk mund të thuhet gjë. Haxhi Halifeja citon Ker'hiun të ketë thënë në *el-Muhtesar*: “Kush dëshiron të kalojë përtej asaj që kemi shënuar në këtë libër (el *Muhtesar*), le të shikojë veprën el *Xhamiu's-Sagir* të shkruar nga ne. E ndërsa kush dëshiron akoma më shumë, atëherë le të shikoj el *Kebirin* (el *xhamiu'l-Kebir*), i cili përmbledh gjithçka.”¹³ Deklarata e sipërpërmendur e Kuduriut është si në vijim: “...Patët përmendur gjendjen e Muhtesarit të shejh Ebu'l-Hasen Ker'hit, rahimehullah, dhe nevojën për komentimin e tij. E që ky libër ka përmbledhur degëzime të fikhut në atë formë që së ka bërë tjetër kush. Bile, Ebu Ali Shahi thoshte se kush e memorizon këtë libër ai konsiderohet më hafëzi në mesin e dijetarëve tanë dhe kush arrin ta kuptoj këtë libër ai është më i mençuri në mesin e dijetarëve tanë. Ky libër ka një renditje të dallueshme, ngase autori atë e filloi që të jetë një libër i vogël, mirëpo pastaj shtoi në të pas (kapitullit të) ibadeteve, e ndërsa kur e kaloi kapitullin e hipotekës u zgjerua tej mase. Unë (Kuduriu) punova për të diktuar një libër gjithëpërfshirës që do ta komentonte atë (*Muhtesar Ker'hin*) duke u nisur me sqarimin e degëzimeve fikhere dhe rivajeteve si dhe renditjen e tyre, ndërsa për meseletë divergjente do të shënoj më pak. E kush dëshiron më gjerësisht, atë e kemi përmbushur në librin tonë el *Texhrid*. Po ashtu, në të (doracakun e komentuar) kemi shtuar asi degëzime fikhu që i ka hije, kjo për ta balancuar fillimin e librit me fundin e tij. Pastaj kemi shtuar në këtë vepër edhe ata kapituj që autori (Ker'hi), rahimehullah, i pati lënë dhe në

fund do t'i komentojë të gjithë..."¹⁴ Mulla Ali Lexuesi, këtë doracak e vlerëson kështu: "Litari më i sigurt për të cilin kapen dijetarët e fesë dhe eprorët e të devotshmëve."¹⁵

KOMENTET (EL-SHURUH) TË MUHTESARIT TË KER'HIT

Për Muhtesarin e Ker'hit numri i komenteve bie në gjashtë, dhe të paktën deri më tani, tre prej këtyre komentarëve ekzistojnë si dorëshkrime, ku njëri është i botuar. Nevoja e komentit të këtij *muhtesari* ishte e madhe siç deklaroi vetë Kuduriu pak më parë. Komentet¹⁶ e *Muhtesar Ker'hit* janë:

1. Komenti i Razi Xhesasit (vdiq 370 hixhri). Kjo vepër deri më tani llogaritet e humbur edhe pse në disa shënime të Kevtheriut aludohet se ai ka pasur qasje në brendinë e tekstit të këtij komentari, ngase ai thotë: "Vrullshmëria e Xhesasit në medhheh duket në veprat e tija Ahkamu'l-Kuran, el Fusulu fi'l-Usul, Sherhu'l-Xhami el Kebir, Sherhu Muhtesar et Tahavi dhe Sherhu Muhtesar el Ker'hi." Pastaj, në një shënim tjetër thotë: "Prej librave më të mira të dijetarëve të hershëm në fushën e haditheve të fikhut (ehadithu'l-ahkam) përveç sahihëve, suneneve dhe musnedeve janë edhe veprat Musannef i Ibën Ebi Shejbes, veprat e Tahaviut e sidomos Meani'l-aathar, veprat e Ibën el Mundhirit e sidomos el Ishraf, komentet e Xhesasit mbi Muhtesar Tahavi dhe mbi Muhtesar Ker'hi, el Xhami el Kebir...", në një vend tjetër thotë: "Suneni i Ebu Davudit është prej veprave më të dobishme hadithore për ata që merren me hadithet e fikhut (hallallit & haramit)...prandaj gjejmë se imam Ebu Bekër Razi Xhesasi i kushtoi shumë rëndësi këtij suneni si dhe hadithet e tija i zotëron mirë, sidomos në dy komentet e tija mbi veprën El Xhami el Kebir si dhe në dy komentet e tija mbi Muhtesar Tahavi dhe Muhtesar Ker'hi."¹⁷ Xhesasi si dhe Xhuëli në vijim ishin nxënës të Ker'hit.

2. Komenti i Xhuëlit (vdiq 399 hixhri). Ky koment llogaritet i humbur që moti kohë.

3. Komenti i Kuduriut (vdiq 428 hixhri). Prej këtij koment ekzistojnë ca kopje të plota në Turqi. Ndërsa së fundmi kjo vepër është botuar në Kuvajt në 9 vëllime, afërsisht 5500 faqe, duke përfshirë edhe shënimet marginale të recensuesit. Kuduriu është nxënës i nxënësit të Xhesasit. Ky punim i Kuduriut citohet me të madhe në literaturën e zgjeruar të fikhut hanefi, sidomos në fushën e veprave *esh shuruh* dhe *el fetava*. Me sa duket puna e Kuduriut në këtë komentar është ajo që e shpëtoi nga zhdukja shumicën e tekstit të këtij doracaku edhe pse është mjaftë e vështirë të bëhet vija ndarëse mes fjalëve të Kuduriut dhe atyre të Ker'hit.

4. Komenti i Ispixhabit të Madh (vdiq 481 hixhri). Autori i tij është Ebu Nesr Ahmed b. Mensur Huxhendi Ispixhabi (Isfixhabi) el Kebir. Flitet për një kopje dorëshkrimi të tij në Turqi.

5. Komenti i Kirmanit (vdiq 543 hixhri). Fatmirësisht edhe kjo vepër ekziston si dorëshkrim në disa biblioteka të Turqisë, porse akoma nuk e ka parë dritën e botimit bashkëkohor.

6. Komenti i Kutlubugasë (vdiq 879 hixhri). Si vepër përmendet nga SeHAVIU dhe Merashliu. Llogaritet libër i humbur.

- 1 Kadi Ebu Abdilah Sajmeri, *Ehbaru Ebi Hanifeh ve Es habihi*. (Rijad: Alemu'l-kutub, botimi i dytë, 1985), fq. 161, 165 dhe 166.
- 2 Abdulkadir el Kurashi, *El Xhevahiru'l-mudijeh fi Tabekati'l-Hanefijeh*. (Rijad: Hexhr, botimi i dytë, 1993), vëll. 1, fq. 164.
- 3 Shiko: Ibën el Xheuzij, *el-Muntedham fi tarihi'l-muluki ve'l-umem*. (Bejrut: daru's-Sadir, botimi i parë, 1979), vëll. 6, fq. 369; Dhehebi, *Sijeru ealami'n-nubela*. (Bejrut: muesesetu'r-risaleh, botimi i tretë, 1985), vëll. 15, fq. 426; Dhehebi, *Tarihu'l-islam ve vefejatu'l-meshahiri ve'l-ealam*. (Bejrut: daru'l-garbi'l-islamij, botimi i parë, 2003), vëll. 7, fq. 742; Ibën Kethir, *el-Bidajeh ve'n-Nihajeh*. (Rijad: daru'l-hexhër, botimi i parë, 1997), vëll. 15, fq. 209; Ahmed bin Jahaj bin el Murteda, *Tabekatu'l-mu'ezileh*. (Bejrut: daru mektebeti'l-hajat, 1961), fq. 130; etj.
- 4 *Ehbaru Ebi Hanifeh ve es'habih*, fq. 167.
- 5 Po aty, fq. 169.
- 6 *Sijeru ealam'in-nubela*. Vëll. XV, fq. 426-427.
- 7 Ibën Abidin, *Radu'l-Muhtar ale'd-durri'l-muhtar*. (Damask: daru'th-the kafeti ve't-turath, botimi i parë, 2000), vëll. 1, fq. 254.
- 8 *Tabekatu'l-mu'ezileh*. Fq. 130.
- 9 Për debatin e akides së Ker'hit shiko: Hatib el Bagdadi, *Tarihu Bagdad*. (Bejrut: daru'l-garbi'l-islamij, botimi i parë, 2002), vëll. 12, fq. 74; *el Muntedham fi tarihi'l-muluki ve'l-umem*, vëll. 6, fq. 369; *Sijeru ealami'n-nubela*, vëll. 15, fq. 427; *el-Bidajeh ve'n-Nihajeh*, vëll. 15, fq. 209; Ibën Haxher el Askalani, *Lisanu'l-Mizan*. (Bejrut: daru'l-beshairi'l-islamijeh, botimi i parë, 2002). Vëll. 5, fq. 321; Tekijudin el Temimi el Gazij, *el-Tabekatu's-senijeh fi teraxhimi'l-hanefijeh*. Rijad: Hexhër & Daru'r-Rifajj, botimi i parë, 1989. Vëll. 4, fq. 422; el Kumilai, *el-Buduru'l-Medijeh fi teraxhimi'l-hanefijeh*. (Kajro, daru's-salih, botimi i dytë, 2018). Vëll. 12, fq. 181; etj.
- 10 Christopher Melchert, *The Formation of the Sunni Schools of Law, 9th-10th centuries c.e.* (Leiden: Brill, 1997), fq. 125.
- 11 Ebu'l-Vefa Afgani. Hyrja studimore e *Muhtesar Tahaviut*. (Kajro: metbeatu dari'l-kitabi'l-arabij, 1951), fq. 4.
- 12 Jusuf Abdurrahman el Mer'ashli, *Mesadiru'd-Dirasati'l-islamijeh el-fikhu'l-hanefiju furuan ve usulen*. (Bejrut: DKI, 2020), vëll. 1, fq. 131
- 13 Katip Çelebi, *Keshfu'dh-Dhunun an esamij el-kutubi ve'l-funun*. (Londër: Al-Furqan Foundation, 2021), vëll. 3, fq. 185, lib. nr. 5217.
- 14 Kuduri, *Sherhu Muhtesar el-Ker'hi*. Stamboll: dorëshkrim me numër 804 në bibl. Fejzullah efendi. Vëll. 1, fq. 2a.
- 15 Ali Lexuesi, *El Ethmaru'l-xhenijeh fi esmai'l-hanefijeh*". (Bagdad: Divanu'l-vakfi's-sunij, botimi i parë, 2009), vëll. 2, fq. 489.
- 16 Për komentet e Muhtesarit të Ker'hit shiko: Abdullah el Habeshi, *Xhamiu'sh-shuruh ve'l-havashi*. (Xhide: daru'l-minhaxh, botimi i parë, 2017), vëll. 4, fq. 147; *Mesadiru'd-Dirasati'l-islamijeh*, vëll. 1, fq. 131, 141, 202, 269; *Mesadiru'd-Dirasati'l-islamijeh*, vëll. 2, fq. 127; SeHAVI, *El-dau'l-lamië li ehli'l-karni't-tasië*. (Bejrut: daru'l-xhil, botimi i parë, 1992). Vëll. 6, fq. 187, bio. nr. 635.
- 17 Zahid el Keutheri, (*Hyrja studimore*) *Risaletu Ebi Davud*. (Kajro: metbeatu'l-envar, 1950), fq. 2; *Mekalatu'l-Keutheri*. (Kajro: el-mektebetu't-teufikijeh). Fq. 452; *Mekalatu'l-Keutheri*, fq. 83.

Ndikimi i tjetrit në ndërtimin e imazhit personal

PhD Merjeme Gashi

Në kohët e sotme, rrjetet sociale janë bërë pjesë e pashmangshme e përditshmërisë sonë. Përpos realitetit të cilin e jetojmë dhe ndaj të cilit jemi dëshmitarë, ekziston edhe një “realitet virtual”, i cili çdoherë e më shumë po bëhet vështirë i ndarë nga ai i vërteti. Në këtë shkrim do të përpiqem të analizojë konceptin e identitetit, imazhit personal dhe rëndësisë së *tjetrit* në krijimin e këtij imazhi, konformimit ndaj shumicës dhe shndërrimit të individëve në njerëz *njëdimensional*, të kontrolluar nga forma të reja të kontrollit shoqëror, siç është teknologjia.

Në pyetjen se çka është identiteti, mund të themi se është përgjigja që i jepet pyetjes, “Kush jam unë?”. Identiteti ynë buron nga rolet që ne i luajmë dhe raportet që i krijojmë.¹ Etimologjia e termit “identitet” vjen nga emri latin *identitas*, i cili thekson imazhin mendor të një individi për veten dhe “ngjashmërinë e tij me të tjerët”. Identiteti ka karakter multidimensional, që do të thotë se varësisht në çfarë roli dhe statusi gjendemi, atë identitet e shfaqim. Identiteti kombëtar, etnik, racor, fetar, gjinor, politik, profesional, janë disa prej identiteteve që mund t'i ketë një individ.

Njeriu si qenie është i dalluar me arsye dhe imagjinatë, atij i duhet të krijojë një ide për veten e vet dhe të thotë: “Unë jam Unë”. Për dallim nga kafsha, njeriu ka nevojë për ndjenja identiteti.² Ndër të tjerash, ai ka nevojë për të hyrë në marrëdhënie me botën e jashtme në mënyrë që ta shmangë vetminë.³

Erich Fromm, përfaqësues i Shkollës së Frankfurtit dhe Teorisë Kritike, në librin e tij

“*Arratisje nga Liria*” (1941), gjatë analizës së konceptit të lirisë, thotë se liria e individit nga lidhjet tradicionale të shoqërisë mesjetare, ndonëse i dha individit ndjenjë e lirisë dhe pavarësisë prej autoritetit të atëhershëm, në të njëjtën kohë, e bëri të ndihej i vetëm dhe i izoluar, me dyshime dhe ankthe të cilat e bënë që t'i nënshtrohej një autoriteti të ri anonim dhe irracional.⁴ Njeriu modern fitoi lirinë, por krijoi tipa të reja të varësisë. Në përpjekje për t'i shpëtuar vetmisë dhe pafuqisë, Fromm thotë se jemi të prirë të shkatërrojmë dhe sakrifikojmë Unin tonë përmes disa mekanizmave të arratisjes nga liria, siç janë *nënshtrimi* dhe *konformimi*. Në kohën moderne, *nënshtrimi* dhe *konformimi*, zëvendësojnë format e vjetra të autoritetit⁵ dhe luajnë rolin e mekanizmave mbrojtës të individit nga ndjenja e vetmisë dhe ankthit. Si pasojë e konformimit, njeriu “shndërrohet në një automat, identik me miliona automat tjerë”.⁶ Procesi i “rahatisë” që sjellë konformimi nuk merr fund këtu, pas humbjes së Unit, fillon paniku që sjellë humbja e identitetit dhe për ta mundur këtë panik, njeriu është i detyruar të krijojë një identitet tjetër, i cili është në miratimin e vazhdueshëm nga ana e të tjerëve.⁷

Koncepti i vetes apo i imazhit personal është ngushtë i lidhur me atë të identitetit, pra me mënyrën se si ne e perceptojmë veten në raport me vetveten dhe të tjerët. Erving Goffman, përfaqësues i teorisë së Ndërveprimit Simbolik, në veprën e tij “*Prezantimi i Vetes në Jetën e Përditshme*” (1959), flet për ndërtimin social të vetvetes

Etimologjia e termit “identitet” vjen nga emri latin identitas, i cili thekson imazhin mendor të një individi për veten dhe “ngjashmërinë e tij me të tjerët”.



në një botë, të cilën, Goffman, e konsideron të jetë një *skenë*. Teoria e Goffman-it përqendrohet në kontekstin e sjelljes njerëzore, të bazuar në përshtypjen e tjetrit për veprimin apo sjelljen. Ai studioi rolet që luajnë individët, se si ato role ndryshojnë varësisht situatave dhe llojet e maskave që njerëzit mbajnë. Përmes modelit dramaturgjik, Goffman përshkruan jetën shoqërore si një jetë që luhet nga aktorët në një teatër me disa skena.

Goffman, ndër të tjerash i vë theks tensionit që rezultojnë nga ndryshmi mes asaj që njerëzit presin që ne të bëjmë dhe asaj që ne duam të bëjmë në mënyrë spontane.⁸ Për të pasur një imazh të qëndrueshëm të vetes së tyre, njerëzit interpretojnë për audiencën e tyre sociale. Njerëzit paraqesin imazhe të vetvetes bazuar në mënyrën se si shoqëria mendon se duhet të veprojnë në një situatë të caktuar. Goffman përshkruan shfaqjet teatrale që ndodhin në ndërveprimet ballë për ballë. Ai mendon se kur dikush vjen në kontakt me një person tjetër, ai përpaket të kontrollojë ose të drejtojë përshtypjen që personi tjetër do të krijojë për të, duke ndryshuar mjedisin, pamjen dhe mënyrën e tij.

Herbert Marcuse, një ndër përfaqësuesit kryesor të Shkollës së Frankfurtit, në librin e tij të njohur *“Njeriu Njëdimensional”* (1964), zhvillon kritikën e shoqërisë bashkëkohore duke teorizuar format e reja të kontrollit shoqëror. Marcuse, argumenton se “shoqëria e përparuar industriale” krijon nevoja false, të cilat i integrojnë individët në sistemin ekzistues të prodhimit dhe të konsumit. Teknologjia shërben për të krijuar forma të reja, më efektive dhe më të këndshme të kontrollit shoqëror dhe të kohezionit shoqëror.⁹

Marcuse dallon dy lloje të nevojave, nevojat e vërteta dhe nevojat e rreme. Shumica e nevojave mbizotëruese për t’u shtendosur, për të bërë qejf, për t’u sjellë dhe për të konsumuar në përputhje me reklamat, për të dashuruar dhe urryer atë që dashurojnë dhe urrejnë të tjerët, hyjnë në këtë kategori të nevojave të rreme. Nevoja të tilla kanë një përmbajtje dhe një funksion shoqëror, që përcaktohen nga fuqi të jashtme, ndaj të cilave individ *nuk* ka kontroll. Në të njëjtën kohë, këto nevoja false e zhvendosin individin nga identiteti i vet duke u identifikuar me të tjerët.¹⁰

Sot njëri nga kontrolluesit më të mëdhenj të sjelljes së njeriut modern rezultojnë të jenë rrjetet sociale, të cilat janë shndërruar në një formë të re të kontrollit shoqëror. Perceptimi i imazhit është kufizuar dhe reduktuar në *dukjen* apo në “kulturën vizuale”. Platformat e ndryshme mediale si Facebook, Twitter, Instagram, YouTube etj., janë bërë mjedise që mundësojnë prezantimin e vetes në terrenin *online*. Media sociale është duke u shndërruar në një sferë të re publike, e cila ua mundëson njerëzve të krijojnë dhe shfaqin identitete të ndryshme duke i atribuar vetes më shumë cilësi dhe vlera nga çka i posedojnë. Paraqitja e vetes ndryshe nga çështje në të vërtetë diktohet nga ajo se çka kërkohet dhe pranohet si “normale”, “e dëshirueshme” apo “e denjë” për masën për një kohë dhe vend të caktuar. Për Marcuse-n, ideja e “lirisë së brendshme”, tregon hapësirën private ku njeriu mund të bëhet dhe të mbetet “vetvetja”. Por, kjo hapësirë private është pushtuar dhe zvogëluar sot nga realiteti teknologjik. Mungesa e aftësisë për mendim original dhe kritik rezultojnë në një univers “njëdimensional” të të menduarit dhe të sjellit.

Asnjëri nga teoricienët e cituar lart nuk ishin dëshmitarë të rolit dhe ndikimit të rrjeteve sociale në jetën e njeriut modern, por përmes teorive dhe koncepteve të tyre marrin kuptim shumë sjellje të njeriut modern dhe shoqërisë kapitaliste. Teoria e Goffman-it për *veten*, ajo e Marcuse-s për nënshtrimin e individëve ndaj nevojave false dukë u shndërruar në njerëz *njëdimensional* dhe e Fromm-it për lirinë dhe ikjen e individit nga ajo duke u shndërruar në dikë ose në diçka jashtë vetvetes për t’u bërë identik me miliona njerëz të tjerë, vazhdojnë të jenë relevante edhe sot.

1 James W. Vander Zanden, *Social Psychology*, New York, McGraw-Hill, Inc., 1987, f. 141.

2 Erich Fromm, *Shoqëria e Shëndoshë*, Tiranë, Fan Noli, 2012, f. 62.

3 Po aty, f. 24.

4 Erich Fromm, *Arratisje nga Liria*, Tiranë, Phoenix, 1998, f. 84.

5 Po aty, f. 106.

6 Po aty, f. 141.

7 Po aty, f. 155.

8 George Ritzer dhe Douglas Goodman, *Teoria Sociologjike*, Tiranë, Ufo Press, 2008, f. 374.

9 Herbert Marcuse, *Njeriu Njëdimensional*, Tiranë, Plejad, 2006, f. 23.

10 Po aty, f. 28-30.

Triumfi i së vërtetës islame

Mimoza Sinani

I

Ishte pranverë. Moti ndërronte vazhdimisht. Ndodhte një alternim i çuditshëm kohësh me diell e shi. Edlira ishte ulur pranë dritares dhe po shijonte ëmbëlsinë e trokitjes në xham të pikave të një shiu të butë e të ngrohtë pranveror që sapo kishte filluar të binte. Ajo e donte diellin, por e donte shumë edhe shiun. Shi u bënte melankolike dhe e fuste në meditime të thella.

Rrekëzat e holla të shiut linin gjurmë vijash që dredhnin në hapësirën e xhamtë. Kohët e rënies së shiut ishin të vetmet kohë në të cilat ajo përqendrohej fort në thellësinë e vetvetes, meditante për të shkuarën dhe ëndërronte për të ardhmen. Iu kujtuan turbull fragmente nga fëmijëria e saj. Mendimet iu kthjelluan kur solli në mend ditën e parë të shkollës.

Iu kujtua vetja: një vajzë e vogël me shikim të druajtur, me hapa të ngadaltë, me flokë të thurura gërshet të lidhura me kordele të kuqe. Por sot nuk ishte më ajo vajza e habitur që priste me padurim të fillonte të lexonte dhe të mësonte. Vitet kishin rrjedhur dhe filizi i saj i njomë dhe delikat ishte forcuar për t'u bërë ballë me sukses rrebesheve të kohës.

Shkolla i kishte dhënë ndjesinë e një limani të qetë në të cilin ajo kishte hedhur spirancën e anijes dhe ishte ankoruar në pjesën e parë të jetës së saj, për të mësuar, për t'u aftësuar dhe për t'u forcuar që më pas të çante me guxim në ujërat e thella të oqeanëve pafund, për t'u bërë ballë sfidave dhe për t'u ndier e sigurt nga tallazet e trazuara të jetës.

Ndjeu një fllad freskie dhe kujtimet i rrodhën nga shpirti tërë ngazëllim.

Ishin të gjithë të rinj, me mendime e zemra të pastra. Njohja e vetvetes dhe gjetja e identitetit ishin momente të rëndësishme në adoleshencën e tyre, një fazë që përcaktonte të ardhmen e tyre dhe zgjidhte enigmën se kush ishin ata në të vërtetë. Ishte një moshë kur ata vërenin, vlerësonin, reagonin, pohonin, mohonin, qortonin dhe mundoheshin të

integroheshin duke dhënë mendimin dhe gjykimin e vetë atyre.

Edlira hodhi vështrimin jashtë. Larg në horizont, një vazhdë resh të hirta në të bardhë qëndronin pezull. Disa dallëndyshe fluturuan para dritares si për të treguar me ecejaket e tyre se ishin kthyer nga shtegtimi i largët.

Edlira ndezi televizorin dhe u tulat në kolltuk.

Atmosfera e ndezur e zgjedhjeve elektorale të një muaji më parë ishte qetësuar. Stuhia propaganduese e krijuar nga klasa mediatike ishte fashitur. Hapësira publike shqiptare kishte dëshmuar edhe njëherë zgjatimin e trishtë të mentalitetit të



ngjizur në diktaturë. Zinxhirët ngulfatës të mentalitetit të ngjizur në kornizat e ngurta të ideologjisë së dështuar totalitariste e kishin penguar politikën që të pastrohej nga fosilet e së kaluarës.

E vetmja gjë e dukshme që kishte ndryshuar në qytetin e saj dhe e kishte mbushur hapësirën boshe të stuhisë propaganduese elektorale ishte emërimi i drejtorit të ri në shkollën e saj, një militant i partisë që sapo kishte ardhur në pushtet.

E nesërmja u gdhi me diell. Edlira jetonte në një qytet të bukur klimaterik që shtrihej buzë një liqeni të freskët dhe të kaltër. Disku i zjarrtë i diellit ndriçonte plot ëmbëlsi lart në kupën qiellore dhe shpërndante ngado rrezet e tij të ngrohta. Ajo, si zakonisht, mori udhën për në shkollë. Hodhi shikim lart në qiellin e hapur dhe pa se si lëvizte tërë ai qiell i lartë sipër kreshtave të maleve dhe e ndjeu veten shumë të vogël.

Nxënësit ecnin grupe-grupe në rrugët e qytetit të qeshur e të gëzuar si për të larguar monotoninë e ditëve të ftohta të dimrit. Rrugët e qytetit dukeshin si një lumë që rridhte vazhdimisht. Gjithçka gjallëronte dhe frymonte lirshëm. Pasi la bulevardin e rrugës kryesore u kthye majtas për të vazhduar rrugën që e çonte për në shkollë. Shkolla gjendej jo më shumë se treqind metra larg liqenit kaltërosh. Në ajër ndihej aroma dehëse e luleve të blirit.

U ngjiti në katin e tretë dhe hyri në klasë. Klasa ishte mbytur në dritë dielli pranveror. Nga dritarja qyteti dukej se lante sytë në ujërat e ndritshme pors i argjend të liqenit të bukur. Në syprinën e liqenit përvijoheshin dridhjet e lehta të ngjyrave dhe qetësia e tij thyhej nga klithmat e pulëbardhave që fshiknin ujin me krahët e tyre.

Klasa gumëzhinte nga zërat gazmorë të shokëve e të shoqeve. Në derën e klasës u shfaq arsimtarja dhe zërat u ndalën. Arsimtarja mbylli derën ngadalë, hodhi shikimin mbi fytyrat e nxënësve dhe me hap të ngadaltë u afrua te tavolina e vet. Klasën e pushtoi qetësia. Ajo hapi regjistrin dhe shënoi diçka shpejt e shpejt. U ul në heshtje në karrigen e vet dhe e humbi shikimin diku jashtë dritares. Pastaj me një zë ku ndihej një turbullim i përzier me keqardhje, lexoi vendimin e drejtorit të sapoemëruar për përjashtimin nga shkolla të Fatmës, për shkak të veshjes së saj islame, nën pretekstin se shkolla është laike. Fjalët e mësues u ngritën si re të zeza mbi kokat e nxënësve. Zëri i saj u përplas në mure dhe në klasë mbizotëroi një heshtje varri. Fytyrat e nxënësve u hutuan dhe u ngurtësuan. Çdo gjë dukej se qëndronte pezull, fjalët ngrinë.

Xhami i kthjellët i dritares u mjegullua, ndërsa hapësira e kaltër e qiellit dukej si e fundosur në shkretëtirën e gjerë e të hapët të liqenit. Rrezet e diellit sikur donin të shkrinin ngurtësinë, ndërsa uji i turbullt i liqenit, që donte të kthjellej, vështronte me dëshpërim qiellin e kaltër.

Ka disa raste kur heshtja është mburoja më e mirë, por në disa raste brenda heshtjes rritet një shpërthim i ri, i fortë, i papritur.

Papritmas u dëgjua zëri kundërshtues i Sokolit, i cili shquhej për shkak të njohurive të gjithanshme dhe përgatitjes së tij të lartë. Ai u ngrit rrëmbimthi dhe duke mbajtur në dorë fletoren e tij të shënimeve tha:

- Mësuese! Në nenin 24 të Kushtetutës, në pikën e parë dhe të dytë, thuhet se "Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve". Edhe në nenin 18 të Konventës së Kombeve të Bashkuara, që konsiderohet si e shenjtë, thuhet se "Secili ka të drejtën e mendimit të lirë, të vetëdijes dhe të besimit, e kjo e drejtë nënkupton edhe lirinë e manifestimit, si individualisht ashtu edhe në bashkësi me të tjerët, të besimit apo mësimit fetar, kryerjen dhe mbajtjen e riteve fetare."

- Pra, ky nuk është laicitet, por është një diskriminim i fortë fetar – e përfundoi ai revoltën e vet.

Edlirës iu kujtua thënia e Solonit "Ligjet janë si puna e pezhishkave të merimangave, të dobëtit dhe të vegjlit ngecin në to, kurse të pasurit dhe të fuqishmit i bëjnë copa-copa." Vendimi dhe sjellja e paskrupullt e drejtorit i ngjalli ndjesinë e "argëtimit të egër subkoshient" si në lashtësi, në stadiumin e Koloseut Romak, për jetën dhe gjakun e gladiatorit, kërkesë kjo që përmbante tmerrin e gishtit të drejtuar poshtë.

Ajo ndjeu një valë nxehtësie t'i hipte në fytyrë. Një fërgëllimë i kaloi nëpër trup dhe brenda qenies së saj u formua një boshllëk. Ndjeu një shterpësi në shpirt dhe nuk po arrinte ta kuptonte atë që po ndodhte. Vetja dhe shokët e saj iu dukën si ca avuj të lehtë uji që vetëm po të bashkoheshin e po të ngriheshin lart mund të formonin një shi të furishëm dhe ashtu si shiu që e ndryshon, e transformon dhe e përtërit tokën e thatë e të plasaritur, edhe ata vetëm duke u bashkuar mund ta kundërshtonin, tronditnin dhe ndryshonin atë mentalitet të ndryshkur. Ndjenja të furishme uleshin dhe ngriheshin në zemrën e saj. Në gjakun e saj kish jetë, në jetën e saj kish shpresë, në shpresën e saj forcë e në forcën e saj dashuri. Ajo e donte shoqen e saj. U ngrit rrëmbimthi nga banka dhe tha me zë revoltues:

- Nëse Fatma përjashtohet nga shkolla, atëherë edhe unë do ta ndërpres mësimin në shenjë proteste.

Mendimin e saj e përkrahën të gjithë nxënësit.

Mësimi u ndërpre. Korridoret e shkollës buçitën nga hapat e zhurmshëm dhe zërat e lartë të tyre.

II

Edlira nuk kishte njohuri të thella për fenë islame, por zemra e saj e pastër dhe e çiltër e kuptonte se shoqes së saj të mirë e të dëlirë po i bëhej një padrejtësi e madhe. E gjithë ajo tymnajë e kishte bazën te mungesa e vizionit transcendent të elitave materialiste e pragmatiste që i nënshtroheshin çdo koniunkturë për hir të interesave të tyre egoiste. Tek qarqet intelektuale snobiste, që ishin formuar nën ombrellën ateiste, ekzistonte një lloj paranoje dhe qasje provokuese ndaj fesë islame. Për ta, vlerat fetare e morale ishin bërë 'hi e pluhur' në muzgun e kohës. Trampolina mediatike shqiptare e kishte zhvlerësuar rolin e faktorit fetar në përcaktimin e kahut dhe ecurisë drejt rrjedhave globale integruese. Kjo klasë mediatike, si një neobizant modern, përpiquej të futej dhe të depërtonte në dhomat, korridoret dhe anekset e ndërgjegjes së secilit dhe ta bunkerizonte mënyrën e të menduarit, ta betononte trurin dhe ta shterpëzonte intelektin. Sipas kësaj klase mediatike, feja islame bartte arkaizmin.

Sipas tyre vetëm Evropa duhej të ishte personifikim i përparimit dhe pikëpamjet e saj kulturore, ideologjike, politike dhe ekonomike, pra me një fjalë filozofia e saj e jetës duhej të konsiderohej e detyrueshme për të gjithë njerëzit e planetit. Çdo gjë tjetër cilësohej anakronike, prapanike, jocivilizuese. Dhe si për paradoks, lihej në heshtje fakti se vetë modeli perëndimor, që perceptohej si modeli më joshës i shoqërisë, dyshonte pafundësisht mbi veten e tij si një model në krizë, i paafte të luftonte kriminalitetin, drogën, prostitucionin, korrupsionin etj.

Edlira po mendonte të gjitha këto ndërkohë që kishte mbërritur te hyrja e pallatit të saj. U ngjit lart dhe hapi derën

me përtim. Babai i saj ishte mjek, ndërsa nëna arkitekte. Ata ishin tepër të angazhuar me punët e tyre dhe Edlirës iu duk se shtëpinë e kishte pushtuar një heshtje vrasëse. Ajo ishte vajzë e vetme dhe jeta e saj ishte e mbushur me ditë vetmie e mërzie. Sa shumë dëshironte të kishte motra dhe vëllezër. Orenditë dhe kolltukët luksozë që mbushnin shtëpinë e saj i sillnin ftohtësi. Sa shumë do të dëshironte të bisedonte tash me prindërit e saj. Por ata ishin gjithmonë të zënë, të zënë, të zënë. Ata punonin 10-12 orë në ditë dhe e kishin mendjen gjithnjë të mbingarkuar. Puna ishte si një ritual makabër që i gllabëronte çdo mëngjes dhe i lëshonte në orët e vona të pasdites të rraskapitur e të sflitur. Edhe kur ktheheshin në shtëpi hapnin televizorin dhe dëgjonin lajmet që ua bombardonin trurin pa pushim. Më pas hapnin kompjuterin, pa u prehur aspak nga presioni i punës. Lexonin gazeta, revista, katalogë të ndryshëm, oferta për produkte dhe shërbime, duke e pushtuar kështu tërë kohën dhe duke mos krijuar aspak ndonjë lidhje shpirtërore me Zotin. Sakrifikonin shëndetin dhe preokupoheshin për të fituar sa më shumë, duke u mbështetur vetëm mbi forcat e veta dhe duke mos kërkuar ndihmë e fuqi nga Zoti i Gjithëfuqishëm. Edlirës iu kujtuan fjalët e Teognisit: "Ata që sot kanë shumë, lakmojnë dyfishin. Pasuria kthehet te njeriu në çmenduri." Pasuria e krijuar për të realizuar nevojat e tyre të jetës ishte kthyer në qëllim në vetvete. Ajo ishte shndërruar për ta në një nevojë të pangopshme, të paanë, që nuk fashitej kurrë. Në themel të saj qëndronte një vullnet i shtrembër, një dëshirë për të pasur me shumë se të tjerët.

Edlirës iu duk vetja si një somnambule që endej në një kaos vlerash pa pasur ndonjë orientim. Ndjeu vogëlsinë e botës së



vet dhe parëndësinë e qëllimit të jetës së saj. Deri më tash e kish ushqyer kureshtjen e saj duke lexuar “letërsi të verdhë”, “bulevardeske” apo “limonadë”, por tani po ndiente një hapësirë boshe në shpirtin e saj. E kish kuptuar se vetëdija transcendentale për Zotin ishte një virtyt i bashkëlindur me të. Ndjenja fetare ishte më e qëndrueshmja, më e rrënjësura dhe e vetmja që mund t’i përmbushte nevojat thelbësore të saj. Iu kujtuan lisat: ata rriten e rriten, lëshojnë shtat sikur duan të arrijnë në qiell por nuk harrojnë të lëshojnë rrënjët thellë e më thellë për t’u lidhur sa më shumë me zemrën e dheut.

Edlirën po e hante vetmia. Ishte zhytur në ujërat e thella të deteve të zemrës. Mendimet filluan t’i kacavirreshin në pemën e mërziisë. Hodhi shikimin e përhumur diku përjashta, larg katër mureve që e rrethonin. Një valë nxehtësie ia pushtoi trupin. Nuk po e zhuriste dielli që kishte lart, por zjarri që kishte përbrenda. Dielli i shpresës po mundohej të mos jepte shpirt. Rrezet e tij po përpiqeshin ta shqyenin velin e fshehtësive. Filloi të zbulonte në nënshtresat e vetëdijes së saj të fjetur thellësinë e shpirtit njerëzor. Ndjeu nevojën që ta ngrohte zemrën e saj me dashuri hyjnore, që ta fshinte nga mendja idenë e një bote kaotike dhe në dukje absurde. Dëshironte të gjente strehë në një univers të harmonishëm, të qartë dhe të kuptueshëm dhe të arrinte përsosmërinë me të lartë, që do t’i përmbushte kërkesat e arsyes, të ideve estetike dhe metafizike. Mjaftonte veçse pak meditim dhe ajo mund të gjente me qindra argumente për ekzistencën, forcën dhe urtësinë e të Gjithëfuqishmit nëpërmjet ligjshmërisë, precizitetit dhe harmonisë që ekzistonin në formimin e tokës, hënës, diellit, planetëve, yjeve, qiejve, në formimin e ditës, natës, erërave, shiut, maleve, lumenjve, deteve, bimëve, gjallesave dhe njerëzve, duke filluar nga atomet e deri te fenomenet më të ndërlikuara: ligjet, raportet, format, lëvizjet.

Zbriti me nxitim shkallët e pallatit dhe u drejtua për te shtëpia e Fatmës. Pas pak u gjend para portës së saj. E shtyu derën lehtë. Para saj shtrihej oborri i shtruar me plloça të mëdha e të pastra. Më tej ishin mbjellë plot lule dhe pemë.

Menjëherë i doli përpara Fatma, nëna, motra dhe dy vëllezërit e saj më të vegjël, të cilët i uruan mirëseardhjen ngrohtësisht. Pak metra më tej ndodheshin edhe shtëpitë e xhaxhallarëve të Fatmës. Ajo ndjeu gëzimin e tyre të vërtetë, të sinqertë, të vetvetishëm që përhapej natyrshëm në sytë, flokët dhe lëvizjet e tyre. Zëri i fjalëve të tyre e tërhoqi me butësi në një botë të ngrohtë.

Hyri brenda. Çdo gjë ishte e pastër dhe e vendosur në vendin e vet.

Dy shoqet u veçuan në dhomën e Fatmës dhe filluan të bisedonin. Edlira i tregoi për ftohtësinë dhe vetminë që ndiente në shtëpinë e saj. Ndërsa Fatma i tregoi se nëna e saj ishte gjithmonë prezent në çastet kur ndahej gëzimi, hareja,

pikëllimi dhe ngushëllimi, dhe në ato momente ajo luante një rol të pazëvendësueshëm. Ngrohtësia që i dhuronte ajo ishte si një lumë që nuk shterej kurrë. Ajo i dukej asaj si një mirësi, si dora e Perëndisë që kishte zbritur nga qiejt në këtë botë. Fjalët që dilnin nga goja e nënës së saj i dukeshin si fjalë qiellore, fjalë jete, fjalë ëndrrë.

Edlira i shfaqti dëshirën Fatmës që t’i tregonte diçka më tepër për fenë e saj. Nga fytyra e Fatmës filluan të shpërndareshin disa rreze të ndritshme. Ajo filloi t’i tregonte Edlirës për dashurinë e saj të pakufishme për Krijuesin Madhështor dhe për lutjet e saj të përditshme fetare:

- Namazi për mua është një lidhje e fuqishme me Zotin, është një burim i pashtershëm frymëzimi për një jetë më të lartë, më fisnike. Është një ushqim shpirtëror që më përtërit. Dëshpërimi i njeriut në këtë jetë rrjedh nga fakti se ai është një qenie e nevojave të pakufishme. Sa më tepër që i plotëson ato, aq më tepër shfaqen nevojat të tjera. Ai s’është veçse një prodhues dhe konsumues të cilin e vë në lëvizje vetëm interesi i tij vetjak. Ai synon nevojat të pafundme por mundësitë e plotësimit të tyre janë të kufizuara. Kjo bën që atë ta kaplojë mërzia. Feja islame nuk e konsideron këtë botë si luginë të ofshamave dhe të psherëtimave. Ajo angazhohet për një harmonizim dhe paralelizëm mes vlerave materiale dhe shpirtërore, sepse pikërisht ekuilibri i prishur i tyre ka shkaktuar kaosin ekzistencial në civilizimin e sotëm.

Edlira e dëgjonte Fatmën me vëmendje. Fjalët e saj rrezatonin një energji që mbushnin hapësirat brenda saj. Tingëllima e zërit të saj ishte si tingëllima e një çelësi që hapte portën e shpirtit të saj. Feja islame iu shfaq me të gjithë butësinë, tolerancën dhe ngjyrimet e ngrohta që e karakterizojnë. Në besimin e Fatmës ajo nuk shihte kurrfarë paqartësie, misterioziteti apo dyshimi. Besimi i drejtë, që është shkalla më e kompletuar e dijes, i kish mundësuar asaj të kishte një diapazon, botëkuptim dhe horizont të gjerë. Sigurisht që formimin, intuitën, inteligjencën dhe sensibilitetin e saj ajo i shihte në frytet e punës së saj, si edhe në duatë që ajo kishte bërë për to. Janë disa ndjenja të përcjella në gjen, që duke rënë në truall të shëndetshëm rriten dhe lulëzojnë. Ato janë si farat e disa luleve të mrekullueshme që balta ua ka zënë frymën dhe i ka varrosur të gjalla. Ato fara lulesh janë të groposura thellë në baltë dhe presin të rimbijnë një ditë. Edlirës iu duk se gjeti një oazë që i lulëzoi ato sërish.

Njohja hyjnore e përgatiti për udhëtimin e gjatë drejt së vërtetës absolute duke e zhytur në shijen e pafundme të përjetimeve shpirtërore, ndjesive supreme dhe fërgëllimave shpirtërore.

Pas dy ditësh mësimi rifilloi sërish.

Vitin shkollor që pasoi, në bankën e dytë, në rreshtin e mesit, qëndronin dy vajza me mbulesë: Fatma dhe Edlira.



Luftimi i amoralitetit, analfabetizmit dhe ngritja e edukimit dhe arsimimit


Dr. Mirsad Aslani

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Dhe, Amos iu qasni kurverisë, se ajo është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar!” (El Isra, 32); “Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (Ez Zumer, 9).

Vizioni dhe përgjegjësia e Islamit janë luftimi i amoralitetit dhe ngritja e moralit, por gjithashtu edhe luftimi i analfabetizmit dhe ngritja e nivelit të lartë intelektual e arsimor. Nëse e marrim parasysh dhe e analizojmë rolin e të gjithë peygamberëve të Zotit, do të shohim se një nga detyrat kryesore dhe parësore e tyre ishte ftesa në besim, më pastaj lufta kundër mëkatit, jetës imorale dhe injorancës, duke e edukuar popullin për një jetë morale të pastër e të ndershme. Kështu ishte mësuar nga vetë Zoti edhe Pejgamberi i fundit i Zotit, Muhamedi a.s., dhe kështu ai i ka mësuar

edhe shokët e tij dhe pasuesit e besimit islam. Pejgamberi i fundit, Muhamedi a.s., mësoi nga mësimet e peygamberëve dhe ndodhitë historike, ishte i vetëdijshëm për dënimet, pasojat dhe vështirësitë që mund t'i ndodhnin shoqërisë për shkak të imoralitetit, andaj tha: “Kur imoraliteti përhapet në një komb dhe fillon të bëhet publikisht, ata do të preken nga murtaja dhe sëmundje që paraardhësit e tyre nuk i dinin.”¹ Pejgamberi a.s., e konsideronte edukimin moral si pikën më të rëndësishme të karakterit të njeriut. Edukimi moralisht i vetes, është suksesi më i madh në këtë botë, por dhe në botën tjetër: “Besimtarët më të mirë janë ata që kanë moralin më të mirë. Nuk ka asgjë që do të vihet në Mizan (peshore), dhe që do të peshojë më shumë sesa morali i mirë. Një person me moral të mirë do të ketë statusin e agjëruesit dhe namazfalësit të

“Kur imoraliteti përhapet në një komb dhe fillon të bëhet publikisht, ata do të preken nga murtaja dhe sëmundje që paraardhësit e tyre nuk i dinin.”



vazhdueshëm.”² Prandaj, besimtarët e vërtetë janë të vetëdijshëm për prioritetet e tyre në jetë dhe nuk dorëzohen kurrë, por punojnë gjithë jetën për të përmirësuar situatën dhe për t’iu afruar parimeve të larta islame, pra, parimeve universale njerëzore.

Në luftën kundër analfabetizmit dhe injorancës, Pejgamberi a.s., kishte një ide që është karakterizuar si një nga idetë më të mira botërore gjatë gjithë historisë. Pas fitores së betejës së Bedrit, ai ua bëri një propozim të burgosurve. Propozimin më së miri e përshkruan Ibën Sadi, i cili transmeton nga Amër esh Shabiu r.a., i cili ka thënë: “Pas betejës së Bedrit, ranë shtatëdhjetë robër. Secili prej tyre mori lirinë e tyre në bazë të pasurisë. Njerëzit në Meke dinin shkrim-lexim, ndërsa në Medine nuk dinin. Ai që nuk kishte pasuri për ta blerë lirinë, iu dha mundësia t’i mësonte dhjetë fëmijë nga Medina shkrim-lexim, dhe kur ta bënë atë, lirohet nga robëria (burgosja).”³ Ky propozim i Pejgamberit Muhamed a.s., ishte shkaku i vetëdijes dhe përgjegjësisë kolektive që kishte në luftimin ndaj analfabetizmit. Një shoqëri që është në kërkim të përparimit dhe zhvillimit, duhet të punojë për ndryshimin e vlerave reale dhe të reflektojë nga brenda, e të mos presë ndryshime nga jashtë, dhe të veprojë vetëm për të mirën e gjithë shoqërisë, në mënyrë që gjendja e saj të ndryshojë. Ajo ndryshohet me reforma dhe gradualitet, me përpjekje të përbashkëta dhe angazhime, e më pastaj, vjen edhe ndihma e Zotit: “... Allahu nuk e ndërton një popull derisa ata vetveten nuk e ndërrojnë.” (Er Rad, 11).

Në mënyrë që procesi edukativo-arsimor të realizohet si diçka që ka një “qëllim” fisnik, të gjithë pjesëmarrësit e tij duhet të kenë vetëdije të zhvilluar për përgjegjësinë e tyre. Që njohuritë të përcillen siç duhet përmes procesit të edukimit dhe arsimimit, në këtë rast, duhen ndërmarr parasysh të gjitha dallimet individuale, aftësitë, interesat dhe afinitetet e njerëzve. Çdo individ, i cili në procesin edukativo-arsimor ka përgjegjësinë dhe detyrën për të përcjellë dije dhe për të edukuar shoqërinë, ai së pari duhet të ketë ndërgjegje të edukuar dhe vetëdije intelektuale për rëndësinë e rolit të tij, më pastaj ta përmbushë atë nga një motivim i brendshëm, që nënkupton një synim altruist ndaj edukimit dhe arsimimit. Çdo person që vepron në mënyrë joadekuate në sistemin edukativo-arsimor, duhet të jetë i vetëdijshëm për pasojat

“Besimtarët më të mirë janë ata që kanë moralin më të mirë. Nuk ka asgjë që do të vihet në Mizan (peshore), dhe që do të peshojë më shumë sesa morali i mirë. Një person me moral të mirë do të ketë statusin e agjëruesit dhe namazfalësit të vazhdueshëm.”

afatgjata dhe ndoshta fatale që mund ta prekin shoqërinë në një të ardhme të afërt apo të largët.

E gjithë shoqëria duhet të punojë për të krijuar humanitet shoqëror, ku përfshihen vlerat si, ndershmëria, sinqeriteti dhe dashuria për njeri-tjetrin. Edukimi i çdo individi fillon në rrethin e ngushtë familjar. Në atë rreth, në radhë të parë përfshihet nëna dhe babai, më pas ai rreth zgjerohet te të afërmit, më pastaj, jashtë familjes përfshijmë kopshtet, shkollat dhe institucionet e tjera edukativo-arsimore.

Sistemi i zhvilluar arsimor dhe niveli i lartë i edukimit kolektiv janë çelësi i suksesit shoqëror, prosperitetit, ngritjes së nivelit të demokracisë dhe lulëzimit të lirisë njerëzore. Edukimi, morali dhe arsimimi janë themeli i marrëdhënieve njerëzore. Brenda një shoqërie, njerëzit mund të gjejnë një mënyrë jetese vetëm nëse funksionojnë brenda vlerave edukativo-morale. Sa më të thella të jenë rrënjët e edukimit në një shoqëri, aq më shumë ajo shoqëri zhvillohet dhe bëhet më e shëndetshme, sepse njerëzit ndikojnë me karaktere të edukuar ndaj njëri-tjetrit, andaj ky proces i ndikimit në bashkëjetesën dhe ndarjen e vlerave morale është i pashmangshëm, si për individin, po ashtu edhe për gjithë shoqërinë. Një nga vlerat kryesore edukative dhe morale në shoqëri është ndjenja e nderimit për njëri-tjetrin, më pas, kujdesi ndaj shoqërisë në situata të

caktuara dhe ekuilibri në ndërtimin e marrëdhënieve ndërshoqërore.

Edukimi dhe arsimi janë faktorë të domosdoshëm në procesin e njohjes së njëri-tjetrit, të kuptuarit të kulturave të ndryshme, si dhe për vendosjen e ndërveprimeve pozitive. Ato janë edhe rezultat i nevojës për organizimin e shoqërive multikulturore sipas parimeve të pluralizmit kulturor, siç janë: mirëkuptimi reciprok, toleranca, dialogu, interesat, besimet dhe zakonet e përbashkëta, dialogu social etj..

1 Ibën Maxhe, (1372-1373/1952-1953), Es Sunnen, për botuesin Muhamed Fuad Abdalbaki, Kajro, hadithi nr. 4019.

2 Tirmidhi, Es-Sunen, për botuesin Ahmed Muhamed Shaqir dhe të tjerët, Kajro, 1356/1385, hadithi nr. 1262/2003.

3 Dr. Mirsad Aslani, “Koncepti religjioz i edukimit dhe arsimimit në kohën moderne”, Novi Pazar, 2023, f. 66.

Ekspozimi ndaj drogave të ndaluara dhe ndikimi i tyre në lidhjet ndërnjerëzore

Arben Desku

Në të thjeshtë, drogat janë substanca të cilat kanë efekt psikologjik dhe fizik në trupin e njeriut. Disa nga to, në sasi precize, përdoren në mjekësi si ilaçe apo anestezion, e disa prej tyre janë të përjashtuara dhe konsiderohen joligjore për shkak të varësisë që krijojnë tek individit, varësi e cila dërgon drejt dëmtimit psikik e shpesh edhe drejt vdekjes së individit përdorues.

Drogat krijojnë varësi, e personi i varur nga drogat njihet me emrin narkoman. Varësia është psikologjike, pasi truri vazhdimisht dëshiron dozë më të lartë, ndërsa dëmi përveç psikologjik është krah për krah edhe fizik, me simptoma të njohura në mjekësi.

Ndër drogat më të njohura të ndaluara të kohës që shkaktojnë varësi dhe vdekje janë:

- Produktet e cannabis (marijuana, hashish dhe hashish oil);
- Halucinogjenët (drogat që shkaktojnë vizione joreale) LSD, mescaline, peyote dhe psilocybin;
- Ecstasy (ekstaza);
- Narkotikët (morphine, codeine, heroin, fentanyl, etj.);
- Stimuluesit (cocaine, amphetamine, adderall, ritalin, etj.).

Këto droga me pavetëdije dërgojnë drejt varësisë, varësia dërgon drejt krimeve, krimet

Aktualisht në Kosovë nuk ka vlerësime gjithëpërfshirëse për të dhëna përfaqësuese që flasin për numrin e saktë të përdoruesve të drogave.

Numrat që janë dhënë janë 30 mijë deri në 40 mijë përdorues të drogave sa vlerësohet që janë në Kosovë nga të gjitha komunitetet dhe grup moshat e ndryshme.





drejt burgut. Por, varësia nuk dërgon vetëm drejt burgut, por fatkeqësisht shpesh edhe drejt një jete denigruese dhe një vdekjeje të tmerrshme.

Globalizimi i shpejt detyrimisht e ka sjellë këtë problem madhor edhe te dyert tona, dhe për një periudhë shumë të shkurtër, ky problem dikur pothuajse joekzistent, u përhap shumë, aq sa shpejt mund të kërkojë një trajtim urgjent institucional. Shoqëria jonë, e cila para njëzet vjetësh ishte pothuajse e pa njoftuar me drogat, sot numëron mes 30 e 40 mijë përdorues të drogave.

“Aktualisht në Kosovë nuk ka vlerësime gjithëpërfshirëse për të dhëna përfaqësuese që flasin për numrin e saktë të përdoruesve të drogave. Organet që kanë prezantuar këto të dhëna nga institucionet e shëndetësisë që merren me këtë çështje na tregojnë se përdorimi i drogës është rritur. Numrat që janë dhënë janë 30 mijë deri në 40 mijë përdorues të drogave sa vlerësohet që janë në Kosovë nga të gjitha komunitetet dhe grup moshat e ndryshme, me dominim nga moshat e reja. Shumica e drogave përdoren në shtëpi” - tha ministri i Shëndetësisë, Latifi. (Shkrim i publikuar nga TRT Balkan, 27 qershor 2022).

“Rreth 40 mijë është numri i përdoruesve të drogës në Kosovë, nga ta 2850 janë të regjistruar në data-baza si përdorues të rregullt të drogës”, kjo u bë e ditur nga Safet Blakaj, drejtori i Qendrës Specialistike Psikiatrike “Labyrinth”, në një intervistë për median online Ekonomia Online, të publikuar më 17 gusht 2023.

Fatkeqësia qëndron në atë që përdoruesit e drogave janë grupmoshat mes 16 e 45 vjeç. Praktikisht pjesa që duhet të jetë më e shëndosha dhe më kontribuuesja për shoqërinë, po bëhet pikërisht ajo pjesa e sëmurë e shoqërisë. Arsyeja që dërgon te drogat për adoleshentët është kryesisht kureshtja dhe qasja e lehtë të dilerët e drogave, ndërsa për moshat më të pjekura, arsyet janë më shumë problemet emocionale, pasiguria, problemet ekonomike, e kryesisht mungesa e besimit. Pjesa dërrmuese e personave të intervistuar të cilët janë të varur nga drogat shprehin një pendim të thellë që i kanë hyrë një rruge të tillë.


Vendet më të ekspozuara ndaj drogave janë kryesisht klubet e natës, zonat më të mbyllura të qyteteve (për shitje), zonat e thella malore (për mbjellje), e fatkeqësisht rrethinat e shkollave fillore dhe të mesme.

Varësia ndaj drogave shkakton probleme të thella, shpesh të pariparueshme në raportet ndërnjerëzore. Raporti prind-fëmijë, në prizmin e një fëmije të varur nga droga është mjaft kompleks. Fëmijët të cilët përballen në rezistencë nga prindërit për t'u larguar nga droga apo për të kërkuar kurim, shpesh mund të tregohen të dhunshëm dhe të braktisin shtëpinë në të cilën jetojnë. Kështu ata përfundojnë të pastrehë, të ekspozuar më tej ndaj krimeve të tjera si vjedhja, prostitucioni dhe në raste jo të rralla edhe vrasjet.

Raporti prind-fëmijë, në prizmin e një prindi të varur nga droga është edhe më kompleks. Një prind i varur nga droga nuk angazhohet në plotësimin e nevojave elementare të fëmijëve, prandaj familja vuan nga mungesa e ushqimit dhe kushteve për jetë. Shpesh ata madje edhe shesin pronat e familjes për të krijuar kapital për blerjen e drogës. Në familje ku prindi është i varur nga droga, dhuna është detyrimisht e pranishme, qoftë ndaj fëmijëve, e kryesisht ndaj bashkëshorteve (grave).

Vendet më të ekspozuara ndaj drogave janë kryesisht klubet e natës, zonat më të mbyllura të qyteteve (për shitje), zonat e thella malore (për mbjellje), e fatkeqësisht rrethinat e shkollave fillore dhe të mesme. Shifrat fatkeqësisht tregojnë që as nga afër nuk është duke u bërë mjaftueshëm për parandalimin e shpërndarjes së drogave të ndaluara ligjërisht, dhe këtë e vërtetojnë numrat e cekur më lartë të përdoruesve të drogave. Sistemi i sigurisë në nivel vendi duhet të bëjë më shumë në parandalimin dhe kapjen e shpërndarësve, ndërsa gjykatat duhet të japin dënime serioze, dhe jo dënime me kusht, që janë sinqerisht qesharake.

Ndërkohë, ne si qytetarë të këtij vendi, fëmijët tanë, mbesim të ekspozuar thellësisht ndaj këtij rreziku. Në një diskutim spontan me një kolege rreth kësaj çështjeje, komenti i saj ishte: “Më duket Arben, veç me i dërgua fëmijët në xhami se do me mbet vendi i vetëm i sigurt nga droga!” Por, jo! Xhamia nuk duhet të jetë i vetmi vend i sigurt nga droga. Çdo vend në qytet, çdo familje, çdo fëmijë duhet të jetë i sigurt nga droga.



Imuniteti dhe vaksinimi

Dr. Mysheref Sylbije

Duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s.: “Për çdo sëmundje që ka zbritur Allahu, Ai ka zbritur edhe ilaçin e saj”, dhe parimin se parandalimi është më i mirë se shërimi, po e ndaj këtë artikull me ju, me shpresën që të jetë i dobishëm.

Sistemi imun është një prej sistemeve më të rëndësishme të organizmit. Ky sistem ofron mbrojtje nga çdo mikroorganizëm që mund ta dëmtojë njeriun.

Funksionimi normal i sistemit imun është mbrojtja kundër mikrobeve infektuese. Sidoqoftë edhe substancat e huaja jo infektuese dhe produktet e qelizave dhe indeve të dëmtuara ose qelizave malinje, mund të nxisin reagim imun. Në disa raste, edhe qelizat e vetë organizmit krijojnë reagim imun, e që njihet si përgjigje autoimune.

Mbrojtja kundër mikrobeve mundësohet nga përgjigjet, të cilat quhen adaptive ose të lindura. Imuniteti i lindur ka rëndësi për mbrojtje kundër mikrobeve në disa orë ose ditë pas infeksionit, para se të zhvillohet përgjigja immune adaptive.

Për shkak se kjo formë e imunitetit zhvillohet në përgjigje ndaj infeksioneve, ajo quhet imunitet adaptiv. Sistemi imun adaptiv njihet dhe vepron për një numër të madh të mikroorganizmave, që mund të jenë mikrobike dhe jomikrobike, e që quhen antigjene.

Vaksinat janë substanca biologjike aktive, e të cilat japin imunitet ndaj infeksioneve të ndryshme.

Gjatë historisë, siguria dhe efektiviteti i vaksinave janë studiuar dhe verifikuar.

Vaksinat janë substanca biologjike aktive, e të cilat japin imunitet ndaj infeksioneve të ndryshme.



Sëmundja	Mosha në muaj				Mosha në vite			
	Në lindje	2 muaj	3 muaj	4 muaj	12 muaj	6-7 vjet	12-13 vjet	17-18 vjet
Tuberkuloz	BCG							
Hepatit viral B	Hep B							
Difteri, Tetanos, Pertusis, Hemophilus Influenza B,		DTP1-HepB1-Hib1	DTP2-HepB2-Hib2	DTP3-HepB3-Hib3				
Poliomieliti		IPV1	IPV2	IPV3				
Difteji, Tetanos, Pertusis					DTPr			
Fruth, Rubellë, Parotit					MMR	MMRr		
Poliomielit					bOPVr	bOPVr	bOPVr	
Difteri, Tetanos						DT	Td	Td

Tabela 1. Kalendar i rregullt i vaksinimit në Kosovë

Vaksinat mund të jenë terapeutike (trajtuere) dhe profilaktike (parandaluese). Procesi i marrjes së vaksinave quhet vaksinim, dhe është metoda më efektive për mbrojtje kundër sëmundjeve.

Sëmundjet që janë zhdukur përmes vaksinimit janë: Variola, Polio, Fruthi, Tetanosi. Sistemi ynë imun e njeh vaksinën si përbërës të huaj, reagon kundrejt saj dhe e mban mend atë.

Për të qenë sa më efektive, vaksinat, përcaktohen përmes kalendarit të vaksinimit, në intervale të caktuara kohore. Fëmijët rekomandohet të marrin vakcina menjëherë kur sistemi i tyre imun është mjaft i zhvilluar për t'iu përgjigjur vaksinave të caktuara, ndërsa rivaksinimi rekomandohet të bëhet për ta arritur imunitetin e plotë.

Aktualisht në Kosovë, kalendar i vaksinimit përfshin dhjetë sëmundje të parandaluara me vakcina. Ky plan i vaksinimit përfshin periudhën kohore prej vitit 2022-2025. Plani ka për qëllim që të arrijë vaksinimin e fëmijëve në shkallën prej 95% - 97%. Plani i ri i vaksinimit i periudhës 2022-2025, ka për qëllim vaksinimin kundër HPV, Pneumokokut, Rotavirus. Vaksinimi kundër këtyre antigjeneve ka rëndësi të madhe, sepse na ndihmon të mbrohemi nga sëmundjet si, kanceri i qafës së mitrës, infektimi me rotavirus, pneumoni, meningjit, sepse etj.. Gjithashtu është me rëndësi vaksinimi kundër gripit sezonal dhe vaksinimi me vakcina të tjera sipas indikacioneve

epidemiologjike dhe atyre me indikacion udhëtimesh në vende endemike me sëmundje të caktuara.

Zinxhiri i ftohtë mundëson mbrojtjen e vaksinave në institucionet shëndetësore në Kosovë. Gjithashtu duhet të kemi kujdes me pacientët të cilët kanë mundësi për alergji, ose alergji të dëshmuar në substanca të caktuara që marrin pjesë në përbërjen e vaksinës. Vaksinimi mund të bëhet përmes rrugës orale, intranazale, subkutane, intramuskulare. Reaksionet alergjike janë të mundshme, prandaj mjekët kanë përgatitje adekuate për reagim në rast të shfaqjes së alergjisë.

Efekti i dëshmuar i vaksinave në zhdukjen e sëmundjeve të ndryshme gjatë historisë dhe mbrojtja kundër sëmundjeve të tjera aktuale, si p.sh. COVID-19, na bën të qartë rëndësinë e vaksinimit. Prandaj është me rëndësi vetëdijësimi i familjeve për vaksinimin e fëmijëve me të gjitha vaksinat që mbrojnë nga sëmundjet, pra me vaksinat prevenuese.

Referencat:

1. Imam Zejnudin Ahmed ibën Abdul-Latif Zebidi, Muhtesar Sahih El Buhari. (Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam), 598.
2. Abbas, Abul K., Andrew H. Lichtman, and Jordan S. Pober. Cellular and Molecular Immunology. (Philadelphia: Saunders, 1994).
3. "Vaccine." Wikipedia, October 14, 2023. <https://en.wikipedia.org/wiki/Vaccine>.
4. Plani I Veprimt Për Parandalimin e Infeksioneve Spitalore 2020-2021. Accessed October 20, 2023, <https://msh.rksgov.net/Documents/DownloadDocument?filename=plani%20i%20veprimt%20p%20c3%8br%20parandalimin%20e%20infeksioneve%20spitalore%202020-202154592138.5005.pdf>.

111-vjetori i lindjes së hafëz Abdullah ef. Sagdanit

Faik Miftari

Kisha ndërmend prej kohësh që të shkruaj një punim paksa më të gjatë për jetën dhe veprimtarinë e hafëz Abdullah ef. Sagdanit. Edhe pse më parë kam shkruar biografinë e tij me rastin e botimit të monografisë “Hafizët e Prizrenit me rrethinë (1912-2012)”, si njërin prej hafëzëve të shumtë të përmbledhur në këtë monografi të hafëzëve gjatë periudhës kohore 100-vjeçare (1912-2012).

Tani me rastin e 111-vjetorit të lindjes së hafëz Abdullah ef. Sagdani, vendosa ta përkujtojë këtë personalitet të shquar fetar e kombëtar në kuptim të plotë të fjalës, të njohur jo vetëm në qytetin e Prizrenit, por edhe gjithandej Kosovës, Bosnjës e Shqipërisë.

Hafëz Abdullah ef. Sagdani lindi në vitin 1912 në fshatin Reqan, 9km larg qytetit të Prizrenit. Rrjedh nga një familje e njohur me traditë fetare, pasi që edhe baba i tij, mulla Ramadani (i quajtur mulla Rama) ka qenë imam në fshatin e tij të lindjes. Mësimet e para të fesë, apo mejtepin, e kreu te babai i tij, mulla Rama. Më tutje, vazhdoi mësimin e hifzit (mësimin përmendsh) të Kuranit, të cilin e kreu me sukses në moshën -12vjeçare, në vitin 1924, te mentori i tij, muhafiz hafëz Qemajl ef. Kajserliu.

Pas kryerjes së hifzit, vazhdoi mësimet e mëtutjeshme të fesë, me ç’rast regjistroi medresenë e mirënjohur të kohës, “Gazi Mehmed Pashës”, me një traditë 400-vjeçare të ekzistimit të saj, të cilën medrese, pas vijimit të plotë të mësimave tetëvjeçare, e

kreu me sukses të plotë dhe u pajis me ixhazetname (diplomë) të medresesë.

Në fillim, për shtatë vjet, ka shërbyer si imam në fshatin Korishë, pastaj është caktuar të shërbejë si imam në xhaminë e Sejdi Beut, në lagjen e Kurilës, me preferencë të imamatit të atëhershëm të xhamisë, hafëz Maksud efendiut, i cili u shpërngul në Turqi në vitin 1957 për shkak të presionit të ushtruar ndaj tij nga pushteti i atëhershëm komunist. Në xhaminë e Sejdi Beut në lagjen e Kurilës, hafëz Abdullah ef. Sagdani, shërbeu gjer në përfundim të jetës së tij. Aty, gjatë tërë kohës sa ka shërbyer, i ka falur rregullisht tri kohët e namazeve (sabahun, akshamin dhe jacinë), gjithashtu namazin e xhumasë, teravive dhe bajrameve.

Hafëz Abdullah ef. Sagdani çmohej si lexues i rrallë i Kuranit, ka pasur një zë të bukur, bariton të veçantë të këndimit të



Hafëz Abdullah ef. Sagdani lindi në vitin 1912 në fshatin Reqan, 9km larg qytetit të Prizrenit. Rrjedh nga një familje e njohur me traditë fetare, pasi që edhe baba i tij, mulla Ramadani (i quajtur mulla Rama) ka qenë imam në fshatin e tij të lindjes.

Kuranit. Gjatë kohës së ish-Jugosllavisë së kralit, në periudhën sa ishte medresist i medresesë së “Gazi Mehmed Pashës”, meqë ishte hafëz, gjatë muajit të bekuar Ramazan, shkonte në Sarajevë, në qytetin Visokë të Bosnjës, për të lexuar mukabele (leximin e plotë të Kuranit gjatë 30 ditëve të Ramazanit), ndërsa në vitin 1943, ka qenë në Durrës për të kënduar mukabele (lexim Kurani) gjatë Ramazanit.

Gjatë sistemit komunist, gjegjësisht të Jugosllavisë së Titosë, rregullisht, gjatë muajit të bekuar Ramazan, ka kënduar mukabele së bashku me hafëz Maksud ef. Spahiun në xhaminë e Gazi Mehmed Pashës (Bajraklisë) në Prizren. Ishte prej hafëzëve të rrallë, që namazin e sabahut, në xhaminë e Sejdi Beut në lagjen e Kurilës, ku shërbeu gjatë gjithë jetës së tij, e ka falur me hatme.

Përveç që ushtroi detyrën e imanit, rregullisht ka mbajtur mësim-besimin, jo vetëm në xhami, por kohë pas kohe edhe në shtëpi. Me dhjetëra talebe (nxënës) kanë mësuar leximin e Kuranit, ndërsa një rast i rrallë ishte se në mesin e nxënësve të cilët mësonin leximin e Kuranit ishte edhe hafëz

*Hafëz Abdullah ef. Sagdani
çmohej si lexues i
rrallë i Kuranit,
ka pasur një zë të
bukur, bariton të
veçantë të
këndimit të
Kuranit.*

Qazim beg Postagjiu, i cili e mësoi Kuranit përmendësh pas pensionimit të tij në Postë, ku ka punuar gjatë gjithë jetës së tij, që është rast i rrallë që do të duhej të shënohej në Librin e Ginit.

Përveç këndimit të bukur të Kuranit, hafëz Abdullah ef. Sagdani, ishte i njohur edhe për leximin e bukur të mevludit në të tria gjuhët që fliten në Prizren, shqip, turqisht dhe gjuhën boshnjake. Rrallë kanë qenë dasmat, synetit, të shtatat, të katërdhjetat, e të mos ishte ftuar edhe hafëz Abdullahu, jo vetëm nga mesi i qytetarëve të Prizrenit, por edhe nga mesi i fshatarëve të fshatrave të Prizrenit, për të kënduar mevludin me rastin e ceremonive të lartcekura.

Hafëz Abdullah ef. Sagdani ishte njeri i urtë, i dashur, i shoqërueshëm, i afërt, ka qenë i njohur në mesin e gjerë, jo vetëm të qytetarëve të Prizrenit dhe të fshatrave përreth tij, por edhe më gjerë, gjithandej Kosovës. Sa herë, kudo që takonte dikë, ndalej bisedonte dhe interesohej për hallet e çdo njeriut, kushdo qoftë ai.



Nga e majta: hfz. Abdullah ef. Sagdani, hfz. Ramiz ef. Varolli dhe hfz. Beqir ef. Kajserliu



Grup hafëzësh dhe hoxhallarësh në mesin e tyre është edhe hafëz Abdullah ef. Sagdani (ulur i treti në anën e djathtë)

Njihesha për së afërmi me hafëz Abdullahun, pasi që ishin edhe në raporte familjare dhe miqësie, sepse motra e hafëz Abdullahut ishte e martuar për axhën tim, ashtu që kam pasur rast shpesh të takohem dhe të bisedojë. Nuk ka pas Bajram apo ndonjë rast gëzimi, syneti apo dasmë që të mos e takoja.

Përveç aktivitetit dhe shërbimit fetar, hafëz Abdullah ef. Sagdani, ka qenë edhe atdhetar i shquar. Gjatë kohës së Shqipërisë (1941-1944), ka shërbyer si imam ushtarak në divizionin “Skenderbej” të themeluar në vitin 1943. Pas vitit 1944, me ardhjen e pushtetit komunist, ka qenë i anatemuar nga komunistët, një kohë ka qenë i strehuar dhe i fshehur në fshatin Kabash të Prizrenit. Pas kësaj, pas amnistisë së shpallur nga ish-lideri komunist i ish-Jugosllavisë, mareschal Titoja, hafëzi iu rikthye jetës dhe shërbimit fetar. Gjatë gjithë jetës së tij, ka qenë tepër i kujdesshëm dhe i tërhequr gjatë pushtetit komunist dhe se ka qenë i përqendruar në shërbimin dhe aktivitetet fetare, për shkak të kaluarës së tij të ndritshme atdhetare gjatë kohës së Shqipërisë në Kosovë (1941-1944).

“Gjatë gjithë jetës sime, vetëm tri vjet kam qenë i lirë dhe kam frymuar lirisht, gjatë kohës sa ishte Shqipëria në Kosovë, vitet 1941-1944.”

Fare nuk ka folur për të kaluarën e tij, porse në një rast, gjatë një të pame, e shfrytëzova rastin dhe e pyeta hafëz Abdullahun e nderuar se “*gjatë gjithë jetës së tij, kur ka qenë i lirë në kuptim të plot të lirisë?*”. Ai mu përgjigj me këto fjalë: “*Gjatë gjithë jetës sime, vetëm tri vjet kam qenë i lirë dhe kam frymuar lirisht, gjatë kohës sa ishte Shqipëria në Kosovë, vitet 1941-1944.*”

Më 14.12.1991, pasi fali namazin e ikindisë në xhaminë e Sejdi Beut, pas shërbimit si imam për plot 58 vjet me radhë, hafëz Abdullahu i nderuar dhe i respektuar, ia dorëzoi shpirtin e tij Allahut Fuqiplotë. U varros ditën e nesërme në varrezat Kuriçeshme të Prizrenit me nderimet më të larta qytetare dhe fetare, me pjesëmarrjen e xhematlinjëve dhe qytetarëve të shumtë të Prizrenit dhe rrethinës.

Në përfundim të këtij shkrimi përkujtues me rastin e 111-vjetorit të lindjes së tij, bëjë dua (lutje) me dëshirë që Allahu i Madhëruar ta mëshirojë me mëshirën e tij të pakufishme dhe të shpërblejë hafëz Abdullahun tonë të dashur me Xhenetin Firdeus, inshallah!

Si e shpëtoi Islami ekzistencën e çifutëve në Evropën Perëndimore

RRËNJËT E ÇIFUTËVE NË EVROPË

Por ama, sapo kristianizmi hyri në çdo cep të Evropës, filloi armiqësia mes dy besimeve, e cila erdhi duke u ashpërsuar sidomos pasi perandori Konstantin vendosi të përqaftonte fenë kristiane në shekullin e katërt.

Në vitin 70, para se kristianizmi të hynte në Evropë, çifutët kishin kolonizuar rajone të caktuara. Por, pas shkatërrimit të tempullit të tyre në Jerusalem, me mijëra çifutë lanë vendin apo u shitën në tregjet e skllevërve në Evropë. Tregtarët e pasur, çifutët, i blenë duke i vendosur nëpër getot e tyre. Gradualisht u krijuan diasporat çifute në vende të caktuara anembanë botës. Lagjet e krijuara prej çifutëve u rrethuan me mure të larta, të cilat mbyllnin dyert e tyre porsa binte muzgu. Çifutët në atë kohë merreshin me tregti, posedim tokash, si dhe disa zanate të caktuara. Diaspora më e madhe në Evropë, para se kristianizmi të hynte zyrtarisht në kontinent, ishte në Spanjë.

Por ama, sapo kristianizmi hyri në çdo cep të Evropës, filloi armiqësia mes dy besimeve, e cila erdhi duke u ashpërsuar sidomos pasi perandori Konstantin vendosi të përqaftonte fenë kristiane në shekullin e katërt. Në këtë kohë, kristianët u ndien të kërcënuar prej çifutëve jo vetëm për shkak të besimit të tyre, por edhe prej zotërimit të monopolit të pasurive, grumbullimit të saj, përdorimit të ryshfetit krahas fajdeve. Pikërisht për këtë, i trajtuan çifutët si një bashkësi mbi të cilën duhej të vendoseshin taksa, duke bërë dallim në vendosjen e detyrimeve mes tyre dhe bashkësive të tjera (nuk u trajtuan njësoj si bashkësitë e tjera). Sundimtarët kristianë të Toledos, në vitin 589, lëshuan vendime të shumta kundër çifutëve, si:

1. Ndaloheshin të punësoheshin pranë kristianëve;
2. Ndaloheshin femrat kristiane të martoheshin me çifutë;
3. Nuk i lejohej çifutit të kishte rob kristian nën zotërimin e tij;
4. U vendos ndalimi për praktikatat e tyre fetare;
5. U ndalua synetimi i fëmijëve të tyre, e po ashtu edhe i robërve të tyre;
6. Duhej të varnin shenja dalluese në vende të dukshme për t'u ditur se cili komunitet i përkisnin.

Madje ndalimi i praktikave fetare jokristiane përfshinte dhe bashkësitë e tjera ku u lëshuan vendime të ashpra karshi jokristianëve, si: vritej, digjej apo gurëzohej çdokush që praktikonte rite të ndryshme prej atyre kristiane. Këto masa drastike bënë që një pjesë e çifutëve të përqaftonin kristianizmin. Filluan të zbatonin ritet kristiane, të hanin mish derri dhe të tjera rite për të vërtetuar kristianizmin e tyre përballë sunduesve kristianë. Nuk u mjaftuan vetëm me këto masa, por u vendos, pa përjashtime, që të gjithë çifutët e kristianizuar ose jo, t'u dorëzonin pasurinë e tyre kristianëve duke i kthyer në robër të tyre.

Madje Këshilli i Lartë Kishtar në Toledo, në vitin 633, shtoi kushte të tjera ndaj çifutëve duke parë që rezultatet nuk kishin arritur aty ku donin, si:



Duhej që sapo fëmija të mbushte 7 vjeç të shkonte në kishë dhe të merrte edukatë dhe arsim kishtar;

Çdo çifut i kristianizuar në rast se rikthehej në fenë e tij çifute, do i dërgohej si rob një

kristiani.

Të gjitha këto vendime sollën robërimin e çifutëve prej kristianëve. Situata vinte duke u rënduar, kur edhe pasi vendosën të hynin sipërfaqësisht në kristianizëm dhe fshehurazi nëpër shtëpitë e tyre praktikonin fenë e tyre. Kristianët e kuptuan dhe vendosën t'ju merrej e gjithë pasuria pa përjashtim, si atyre që i zbatonin praktikat kishtarë, edhe atyre që nuk i zbatonin, madje i kthyen në robër të kristianëve. Kjo situatë vazhdoi deri me hyrjen e Islamit.

PERIUDHA E ARTË PËR ÇIFUTËT NË SPANJËN ISLAME

Si rezultat i keqtrajtimit sistematik që pësuan prej kristianëve, çifutët e pritën me gëzim hyrjen e Islamit në Gadishullin Iberik në vitin 711, ku ushtrisë së myslimanëve u printe Tarik ibën el Uelidi.

Madje kjo solli gëzim edhe te çifutët në vendet e tjera të Evropës, duke sjellë migrim masiv të çifutëve drejt Andaluzisë, duke u përqendruar kështu në Andaluzi, Kortoba, Sevilje, Toledo etj.. Çifutët iu ofruan ndihmë konkrete myslimanëve. Në fillimet e çlirimeve, ata vullnetarisht ia ofruan komandantit të ushtrisë islame shërbimet e tyre. Ata kryenin vullnetarisht mbrojtjen e mureve të qyteteve që çliroheshin. Porsa u stabilizua situata dhe myslimanët filluan të qeverisnin, çifutëve iu kthyen të gjitha të drejtat e tyre. Për shekuj do të shikohet modeli i marrëdhënieve të shkëlqyera ndërmjet drejtuesve dhe popujve të cilët ishin nën zotërimin e tyre.

Qysh në shekullin e parë të sundimit islam, u gjallërua ekonomia e çifutëve. Kjo solli lindjen dhe shkëlqimin e letërsisë dhe mendimit filozofik hebre. U forcuan ekonomikisht aq sa kishin mundësi të ndihmonin

financiarisht çifutët e varfër jashtë Andaluzisë. Gjatë sundimit islam, ndërtuan qendrat e tyre kulturore sidomos në Kordobë. Në këto qendra mësonin shkencat arabe krahas atyre hebreje.

Bashkësia çifute, gjatë sundimit islam, nxori figura të rëndësishme, të cilat punuan si për interesat e tyre, ashtu dhe për interesat e shtetit islam. Më i njohuri mes çifutëve ka qenë Hasdai ibën Shaprut, i cili mbante postin e ambasadorit dhe të vezirit të thesarit të shtetit, ndërsa mbreti Abdurrahmani i tretë, e emëroi atë mjek personal të tij, si dhe këshillohej me të për çështje të politikës së shtetit dhe për tregtinë. Mblodhi pasuri të shumtë, e cila i mundësoi të krijonte bibliotekë të pasur në libra të gjuhës hebreje, themeloi shkollën për studimet jehudije, u caktua prijës fetar mbi çifutët me vendim të emirit - mbretit mysliman. Poetët dhe letrarët çifutë do e glorifikonin përmes penës së tyre Hasdai ibën Shaprut. Pothuajse në të gjitha principatat e myslimanëve në Spanjë, çifutët shkëlqyen në fusha të ndryshme duke u ngarkuar me detyra të rëndësishme pranë udhëheqësve. Të tjera figura që kanë dalë nga gjiri i diasporës çifute në Spanjën islame janë edhe Samuel ben Nagrella, i cili ishte vezir pranë mbretit të Granadës, Ebu el Fadl ibën Hasdai me detyrën vezir në Zaragozë, Abraham ben Azra ka jetuar dhe punuar në Toledo, Shlomo ben Gabirol ka ushtruar aktivitetin e tij në Malaga. Këto janë figura të rëndësishme që ka nxjerrë diaspora çifute gjatë sundimit islam. Të gjitha këto figura patën fatin të shkëlqenit dhe të zinin vend të rëndësishëm gjatë sundimit islam disa shekullor në Spanjë. Ata regjistruan gjithçka dhe ishin pikërisht këta të cilët transmetuan jetën islame te sundimi spanjoll, i cili do vinte më pas, dhe duke qenë se ishin më afër me kristianët për shkak të besimit dhe normave të jetës, arritën të siguronin besimin e mbretërve dhe fisnikëve duke qëndruar në të njëjtat pozita, funksione dhe detyra të cilat i kishin pasur në shtetin islam, si doktor, financier, shkencëtar, nëpunës, diplomat etj..

Periodha e sundimit islam në Spanjë, konsiderohet prej çifutëve si “periudha e artë”, meqë gjatë kësaj periudhe lulëzoi gjuha dhe letërsia hebreje, u shkruan vepra të cilat

konsiderohen edhe sot e kësaj dite si letërsia mëmë për gjuhën dhe letërsinë hebreje. Ky lulëzim mes çifutëve u arrit si një fryt prej fryteve të lirisë politike, financiare dhe letrare, të cilën e gëzuan nën sundimin e pushtetit islam. Gjatë gjithë kësaj periudhe nuk u detyruan të përqafojnë Islamin, por u është ofruar të jetonin me dinjitet dhe të lirë. Gjatë kësaj periudhe, ata fituan pasuri të jashtëzakonshme, si prej kthimit të pronave të tyre të cilat ua kishin konfiskuar kristianët, por edhe prej punës së tyre duke arritur të zinin postet më të larta në kastën sunduese. Të gjithë popujt që jetonin nën sundimin islam, punonin krah për krah. Kështu ka ardhur përmes dokumenteve se në Toledo, arabët dhe çifutët, punonin krah për krah me spanjollët, gjermanët, ballkanasit, francezët dhe anglezët.

Në shekullin XII, çifutët do të arrijnë të kryenin ringjallje të tërësishme në fushën e përkthimeve dhe filozofisë, duke përhapur veprat e Aristotelit nëpërmjet përkthimit të filozofëve arabë, Ibën Sina dhe Ibën Ruzhdi, veprat e të cilëve kanë shërbyer si bazë për mësimin e filozofisë në atë kohë, dhe kishin të gërshetuar filozofinë me mjekësinë. Më i njohuri prej çifutëve në fushën e përkthimeve ishte mjeku, filozofi dhe shkencëtari më i shquar i asaj kohe, Musa ibën Mejmoni, i cili kreu veprimtarinë e tij në Andaluzi dhe Kajro.

ÇIFUTËT PAS RËNIES SË PUSHTETIT TË MYSLIMANËVE NË SPANJË

Duke parë se principatat islame po binin njëra pas tjetrës, çifutët nxituan të ndihmonin sundimtarët e rinj katolik, duke iu ofruar ndihmën e tyre për të larguar sa më shpejt sundimin islam, duke e paraqitur këtë luftë mes kristianëve dhe myslimanëve si luftë të shenjtë. E gjitha kjo bëhej për të ruajtur pozitat dhe privilegjet e tyre të cilat i kishin fituar gjatë sundimit islam.

Pasi pushteti islam filloi të binte gradualisht, principatë pas principate, kemi krijimin e principatave kristiane para se ato të arrijnë të mbledheshin të gjitha në një mbretëri të vetme pas disa shekujve. Kështu do kemi ndarjen e pushtetit kristian prej kishës në trajtimin ndaj çifutëve. Ndërsa kisha donte të vazhdonte trajtimin e tyre njësoj siç ishte dikur para hyrjes së Islamit, mbretërit kristian donin të përfitonin sa më shumë prej aftësive të tyre diplomatike, shkencore e financiare. Duke qenë se çifutët janë më të afërt me kristianët, si në mënyrën e organizimit të jetës së tyre, por edhe në çështjet e besimit, princërit do u jepnin të njëjtat privilegje që kishin gjatë sundimit islam me qëllim që të lulëzonin dhe përparonin sa më shpejt principatat e tyre. Do shikojmë që do të punësohen

Si rezultat i keqtrajtimit sistematik që pësuan prej kristianëve, çifutët e pritën me gëzim hyrjen e Islamit në Gadishullin Iberik në vitin 711, ku ushtrisë së myslimanëve u printe Tarik ibën el Uelidi.

në të njëjtat poste që kishin pasur para rënies së Islamit: doktorë, shkencëtarë, financierë, nëpunës, diplomatë dhe përfaqësues të parisë e deri dhe përfaqësues të mbretërve. Për këtë arsye, do shikojmë që sundimtarët kristianë, pasi merrnin një principatë islame, si në Zaragozë në vitin 1118, myslimanët të cilët kishin mbetur pas rënies së principatës islame, i linin të jetonin jashtë mureve rrethuese të qyteteve, ndërsa çifutët jetonin brenda qyteteve duke u konsideruar si të besueshëm, si dhe çifutët vunë në dispozicion të kristianëve të gjithë dijen e tyre. Përkthimet e veprave të dijetarëve dhe shkencëtarëve myslimanë të trashëgimisë arabe dhe islame prej çifutëve vijuan edhe pasi Andaluzia ra në dorë të kristianëve. Në Barcelonë, çifutët do të zotëronin një të tretën e tokave, gjë që solli pakënaqësi në radhët e kristianëve, si dhe kishin më shumë të drejta se vendasit.

Por ama, në momentin që pushteti i myslimanëve ra tërësisht dhe pushteti katolik u forcua, do të shikojmë që do të përsëritet i njëjti skenar i shtypjes së të drejtave të çifutëve prej kristianëve.

Pushteti katolik nuk vendosej ballë për ballë me bujkrobërit e varfër spanjoll për mbledhjen e taksave, por ngarkonte çifutët me këtë detyrë, gjë e cila solli urrejtjen mbarëpopullore kundër çifutëve, të cilët ata i shikonin si rrëmbyes të pasurive të tyre, pavarësisht se ishte urdhër i mbretërve dhe princave katolik. Prej shekullit XIII e deri në shekullin XV, gjatë sundimit të mbretit Alfonsi i 10 dhe sundimit të mbretit Pedro i 3, çifutët do të shkëlqenin në fushën e astronomisë. Do të përkthenin shkencën e gjeografisë arabe bashkë me zbulimet e tyre për llogaritë të portugezëve dhe kjo prej vitit 1375 deri në vitin 1385. Vizatuan hartat me përpikëri me të gjitha shënimet. Çifutët, si dhe të huajt të cilët kishin jetuar brenda shtetit islam, përkthenin dhe shpjegonin gjithçka prej shkencave islame-arabe në të gjitha fushat: filozofi, astronomi, matematikë e mjekësi.

Si përfundim, shekujt që nga hyrja e Islamit në Spanjë e deri në rënien e tij të plotë në shekullin XVI, do të shikojmë lulëzimin e Spanjës së ndikuar prej të tri bashkësive që jetuan dhe punuan së bashku, herë si miq, e herë të tjera si kundërshtar apo armiq: myslimanë, kristian dhe çifutë dhe e gjitha kjo nën hijen e pushtetit islam.

Hoda Dervish "Sekretet e jehudëve kriptokristian në Andaluzi", botimi i parë, 2008

Përktheu: Klodiana Xhaferraj



ISLAMI NË NORVEGJI

Anne Sofie Roald*

Në epokën e vikingëve,¹ (shek. VIII), tregtarët arabë vizituan zonën që sot njihet me emrin shtetet e Skandinavisë, mirëpo është e paqartë se çfarë ndikimi ka pasur kjo kulturë mbi atë popull. Shteti i Suedisë ka pasur marrëdhënie të mira me Perandorinë Osmane që në shekullin XVIII, e cila ndër të tjera rezultoi me njohjen e një lënde shkencore të re të teologjisë në “Universitetin e Uppsalës” në vitin 1754. Mbajtësi i këtij posti shkencor duhej të kryente kërkime në “mendimin e lirë” dhe së fundmi ajo lëndë u quajt “Historia fetare me psikologjinë e fesë”.

Mbreti suedez, Charles XII (vdiq më 1718), kërkoi strehim te sulltani osman pas betejës së Poltavës në vitin 1709. Suedezët dhe turqit bënë një front të përbashkët kundër superfuqisë në rritje të Rusisë, dhe Karli qëndroi në Perandorinë Osmane nën mbrojtjen e sulltanit deri në vitin 1714. Takimi me një fe tjetër çoi në një interesim për parimet dhe rregullat e asaj feje, dhe disa teza për myslimanët u krijuan pas shekullit XVIII. Pikëpamjet për Islamin dhe myslimanët në Suedi, fillimisht ishin pozitive, ndërsa orientalizmi anglez dhe francez, fituan një bazë në fund të shekullit XVIII, nga ku këndvështrimi i suedezëve për Islamin dhe myslimanët filloi të ndryshoi.

Norvegjia nuk ka historinë përkatëse në lidhje me Islamin.² Në vitet e gjashtëdhjeta, janë myslimanët e parë të cilët erdhën në Norvegji, atëherë kur shumica e norvegjezëve nuk kishin shumë njohuri për Islamin dhe myslimanët. Para se gjithash, në fillim, nuk konsiderohej problem i madh që emigrantët myslimanë vinin për të punuar në Norvegji. Si komuniteti shumicë, edhe vetë emigrantët myslimanë mendonin se qëndrimi i tyre ishte i përkohshëm. Disa njerëz erdhën të punonin për një periudhë kohore për të fituar ca para, të cilat do të

investoheshin në vendin e tyre. Punëtorët emigrantë ishin vetëm burra dhe në shumicën e rasteve ata jetonin së bashku në dhoma të vogla me qëllim që të kursenin sa më shumë para që ishte e mundur. Ata ishin njerëz të thjeshtë, të cilët vinin nga zona të njëjta në vendet e tyre dhe të cilët ndihmoheshin mes vete për të ardhur në Norvegji. Shumica prej tyre vinin nga Pakistani, Turqia ose Maroku.

Fakti që emigrantët e quajtën qëndrimin e tyre në Norvegji si të përkohshëm, ndikoi në praktikën e tyre fetare. Sipas rregullave të jurisprudencës islame, myslimanët mund të shkurtrojnë namazet e tyre kur janë në udhëtime, ndërsa detyrimi fetar i namazit të xhumasë në xhami është gjithashtu pjesërisht i pezulluar. Shumë prej emigrantëve myslimanë gjatë kësaj periudhe u lidhën me praktikën e tyre fetare sikur të ishin në një lloj udhëtimi më të gjatë. Parimisht kjo nuk pranohet në legjislacionin islam, pasi qëndrimi në një vend për më shumë se 14 ditë nuk konsiderohet më udhëtim.

Në fillim të viteve të shtatëdhjeta, myslimanët në Norvegji filluan të themelojnë institucione fetare.³ Kjo ndodhi pak përpara se autoritetet të bënë një ngrirje të emigracionit. Ngrirja e emigracionit çoi në një fazë të re të modelit të migrimit, përkatësisht bashkimit familjar. Kur gratë dhe fëmijët filluan të vinin në Norvegji, nevoja për institucione fetare u bë e domosdoshme. Fëmijët kanë nevojë për edukim fetar dhe modeli më i qëndrueshëm i vendbanimit nënkuptonte se burrat ndjenin gjithashtu një nevojë më të madhe për vende të kujdesit fetar. Në vitet e tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta, modeli i emigracionit filloi të shihej si problematik, kryesisht për tre arsye:

E para, rënia e murit të Berlinit nënkuptonte se komunizmi nuk shihej më

Fëmijët kanë nevojë për edukim fetar dhe modeli më i qëndrueshëm i vendbanimit nënkuptonte se burrat ndjenin gjithashtu një nevojë më të madhe për vende të kujdesit fetar.



si kërcënim. Prandaj, emigracioni u bë kërcënim i ri për stabilitetin evropian, dhe si rrjedhim edhe për atë norvegjez.

E dyta, statistikatat e reja dolën në fillim të viteve të nëntëdhjeta, të cilat treguan se grupi joevropian ishte dyfishuar në pesë vjet.

E treta, recesionet ekonomike që ndodhën në botën perëndimore në fund të viteve të '80 dhe në fillim të viteve të '90, çuan në papunësi, veçanërisht në mesin e emigrantëve. Kështu, gjatë viteve të nëntëdhjeta, është ndërtuar një ideologji rreth emigrantëve dhe integritetit, në të cilën ka një tendencë për të përshkruar problemet si kulturore ose fetare, në vend që të shihet se shumë nga problemet me të cilat duhet të përballen emigrantët, e që realisht kanë shkakun e tyre në fushën sociale.

Në vitin 1997, u realizua një anketë në mesin e emigrantëve joevropianë, ku rezultati tregoi se mesatarisht myslimanët (pakistanëzët, turqit, iranianët dhe somalezët), kishin një arsim më të ulët se norvegjezët. Grupi i myslimanëve që kishin evazionin më të madh ishin iranianët. Në grupin iranian, pak e konsideronin veten fetarë, pasi shumica e tyre ikën nga presionet e përçarjeve fetare. Në mesin e emigrantëve që përkufizohen si myslimanë praktikantë, niveli i arsimit është i ulët. Kjo nuk ndikon vetëm në gjendjen sociale, por edhe në praktikën e tyre fetare. Emigrantët myslimanë me arsim të ulët priren të mbështeten te studiuesit në vendin e tyre ose te imamët në Norvegji, të cilët shpesh nuk e kuptojnë gjuhën norvegjeze. Çështja është se ato bien ndesh me rregullat, që janë të papajtueshme me realitetin norvegjez.⁴

Një tjetër çështje që është normale në grupet me arsim të ulët, dhe shpesh ka mungesë të vetëdijes, është se të gjitha elementet kulturore janë konstruksione shoqërore, dhe për këtë arsye njeriu ngec lehtësisht në besimin se elementi kulturor i tij është e vetmja "e vërtetë". Emigrantët me arsim të ulët gjithashtu përfundojnë lehtësisht në papunësi, dhe

situata sociale që sjell kjo, krijon probleme të cilat në shoqërinë norvegjeze shpesh quhen kulturore ose fetare. Si qëndrimet e shumicës së shoqërisë ndaj çështjes së emigrantëve, ashtu edhe struktura sociale në vendin pritës, shpesh prekin emigrantët. Ekziston shembulli i zhvillimit të strukturave shoqërore me grupin turk në Gjermani, për të zhvilluar më pas struktura të ndryshme sociale nga turqit edhe në Norvegji. Në të njëjtën mënyrë, tendenca në grupin e emigrantëve në Angli është që ata të kenë një profil dhe moshë të ndryshme nga grupi i emigrantëve në Norvegji, edhe pse përbërja e grupit është mjaft e ngjashme në të dy vendet. Dikush, për shembull, mund të pyesë nëse është rastësi që Norvegjia, me traditën e saj të lartë të barazisë, është vendi i parë perëndimor që ka një grua si kryetare e një organizate myslimane. **Vijon: Komuniteti shumicë**

Përktheu: ma.sc. Refik Gërbeshti, imam në Oslo gjatë viteve 2004-2011.

1 *P.S. Fusnotat dhe fotot janë shtojcë e përkthyesit, kurse fusnotat e autorës i kam hequr.

*Anne Sofie Roald (1945) është profesoreshë e historisë së religjionit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Malmo. Ajo është gjithashtu bashkëpunëtorë në Institutin "Chr. Michelsens" në Bergen. Ajo ka hulumtuar kryesisht mbi lëvizjet islame si edhe Islamin dhe gjininë.

Paraardhësit e norvegjezëve, koha kur lulëzoi tregtia në shekullin e tetë. Për Ditlef Fredriksen, Grunnlaget for vikingtida (<https://www.norgeshistorie.no/merovingertid/0706-grunnlaget-for-vikingtida.html> 31.oct.2023

2 Xhamia në Åkebergveien në Tøyen ishte xhamia e parë e Norvegjisë që u ndërtua si xhami nga themeli në vitin 1995. <https://www.aftenposten.no/oslo/i/WRRzkk/norges-foerste-moske-har-faatt-ny-fasade-for-tredjegang>.

3 Sekti "Islamik" Ahmedia, ishte komuniteti i parë fetar mysliman i regjistruar në Norvegji në vitin 1957. Lëvizja e ringjalljes së Azisë Jugore, Xhemati Teblig, u vendos në Norvegji në vitet 1970. <https://www.nrk.no/norge/mange-nye-muslimske-menigheter-1.6952308>

4 Truls Bølstad është myslimani i parë norvegjez. U konvertua në Islam në vitin 1957. Ai ishte mësues për shumë vite dhe së fundmi drejtor në shkollën e mesme të lartë. Ka qenë sekretar i përgjithshëm i Shoqatës së Mësuesve Norvegjez, konduktor i tramvajit dhe komandant në Forcat e Armatosura.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KOMANDANTIN E KFOR-IT, GJENERALIN ÖZKAN ULUTAŞ



Më 24 nëntor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim komandantin e KFOR-it në Kosovë, gjeneralin Özkan Ulutaş.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas e uroi atë për marrjen e detyrës në udhëheqjen e misionit të KFOR-it, duke i dëshiruar kështu punë të suksesshme. Më pas ai e njohu mysafirin me historikun, veprimtarinë dhe punët e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë në fushën e tolerancës dhe harmonisë

ndërfetare dhe ndëretnike. Ai tha se Bashkësia Islame mbetet e përkushtuar që të vazhdojë kontributin e saj në këtë drejtim, gjithnjë në koordinim me miqtë tanë. Myftiu Tërnavë edhe me këtë rast, shprehu falënderimet e tij për ndihmën dhe mbrojtjen që ka dhënë misioni i KFOR-it në Kosovë.

Nga ana e tij, gjenerali Özkan Ulutaş, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, e më pas shprehu urimet dhe përgëzimet e tij për rizgjedhjen e Myftiut në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës edhe për një mandat, duke i dëshiruar punë të mbarë. Gjenerali vlerësoi lart punën

dhe angazhimin që ka institucioni i BIK-u për mirëqenien e të gjithë qytetarëve, duke vlerësuar kështu harmoninë ndërfetare, tolerancën dhe bashkëjetesën ndërmjet gjithë qytetarëve pa dallim. Komandanti theksoi se misioni i KFOR-it është që të krijoj siguri për të gjithë qytetarët, ashtu që ata të jetojnë në paqe e harmoni. Ai tha se bashkëpunimi ndërmjet KFOR-it, Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe bashkësive të tjera fetare në vend do të vazhdojë edhe më tej në ndërtimin e paqes në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFIN E ZYRËS SË BE-SË NË KOSOVË, Z. TOMAS SZUNYOG

Më 27 nëntor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, z. Tomas Szunyog.

Myftiu Tërnavë e falënderoi ambasadorin e BE-së dhe nëpërmes tij edhe tërë Bashkimit Evropian për ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme dhënë për Kosovën. Ai tha se ne si institucion mbesim të përkushtuar që në vend të mbretërojnë harmonia dhe toleranca ndërfetare dhe ndëretnike, si vlera të çmuara të popullit tonë. Më pas, ai e njohu ambasadorin e BE-së edhe me punët dhe angazhimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion.



Nga ana e tij, ambasadori z. Szunyog, shfrytëzoi rastin që ta uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij edhe për një mandat në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai çmoi lart

kontributin e dhënë të Myftiut Tërnavë dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që në Kosovë të mbretërojnë paqja, respekti e toleranca ndërmjet besimeve dhe etnive të ndryshme.

AMBASADORI I SUEDISË, Z. JONAS WESTERLUND, UROI MYFTIUN TËRNAVA

Më 23 nëntor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim ambasadorin e Suedisë, z. Jonas Westerlund. Në këtë takim, z. Westerlund, uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij si Myfti i Kosovës edhe për një mandat, duke i dëshiruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai çmoi lart kontributin e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës dhënë për mbarëvajtjen e jetës fetare në vend. Ambasadori tha se BIK-u vazhdimisht ka luajtur një rol kyç në tolerancën dhe harmoninë ndërfaqetare që mbretëron në vend, e të cilat janë vlera të jashtëzakonshme të popullit shqiptar.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi ambasadorin z. Westerlund për vizitën dhe për urimet, duke shprehur



kështu falënderimet e tij për përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë shteti i Suedisë për Kosovën në procese të ndryshme. Ai tha se ne si institucion mbetemi të përkushtuar për të vazhduar

misionin tonë të shenjtë që kemi marrë mbi supet tona, duke potencuar kështu se respekti dhe toleranca mbeten vlerat tona me të cilat ne si shqiptarë duhet të krenohemi.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË PROGRAMIN “TAKIMI NDËRKOMBËTAR BALLKANIK NË SAKARIA”

Më 1 nëntor 2023, me ftesë të kryetarit të Bashkisë Metropolitane të Sakarias, z. Ekrem Yüce, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në programin “Takimi Ndërkombëtar Ballkanik në Sakaria”, në të cilin morën pjesë liderë fetarë, deputetë, kryetarë të komunave

dhe personalitete nga vendet e Ballkanit dhe Turqia.

Ky program u mbajt në qytetin e Sakarias së Turqisë, në të cilin jetojnë edhe një numër i madh i shqiptarëve, të cilët kanë emigruar në Turqi nga dhuna dhe presioni sllav.

Në fjalën e tij, në hapje të programit, ndër të tjera Myftiu Naim ef. Tërnavë, falënderoi shtetin e Turqisë dhe popullin vëlla turk për mbështetjen e pakursyer që kanë dhënë për popullin e Kosovës në periudha të ndryshme, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme që kanë pasur për Bashkësinë Islame të Kosovës.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE “DREJT TË KUPTUARIT SHERIATIK TË ZHVILLIMEVE SHKENCORE”

Më 7 nëntor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti, morën pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare me titull “Drejt të kuptuarit sheriatik të zhvillimeve shkencore”, e cila u mbajt në Abu Dabi. Kjo Konferencë u organizua nga Këshilli i Fetvasë së Emirateve të Bashkuara Arabe, dhe u mbajt nën patronazhin e ministrit të Punëve të Jashtme të këtij shteti, shejk Abdullah bin Zayed al Nahyan.

Konferenca filloi punimet me fjalën përshëndetëse të ministrit të Tolerancës dhe Bashkëjetesës së Emirateve, shejk Nahyan bin Mubarak al Nahyan.

Në këtë Konferencë morën pjesë më shumë se 160 figura shkencore dhe intelektuale, që përfaqësojnë më shumë se 50 vende.

Konferenca kishte për qëllim thellimin e njohurive dhe të kuptuarit e



saktë, duke ofruar kështu një mundësi për studiuesit dhe hulumtuesit që të diskutojnë një sërë çështjesh, përfshirë këtu jurisprudencën e realitetit dhe çështjet e tjera të Sheriatit, në atë mënyrë që të kontribuojnë në përputhshmërinë e tërthortë të shkencave natyrore dhe të Sheriatit.

Temat kryesore që u diskutuan gjatë kësaj Konference ishin: “Fetvatë në zhvillimet shkencore – drejt një meto-

dologjie të disiplinuar dhe të qëndrueshme që ndërvepron me nevojat njerëzore”; “Fetvatë në fushën e hapësirës, kozmonautët dhe zhvillimet në hapësirën jashtë tokës”; “Fetvatë në fushën e ambientit dhe ndryshimeve klimatike”; “Fetvatë në çështjet mjekësore”; “Fetvatë në çështjet e mjekësisë familjare” dhe “Fetvatë mbi inteligjencën artificiale”.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË SIMPOZIUMIN NDËRKOMBËTAR MBI VLERAT E PËRBASHKËTA NJERËZORE

Më 15 nëntor 2023, me ftesë të ministrit të Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Sulltanatit të Omanit, dr. Muhamed bin Said al Mamari, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar mbi vlerat e përbashkëta njerëzore, parandalimin e konflikteve për të shpëtuar jetë dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut.

Ky simpozium u organizua nga Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Omanit në bashkëpunim me Rrjetin për Paqebërësit Fetarë dhe Tradicional, si dhe me Zyrën e OKB-së për parandalimin e gjenocidit.

Në hapje të këtij Simpoziumi, fjalë hapëse mbajtën ministri i Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Sulltanatit të Omanit, dr. Muhamed bin Said al Mamari, znj. Alice Nderitu, këshilltare speciale e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Gjenocidit pranë



Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, z. Antonio Gueterres, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, si dhe dr. Muhamed el Senusi, drejtor ekzekutiv i rrjetit.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu Tërnavë, theks të veçantë i kushtoi historikut të popullit të Kosovës, ku ndër të tjera foli për vuajtjet dhe sakrificat e popullit të Kosovës për ndërtimin e një shteti

demokratik për të gjithë qytetarët, pa dallim feje apo etnie.

Myftiu Tërnavë i vuri theks vlerës më të madhe që ka populli shqiptar dhe ofroi shembullin më të mirë për të tjerët me bashkëjetesën fetare që kanë ndërmjet vete shqiptarët.

Në këtë Simpozium, Myftiu Tërnavë u shoqërua nga shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti.

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA MINISTRI I VAKËFEVE DHE ÇËSHTJEVE FETARE I SULTANATIT TË OMANIT

Më 16 nëntor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, u prit nga ministri i Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare i Sulltanatit të Omanit, shkëlqesia e tij, dr. Muhamed al Maamari. Kjo ishte vizita e dytë e Myftiut të Kosovës në Sulltanatit të Omanit.

Ministri Al Maamari e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën, e më pas shprehu gatishmërinë e tij dhe të Ministrisë që ai drejton për bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës. Ai e njohu Myftiun me arritjet e Ministrisë që ai drejton në Qeverisjen Elektronike, me të gjitha departamentet e saj, siç janë: Qeverisja e xhamive, vakëfeve, administratës, zekatit, haxhit, imamëve etj.. Ai theksoi se zbatimi dhe praktikimi i qeverisjes së mirë është në mbështetje të parimeve të drejtësisë, transparencës, llogaridhënies dhe



përgjegjësisë, e të gjitha këto na japin aftësinë për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji afatgjate të qëndrueshme, që mund të japë vlera të rëndësishme për të gjitha palët e interesuara.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, i njohu nikoqirët me gjendjen, historikun, pozitën, të arriturat, objektivat dhe

sfidat me të cilat përballet Bashkësia Islame e Kosovës. Ai gjithashtu e njohu ministrin me projektet e BIK-ut në ngritjen e infrastrukturës.

Të dyja palët u dakorduan për themelimin e bashkëpunimit në sferat e interesit të përbashkët.

REISUL ULEMA, SHAQIR EF. FETAI UROI MYFTIUN TËRNAVA

Më 20 nëntor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, Reisul Ulema, Shaqir ef. Fetain.

Kjo vizitë nga delegacioni i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV-së erdhi pas marrjes së mandatit të ri të Myftiut Naim ef. Tërnavë.

Me këtë rast, Reisul Ulema, Shaqir ef. Fetai, e uroi për mandatin e ri, duke i dëshiruar suksese në përmbushjen e misionit dhe detyrave.

“Në emër të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në emër të të gjithë besimtarëve tanë, jemi këtu për ta uruar marrjen e mandatit të ri, kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnavë. Ne kemi pasur dhe do të vazhdojmë të kemi një bashkëpunim të shkëlqyer. Dhashë Zoti që këtij t’i falë sukses edhe në mandatin e ri, për shkak se ky është rezultat i punës së

deritanishme”, tha ndër të tjera reisi Fetai.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, e falënderoi për urimet dhe për vizitën në selinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

“Ne këtu jemi si dy bashkësi fetare, por në kuptim të fjalës jemi një, për shkak se kemi në qëllim të përbashkët, të ruajmë dhe të kultivojmë jetën fetare islame shqiptare. Ne së bashku me bashkësitë e tjera fetare, atë të Shqipërisë

dhe të Malit të Zi, kemi përgjegjësinë e ruajtjes dhe kultivimit të Islamit të mirëfilltë”, tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Në këtë takim, Reisul Ulema, Shaqir ef. Fetai dhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, diskutuan edhe për problemet e përbashkëta të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut dhe për nevojat e bashkëpunimit dhe fushat se ku duhet të punojnë së bashku. Vëmendje të veçantë i kushtuan migrimit të të rinjve.



U MBAJT PROGRAMI “DASHURIA NDAJ VATANIT ËSHTË PJSË E IMANIT”



Më 24 nëntor 2023, për nder të festës së 28 Nëntorit, Këshilli i Bashkësisë Islame i Malishevës, organizoi manifestim kulturor-fetar kushtuar kësaj dite. “Dashuria ndaj vatanit është pjesë e imanit”, u titullua manifestimi, në të cilin morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ekrem Kastrati, komandant Çeliku, z. Fatmir Limaj, hoxhallarë dhe qytetarë të shumtë.

Në hapje të këtij manifestimi, kryetari i Këshillit të BI-së së Malishevës, Sead ef. Paqarizi, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Ligjëratën kryesore rreth dashurisë ndaj vatanit e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë. Ai foli për dashurinë që duhet ta ketë besimtari për atdheun e tij. “Atdheu është vendi në të cilin kemi lindur dhe në të cilin jetojmë. Atdheu është toka në të cilën morëm frymën e parë dhe në të cilën jetojmë dhe në të cilën do të kalojmë pjesën tjetër të jetës, ndaj duhet ta duam atë. Besoni se atdheu ynë është më i miri dhe më i bukur. Atdheu im ka një diell të ngrohtë, ajër të pastër, ujë të freskët, shira të mrekullueshëm, përmban peizazhe të ndryshme natyrore të maleve, luginave, lumenjve, dhe

pamjeve të tjera natyrore që rrisin lidhjen tonë me të, dashurinë tonë për te dhe na shtojnë drejt mbrojtjes, ruajtjes dhe konsiderimit të tij si një nga thesaret e botës së pashtershme. të nderuar të pranishëm: Më i bukur se atdheu është vetëm atdheu im” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Me nga një fjalë përshëndetëse, të pranishmit i përshëndetën edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ekrem Kastrati dhe Komandant Çeliku, z. Fatmir Limaj.

Programi u përmbyll me pikat artistike, të interpretuara nga Egzon Ibrahimit dhe Basri Lushtaku.

MYFTIU TËRNASA PRITI NË TAKIM IMAMIN BAHRI EF. BOJA

Më 24 nëntor 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim imamin e Xhamisë Shqiptare në Londër, Bahri ef. Boja.

Me këtë rast, imami Boja, shfrytëzoi rastin që të urojë Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij edhe për një mandat në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi imamin Boja për vizitën dhe për



urimet, duke shprehur kështu gati-shmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton, që bashkëpunimi i mirë që ka

mbretëruar deri më tani ndërmjet BIK-ut dhe qendrave islame në diasporë, të vazhdojë edhe më tej.

MYFTIU TËRNAVA DHE MINISTRJA E DREJTËSISË NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI



Më 30 nëntor 2023, Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe ministrja e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu, nënshkruan sot Memorandum bashkëpunimi, i cili ka për qëllim

bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht Zyrës së Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje me Bashkësinë Islame të Kosovës për realizimin dhe ofrimin e sesioneve informuese për

komunitetin myslimanë, si dhe mobilizimin e liderëve në komunitet, si partnerë e bashkëpunëtorë në veprimet kundër të gjitha formave të dhunës në familje e dhunës ndaj grave.

KËSHILLAT E BI-SË, STAFI AKADEMIK I FSI-SË DHE AI I MEDRESESË “ALAUDDIN” URUAN MYFTIUN TËRNAVA

Këshilli i Bashkësisë Islame i Prishtinës, i Prizrenit, i Pejës, i Gjakovës, i Gjiçan, i Drenasit, i Istogut, i Shtimes, i Obiliqit, i Dragashit, i Kamenicës, i Kaçanikut, i Preshevës, i Deçanit, stafi akademik i Fakultetit të Studimeve Islame dhe profesorët e medresesë së mesme “Alauddin” vizituan selinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, në të cilën u mirëpritën nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Udhëheqësit e këtyre institucioneve dhe drejtuesit e këtyre këshillave, uruan Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen edhe për një mandat në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i uruar dhe dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ata, në takime të ndara, që të gjithë u pajtuan se vetëm të bashkuar e unikë, mund të ecim përpara dhe së bashku mund t'i çojmë përpara proceset të cilat i bartim si përgjegjësi, duke kujtuar kështu amanetin që kemi marrë mbi supet tona.



Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që t'i falënderoi të gjithë për besimin e dhënë që të jetë edhe për një mandat në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas kërkoi nga ta angazhimin edhe më të madh për mbarëvajtjen e jetës fetare

dhe për plotësimin e kërkesave të besimtarëve tanë, duke ua kujtuar kështu atyre përgjegjësinë që kemi para besimtarëve në këtë botë, por edhe përgjegjësinë që do ta kemi nesër kur do të dalim para Zotit Fuqplotë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KRYESISË SË BIK-UT AHMET EF. SADRIU PRITI NË TAKIM PROF. FAHREDIN EF. EBIBIN

Më 1 nëntor 2023, sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, i shoqëruar nga kryeimami Vedat ef. Sahiti, drejtori i Drejtorisë për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan ef. Shkodra dhe nga drejtori i Drejtorisë për Diasporë, Ekrem ef. Simnica, kanë pritur në takim profesorin e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, Fahredin ef. Ebibin, i cili shoqërohej nga drejtori i Informacionit dhe Publikimeve në Bashkësinë Fetare Islame të RMV-së, Fidush ef. Ibrahimimi dhe nga drejtori i Sektorit Fetaro-Arsimor në BFI, Fejzulla ef. Sadiki.

Gjatë këtij takimi u diskutua për sfidat dhe peripecitë me të cilat ballafaqohen këto dy institucione, si dhe për bashkëpunimin e mirë që kanë këto dyja, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut. Që të dyja palët

u dakorduan që një bashkëpunim i tillë duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen për të mirën e besimtarëve të të dyja vendeve.

Mysafirët nga BFI e RMV-së shfrytëzuan rastin që të urojnë rizgjedhjen e Myftiut Tërnavë edhe për një mandat

në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke e vlerësuar rolin dhe kontributin e tij në udhëheqjen e deritanishme të këtij institucioni. Ata uruan që të vazhdohet edhe më tej ky kontribut, duke i dëshiruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme.



SEKRETARI SADRIU PRITI NË TAKIM DELEGACIONIN E LARTË TË DIJANETIT TË TURQISË

Më 9 nëntor 2023, sekretari i Përgjithshëm i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, i shoqëruar nga kryeimami, Vedat ef. Sahiti dhe drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, pritën në takim dr. Fatih Kurt, drejtor për Botime dhe Media pranë Dijanetit të Turqisë, i cili shoqërohej nga drejtori i shkollës "Omer Halisdemir", z. Yasar Keskin.

Gjatë këtij takimi, sekretari Sadriu dhe drejtori Kurt, diskutuan për mënyrën dhe nevojat e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Dijanetit të Turqisë.

Pikë e veçantë e diskutimit në këtë takim ishte bashkëpunimin në sferën e botimeve dhe atë mediatik, ku u dakorduan për bashkëpunimin në këto sfera të rëndësishme.



Sekretari Sadriu, falënderoi dhe çmoi lart kontributin e Dijanetit të Turqisë për ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë, ruajtjen dhe konservimin e objekteve fetare e kulturore, çështjet e mesi- besimit dhe çështje të tjera.

Në anën tjetër, Fatih Kurt, shprehu gatishmërinë për mbështetje dhe përkrahje në thellimin e bashkëpunimit me Bashkësinë Islame të Kosovës për çka siç tha ai: "punës dhe kontributit të veçantë në sferat fetare të jetës në Kosovë".

MINISTRI I MKRS-SË Z. ÇEKU DHE KRYEIMAMI SAHITI VIZITUAN DISA XHAMI TË RESTAURUARA

Më 7 nëntor 2023, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku vizituan disa prej objekteve fetare me rëndësi kulturore e trashëgimore. Ata fillimisht xhaminë e Mahmut Pashës në Gjakovë, për të vijuar më pas me Xhaminë e Sefës, të cilat janë restauruar dhe konservuar. Po ashtu, u vizitua edhe Medreseja e Vogël në

Gjakovë, e cila është restauruar së fundmi.

Theks të veçantë iu kushtua Xhamisë së Drenocit, e cila ishte djegur pothuajse tërësisht para dy vjetëve. Kjo xhami tashmë është restauruar dhe konservuar, ku edhe së shpejti pritet të kthehet në shërbim të besimtarëve. Kryeimami Sahiti, falënderoi MKRS-së për punën

që po bën në mbrojtjen e vlerave dhe trashëgimisë.

Ministri Çeku, tha se promovimi dhe mbrojtja e kësaj trashëgimie të çmuar është detyrë që po kryhet së bashkë me BIK-un. Ministrit Çeku në fund iu dhuruan edhe dy vëllimet "Sallnametë e Vilajetit të Prizrenit" nga Drejtoria e Botimeve të BIK-ut.



KRYEIMAMI SAHITI DHE ISH-ZËVENDËS PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË TURQISË, Z. FUAT OKTAY VIZITUAN PUNISHTEN E XHAMISË QENDRORE

Më 7 nëntor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mirëpriti në punishten e Xhamisë Qendrore në Prishtinë, anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Madh të Republikës së Turqisë, në krye me z. Fuat Oktay ish-zëvendës president i Republikës së Turqisë, të cilët po qëndrojnë për vizitë zyrtare në vendin tonë.

Gjatë vizitës, parlamentarët turq, u njohën me ecurinë dhe zhvillimin e punimeve në ndërtimin e Xhamisë Qendrore.

Kryeimami Sahiti, falënderoi parlamentarët turq për vizitën dhe për mbështetjen e shtetit turk, gjegjësisht fondacionit të Dijanetit në ndërtimin e kësaj xhamie.



KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM DREJTORESHËN E ORGANIZATËS PËR FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR OFAP, ZNJ. IBADETE KRASNIQI



Më 9 nëntor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, bashkë me zyrtaret e Departamentit të Gruas së BIK-ut, mirëpritën në takim znj. Ibadete Krasniqi drejtoreshë e Organizatës për fëmijët pa kujdes prindëror OFAP, e cila shoqërohej nga znj. Lule Beka.

Kryeimami Sahiti e falënderoi znj. Krasniqi për kontributin e organizatës

OFAP në ndihmë të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe çmoi lart rolin e kësaj organizate në gjetjen e familjeve strehuese për këta fëmijë. Ai gjithashtu theksoi gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës që të bashkëpunojë dhe të ndihmojë përmes skemave të saj sociale në projekte konkrete.

Nga ana e saj, znj. Ibadete Krasniqi, falënderoi kryeimamin për mikpritjen

dhe për gatishmërinë e tij për bashkëpunim edhe përmes Departamentit të Gruas dhe Shoqatës Humanitare “Bereqeti” që të bashkërendojnë aktivitetet në projekte të ndryshme që t’u dalin në ndihmë fëmijëve pa kujdes prindëror, dhe atyre që kanë nevojë për kujdesin tonë si shoqëri.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË PUNIMET E KËSHILLIT EVROPIAN PËR FETVA DHE HULUMTIME

Nga data 11 deri më 15 nëntor 2023, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në punimet e Këshillit Evropian për Fetva dhe Hulumtime, në sesionin e tij të 34-të, i cili u mbajt në Stamboll të Turqisë.

Në vitin e 25-të të themelimit të Këshillit Evropian për Fetva dhe Hulumtime, morën pjesë personalitete të njohura nga bota islame, duke filluar nga kryetari i Diyanetit, prof. Dr. Ali ERBASH, Sekretari i Unionit të Dijetarëve Mysliman, prof. Dr. Ali Karadagi, Abdulmexhid Zindani, si dhe shumë personalitete nga bota akademike islame.



KËSHILLI DREJTUES I IHSI-SË MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS



Më 16 nëntor 2023, Këshilli Drejtues i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt, të cilën e hapi dhe e kryesoi drejtori i këtij Instituti, prof. Sabri ef. Bajgora. Ai fillimisht falënderoi anëtarët

e këtij Këshilli për punën dhe angazhimin e tyre.

Këshilli në rend të ditës kishte diskutimin për Konferencën Shkencore për xhamitë në trojet shqiptare, e cila është vendosur të mbahet më 9 dhe 10 dhjetor 2023.

Përgatitjet për këtë konferencë janë duke u bërë sipas hapave të paraparë.

Numri i pjesëmarrësve të paraqitur me kumtesat e tyre është mbi 70 studiues, të fushave të ndryshme dhe nga të gjitha trojet shqiptare, vendet e Ballkanit, por edhe më gjërë.

Konferenca do të mbahet në hotelin “Emerald” të Prishtinës.

“BEREQETI” SHTRIU DORËN E NDIHMËS NË PJESËN VERIORE TË VENDIT

Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, në kuadër të aktiviteteve humanitare në pjesën veriore të vendit, vizitoi Komunën e Leposaviqit, me ç’rast drejtori z. Behxhet Ajvazi me bashkëpunëtorë u mirëpritën në takim nga kryetari i Komunës, z. Lulzim Hetemi.

Në këtë takim, z. Ajvazi dhe z. Hetemi diskutuan për mundësitë e mbështetjes dhe bashkëpunimit institucional për të ndihmuar familjet me gjendje të rëndë socio-ekonomike.

25 familje në kushte të rënduara ekonomike u ndihmuan nga “Bereqeti” me produkte ushqimore dhe higjienike të nevojshme.

“Bereqeti” gjatë këtij muaji ka mbështetur me artikuj ushqimor mbi 200 familje nevojtare të komuniteteve



të ndryshme pa asnjë dallim. Ky aktivitet u realizua në koordinim me drejtoritë komunale dhe në bashkëpunim me miqtë e “Bereqetit” që po mbështesin aksionet humanitare.


Aktivitete të tilla do të vazhdojnë gjatë gjithë sezonit të dimrit në mënyrë që secila familje të ketë produktet e nevojshme dhe të ketë mirëqenie për jetë.

ATË NATË

Atë natë kur hëna shkrepiti rrezet e veta,
Që largonin çdo re të qiellit,
Depërtonin bukur ato hijeshi drite përtej dritareve...
Atë natë u gjend një trup i kërrusur...
Një shtrat...
Një dhomë me dritë hënën...
Një tavolinë me rrëmujë letrash...
Shkrimi s'mund t'i lexohej dot,
Sepsë edhe errësira kishte marrë anën e vet...,
Një dënesë u dëgjua...
Një frymë e rëndë u morr...
Atë natë s'dëgjohej i gjalli,
Por edhe i vdekuri kishte ndërruar qetësinë...
Pamja e dritares kishte diçka hyjnore,
Ishte si një portë...
Rrezet kaltëroshë vallëzonin përtej perdes...
Ajo ngrohtësi hëne kishte marrë formën e vijave të trasha e të gjata në tepih.
Trupi s'lëvizte...
Kërkohej diçka, por diçka u gjend...
Atë natë...
Ai trup që lëvizte me gjallëri
Atë natë dukej ta kishte marrë lumi i vdekjes, ndonëse frymonte...
Ajo kishte mbështetur kokën në këmbët e mbledhura,
Por sytë s'i ndante nga hëna...

Ajo kërkonte paqen...
Qetësinë, sigurinë, rehatinë..., veten...
Por, atë natë ajo gjeti shtëpinë...
Frymëmarrja u shpeshtua,
Lëvizjet u gjallëruan...
A ishin këta lot gëzimi?
Apo lot mallëngjimi?
Apo ishin të dyja?
Atë natë ajo gjeti dashurinë mbi të gjitha...
Krejt çka i kërkoi i gjeti në një vend...
Atë natë kuptoi se kishte një shtëpi,
Por në shtëpi nuk ishte.
Atë natë kuptoi se shtëpia mund të bëhet gjithçka...
Edhe një kombinim ere me një rreze hëne mund të bëhet shtëpi...
Atë natë ajo kuptoi se shtëpia ndërtohet mbi lumturinë, sakrificën dhe besimin.
Ndonëse vështirë për t'u gjetur...
Por ajo e kishte të lehtë.
Atë natë si kurrë më parë
Ajo e kishte ndjerë Zotin e saj afër...
Kënaqësia e Tij ishte shtëpia e saj...
Atë natë ajo kërkonte gjithçka që kishte humbur në veten...,
Mirëpo mjaftoi një copë peizazhi hyjnorë dhe ajo i gjeti...

Esma Curri



Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame (IHSI) së shpejti do të nxjerrë në qarkullim “Sallnametë e Vilajetit të Prizrenit I-II (1873-1874)” të përkthyer e përgatitur nga dr. Hatixhe Ahmedi e dr. Sadik Mehmeti

DITURIA ISLAME • Nr. 397 DHJETOR 2024